



Të jetojmë së bashku

Të ndërthurim diversitetin dhe lirinë në
Evropën e shekullit 21



Raport i Grupit të Personave të Shquar të
Këshillit të Evropës

Pasqyra e lëndës

Përmbledhje	5
Hyrje	9
Pjesa e parë– Rreziku	12
A. Cilat janë rreziqet dhe sa serioze janë ato?	12
1. Mungesa në rritje e tolerancës	12
2. Rritja e mbështetjes për partitë ksenofobike dhe populiste	19
3. Diskriminimi	20
4. Prania e një popullsie pothuajse pa të drejta	21
5. Shoqëritë paralele.....	24
6. Ekstremizmi islamik	25
7. Humbja e lirive demokratike	26
8. Një përplasje e mundshme midis “lirisë së besimit” dhe lirisë së shprehjes	27
B. Cilat janë shkaqet e këtyre rreziqeve?	28
1. Pasiguria.....	28
2. Emigracioni.....	29
3. Imazhi i shtrembëruar i minoriteteve në media dhe stereotipet e dëmshme	32
4. Kriza e udhëheqjes.....	34
Pjesa e dytë– Reagimi	35
A. Parime orientuese	35
B. Aktorët kryesorë të ndryshimit	40
1. Arsimitarët	40
2. Masedia	42
3. Punëdhënësit dhe sindikatat	44
4. Shoqëria civile	44
5. Kishat dhe grupet fetare	48
6. Njerëzit e famshëm dhe “modelet”	49
7. Qytezat dhe qytetet	52
8. Shtetet anëtare	56
9. Institucionet evropiane dhe ndërkombëtare	57

<i>C. Propozime për veprim</i>	60
I. Rekomandime strategjike	60
II. Rekomandime të veçanta	63
Shtojca 1: Termat e referencës së Grupit	75
Shtojca 2: Takimet e Grupit dhe njerëzit e intervistuar	77
Shtojca 3: Bibliografi përmbledhëse	79
Shtojca 4: Anëtarët e Grupit	85

Përmbledhje

Në verën e vitit 2010, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, Thorbjørn Jagland, kërkoi që një “Grup Personash të Shquar” të pavarur (Grupi) të hartonte një raport mbi sfidat që lindin si rrjedhojë e rigjallërimit të mungesës së tolerancës dhe diskriminimit në Evropë. Raporti bën vlerësimin e shkallës së rreziqeve, identifikon burimet e tyre dhe bën një sërë propozimesh për “bashkëjetesë” në shoqëri të hapura evropiane.

Grupi drejtohet nga ish ministri i jashtëm gjerman Joschka Fischer dhe përbëhet nga nëntë anëtarë - katër gra dhe pesë burra – ku secili prej tyre është nga një shtet i ndryshëm anëtar i Këshillit të Evropës. Përveç Z. Fischer, grupi përfshin edhe Emma Bonino (Itali), Timothy Garton Ash (Mbretëri e Bashkuar), Martin Hirsch (Francë), Danuta Hübner (Poloni), Ayse Kadioğlu (Turqi), Sonja Licht (Serbi), Vladimir Lukin (Federata Ruse) dhe Javier Solana (Spanjë). Raportuesi është Edward Mortimer (Mbretëria e Bashkuar).

Për nxjerrjen e përfundimeve dhe rekomandimeve Grupi mbështetet plotësisht në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, veçanërisht për sa i përket lirisë individuale dhe barazisë përpara ligjit. Grupi vë në dukje se diskriminimi dhe mungesa e tolerancës janë sot një dukuri e përhapur në Evropë, veçanërisht kundër Romëve dhe emigrantëve, si dhe kundër individëve me të shkuar të afërt prej emigranti, të cilët shpesh trajtohen si të huaj edhe në vendet ku ata kanë lindur dhe janë shtetas.

Raporti thekson se identitetet janë një çështje vullnetare për individin dhe askush nuk duhet të detyrohet të zgjedhë apo të pranojë një identitet kryesor i cili të përjashtojë të tjerët. Sipas raportit, shoqëritë evropiane duhet të përkrahin diversitetin dhe të pranojnë se dikush mund të jetë “një evropian me vizë në mes” – për shembull turko-gjerman, afrikano veriore-franceze, apo aziatiko-britanik – ashtu si dikush mund të jetë afrikano-amerikan apo italiano-amerikan. Megjithatë kjo mund të funksionojë vetëm nëse të gjithë banorët afatgjatë pranojnë si shtetas dhe cilido qoftë besimi, kultura apo përkatësia e tyre etnike, ata trajtohen në mënyrë të barabartë përpara ligjit, institucioneve dhe bashkëqytetarëve. Ashtu si të gjithë qytetarët e tjerë në demokraci, ata duhet të shprehin mendimin e tyre gjatë hartimit të ligjeve, por as besimi fetar dhe as kultura nuk mund të pranojnë si justifikime për t’i shkelur ato.

Raporti është i ndarë në dy pjesë: “Rreziku” dhe “Reagimi”

Në pjesën e parë Grupi identifikon tetë rreziqe specifike për vlerat e Këshillit të Evropës: mungesa në rritje e tolerancës; mbështetja në rritje për partitë ksenofobike dhe populiste; diskriminimi; prania e një popullsie pothuajse pa të drejta; shoqëritë paralele; ekstremizmi islamik; humbja e lirive demokratike; dhe një përplasje e mundshme ndërmjet “lirisë fetare” dhe lirisë së shprehjes. Prapa këtyre rreziqeve gjendet pasiguria (e cila buron nga vështirësitë ekonomike të Evropës dhe ndjenja e rënies relative); dukuria e emigracionit masiv (ashtu siç përjetohet në realitet dhe siç perceptohet); imazhe të shtrembëruara dhe stereotipe të dëmshme të minoriteteve në

media dhe në opinionin publik; numër i ulët udhëheqësish të cilët mund të ngjallin besim duke shprehur një vizion të qartë për të ardhmen e Evropës.

Në pjesën e dytë, Grupi fillon me parashtrimin e 17 parimeve, të cilat ai beson se duhet të orientojnë reagimin e Evropës ndaj këtyre rreziqeve, duke filluar me deklarin se “minimalisht, duhet të pranohet se ligji duhet respektuar, si dhe të kuptohet nga të gjithë se çfarë është ligji dhe si mund të ndryshohet”. Më pas vazhdohet me identifikimin e aktorëve kryesorë të cilët janë në gjendje të sjellin ndryshimet e nevojshme në qëndrimet e publikut: arsimtarët, masmedia, punëdhënësit dhe sindikatat, shoqëria civile, kishat dhe grupet fetare, njerëzit e famshëm dhe “njerëzit model”, qytetazat dhe qytetet, shtetet anëtare, si dhe institucionet evropiane dhe ndërkombëtare. Në pjesën më të madhe të këtyre kategorive, raporti përfshin përshkrime të shkurtra të grupeve apo individëve të veçantë, puna e të cilëve, sipas Grupit, është “e lavdërueshme dhe mund të shërbejë si model”. Më pas raporti mbyllet me 59 “propozime për veprim”, ku 17 të parat emërtohen “rekomandime strategjike”, ndërsa pjesa tjetër, “rekomandimet e veçanta”, lidhen kryesisht me Bashkimin Evropian, Këshillin e Evropës dhe shtetet anëtare.

Parimet

17 parimet drejtuese në fillim të pjesës së dytë përbëjnë një lloj manuali për diversitetin, të cilin mund ta memorizojnë dhe t’a mbajnë pranë të gjithë politikëbërësit, drejtuesit e opinionit si dhe aktivistët e shoqërisë civile. Grupi këmbëngul si për të drejtat ashtu edhe për detyrimet e qytetarëve në demokraci, veçanërisht të të sapoardhurve apo minoriteteve, si dhe për të drejta të barabarta për burrat dhe gratë; nëse zbatojnë ligjet, nga emigrantët “nuk duhet të pritët që të heqin dorë nga besimi, kultura apo identiteti i tyre”. Grupi shprehet se janë të arsyetuar dhe të nevojshme masat që sigurojnë se pjesëtarët e grupeve në nevojë apo të marginalizuara të gëzojnë barazi të vertetë mundësish dhe kjo përpjekje është e nevojshme për të siguruar që pjesëtarët e grupeve të ndryshme fetare, kulturore apo etnike të njihen me njëri tjetrin dhe të punojnë së bashku në grupime vullnetare. Në fund, Grupi mbështet të drejtën për lirinë e shprehjes, por në të njëjtën kohë shton se “deklarimet publike të cilat kanë tendencën të krijojnë apo përforcojnë paragjykime publike kundër pjesëtarëve të ndonjë grupi – dhe veçanërisht kundër pjesëtarëve të minoriteteve, emigrantëve apo njerëzve me prejardhje emigranti të kohëve të fundit – nuk duhen lënë pa ju dhënë përgjigje”.

Propozimet

Rekomandimet strategjike të raportit lidhen ngushtë me parimet e mëposhtme. Shtetet nxiten të “zgjerojnë të drejtat e plota dhe detyrimet e shtetësisë, përfshirë këtu të drejtën për të votuar, për aq shumë banorë sa të jetë e mundur” dhe, si hap i përkohshëm, të gjithë banorëve të huaj t’i jepet e drejta për të votuar në zgjedhjet për pushtetin vendor. Ato nxiten gjithashtu të korrigjojnë “informacionet e gabuara dhe stereotipet rreth emigracionit”, si dhe t’u japin qytetarëve të tyre “një pasqyrë më realiste të situatës së migrantëve dhe nevojave aktuale dhe të ardhshme të Evropës në

fushën e emigracionit”. Ata kanë të drejtën dhe detyrimin për të kontrolluar imigrimin, por të gjithë evropianëve u bëhet thirrje “të trajtojnë në mënyrë të drejtë dhe njëerëzore azilkërkuesit dhe migrantët që mbërrijnë në Evropë”, duke treguar solidaritetin e duhur dhe ndarjen e barrës midis shteteve anëtare. Këshillit të Evropës dhe BE-së i kërkohet të punojnë së bashku për “një politikë gjithëpërfshirëse, koherente dhe transparente për imigrimin”, e cila të përfshijë mbarë Evropën. Së fundi, popujt e Evropës nxiten të ofrojnë ndihmën e tyre për “fqinjët në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, të cilët tashmë janë duke shfaqur me forcë të madhe dëshirën e tyre për vlerat universale të lirisë dhe demokracisë”, veçanërisht duke i dhënë atyre mundësinë të marrin pjesë, “me një status të përshtatshëm”, në institucione dhe konventa evropiane.

Ndër rekomandimet e tij të veçanta, Grupi sugjeron që Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës të emërojë një përfaqësues special të nivelit të lartë i cili të sjellë përmbajtjen e raportit në vëmendjen e udhëheqësve politikë dhe të monitorojë vënien e tij në jetë, dhe nga ana tjetër, Polonia dhe Ukrahina, si drejtuese përkatësisht të Komitetit të Ministrave të BE-së dhe Këshillit të Evropës, duhet të organizojnë një samit të përbashkët mbi diversitetin, për të “shqyrtuar çështjet e ngritura në këtë raport dhe të bien dakort për një strategji të përbashkët veprimi në fushën e diversitetit dhe të drejtave të njeriut”.

Hyrje

Ende në fillim të shekullit 21, evropianët kanë shumë gjëra për të cilat duhet të jenë mirënjohës. Në përgjithësi, jetët e tyre janë më të lira, më të shëndetshme, më të sigurta, më të pasura, më paqësore dhe që mund të jenë më të gjata se ato të stërgjyshërve të tyre – dhe të bashkëkohësve të tyre në shumë pjesë të tjera të botës. Ata kanë larguar shumë praktika çnjerëzore të kohëve të shkuara, si dënimi me vdekje, dhe kanë pranuar një shkallë përgjegjësie për mirëqenien e njeri tjetrit në rast fatkeqësie. Jo vetëm në 27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), por në të 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, të drejtat dhe liritë e tyre – ndonëse ende çenohen dhe neglizhohen shpesh – janë të përcaktuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe mbështeten nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Megjithatë, Evropa është ende e shqetësuar. Evropianët nuk kanë besim se prosperiteti i tyre mund t'i rezistojë lindjes së fuqive të reja, ekonomitë e të cilave duken më dinamike dhe më konkurruese. Ata i frikësohen faktit se jetëgjatësia më e lartë dhe shkalla në ulje e lindjeve mund të sjellë një numër shumë të vogël njerëzish në moshë pune të cilët të mbështesin dhe të kujdesen për numrin në rritje të pensionistëve. Ata i tremben gjithashtu ardhjes së një numri të madh njerëzish nga kontinente të tjera – njerëz që lëvizin në kërkim të një jete më të mirë, ashtu siç kanë bërë shumë evropianë në të shkuarën; njerëz, puna dhe iniciativa e të cilëve mund të ndihmojë Evropën të zgjidhë këtë problem. Pse i tremben kësaj evropianët, në vend që ta mirëpresin atë? Kjo ndodh sepse ata kanë frikë se të ardhurit do të jenë të shumtë në numër dhe do të përkeqësojnë nivelin e papunësisë së vazhdueshme dhe varfërisë që gjendet tashmë në mes të prosperitetit të tyre; dhe sepse ata nuk kanë dëshirë të ndajnë jetët e tyre me njerëz të cilët ata i perceptojë, me apo pa të drejtë, si të ndryshëm nga ata vetë.

Për të ulur frikën e parë, shtetet kanë të drejtën dhe detyrën të kontrollojnë migracionin. Megjithatë, ata duhet t'i kujtojnë vazhdimisht qytetarëve të tyre arsyet pse të paktën disa emigrantë janë të nevojshëm dhe duhen mirëpritur; dhe, besnikë ndaj vlerave njerëzore evropiane, ata duhet të respektojnë të drejtat themelore që i përkasin çdo qenieje njerëzore, pavarësisht kombësisë së tyre. Në të vërtetë, personat pa shtetësi, të cilëve u mungon mbrojtja nga një shtet mëmë, janë shpesh personat për të cilët të drejtat universale janë jashtëzakonisht të rëndësishme.

Frika e dytë – frika nga diversiteti – është ajo të cilën ky raport kërkon të trajtojë. Kështu, le të fillojmë duke kujtuar që shoqëritë evropiane kanë qenë gjithmonë të larmishme. Është pikërisht kjo larmi që ka sjellë shumë nga arritjet e saj më të mëdha në Evropë – ndonëse diversiteti i keqpërdorur ka luajtur gjithashtu rolin e tij në disa nga tragjeditë e saj më të rënda.

Diversiteti është e ardhmja e Evropës për dy arsye.

Së pari, pjesa më e madhe e atyre që kanë ardhur në Evropë gjatë dekadave të fundit, dhe pasardhësit e tyre, janë këtu për të qëndruar. Shumë prej tyre vazhdojnë të jenë të lidhur me trashëgiminë kulturore të vendeve të tyre të origjinës. Ku qëndron problemi

në këtë rast? Për sa kohë që respektojnë ligjin, nuk duhet të pritët që njerëzit të cilët vijnë të jetojnë në një shtet tjetër të lënë pas besimin, kulturën apo identitetin e tyre. Përkundrazi, ky diversitet mund të japë ndihmesën e vet në kreativitetin për të cilin Evropa tani ka nevojë më shumë se kurrë. Kjo do të thotë gjithashtu se që të jetosh së bashku në Evropë duhet parë përtej Evropës. Ajo çka ndodh në ato pjesë të botës nga ku vijnë këta evropianë të rinj, dhe veçanërisht nga fqinjët e Evropës, ka të ngjarë të na prekë të gjithëve ne, për mirë apo për keq. Ne nuk mund të vendosim për fatin e fqinjëve tanë por duhet të jemi të gatshëm për t'i ndihmuar ata dhe të mësojmë prej tyre sa më shumë të jetë e mundur.

Së dyti, vetë fakti se Evropa është duke u plakur do të thotë se nevojiten më shumë emigrantë. Komisioni Evropian parashikon se pa ata, në BE gjatë 50 viteve të ardhshme, fuqia punëtore do të pësojë një rënie prej 100 milion, ndërkohë që popullsia në total vazhdon të rritet. Kjo është recetë për një rënie ekonomike.

Pra, diversiteti do të ekzistojë. Ai është duke i dhënë formë të ardhmes së Evropës në një botë që ndryshon shpesh dhe do të vazhdojë të bëjë një gjë të tillë. Si rrjedhojë, është me rëndësi jetike që evropianët t'i përgjigjen sfidave të saj në mënyrë më efikase dhe bujare – dhe, për të qenë më të drejtpërdrejtë, shumë më mirë se sa po e bëjnë tani. Ata nuk mund t'ia lejojnë vetes që këtë herë të veprojnë në mënyrë të pakujdesshme. Fatkeqësisht, ekzistojnë shenja të cilat tregojnë se ata rrezikojnë ta bëjnë një gjë të tillë.

Në pjesën e parë të raportit tonë përshkruajmë disa nga këto shenja dhe trajtojmë shkurtimisht shkaqet. Në pjesën e dytë parashtrojmë disa parime orientuese për përmirësimin e gjendjes, identifikojmë aktorët kryesorë që mund të sjellin ndryshim dhe e mbyllim me një listë rekomandimesh – disa strategjike dhe disa specifike – të cilat i drejtohen këtyre aktorëve.

Ndërkohë që ishim duke përgatitur raportin, rreth nesh lindi një debat, në të cilin morrën pjesë shumë udhëheqës evropianë. Secili njëri pas tjetrit, udhëheqësit politikë të Gjermanisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës, u shprehën me thuajse të njëjtat fjalë se “multikulturalizmi” kishte dështuar.¹

Sigurisht që jemi në dijeni të këtij debati por mendojmë se termi “multikulturalizëm” përdoret në atë shumë mënyra të ndryshme, merr kuptime të ndryshme për njerëz të ndryshëm dhe në vende të ndryshme – a është ai një ideologji? një grup politikash? një realitet shoqëror? – sa që në fund ai më shumë të ngatërron se sa të sqaron. Për këtë arsye, kemi vendosur të shmangim përdorimin e këtij termi dhe të përqendrohemi në identifikimin e politikave dhe qasjeve të cilat do t'i japin mundësi shoqërive evropiane të ndërthurin diversitetin dhe lirinë.

Për hartimin e raportit, Grupi ka organizuar takime në pesë qytete evropiane me një sërë pjesëmarrësish dhe ka shfrytëzuar një numër të madh dokumentesh nga Këshilli i Evropës dhe organizata të tjera ndërkombëtare apo kombëtare. (Si pjesëmarrësit ashtu edhe dokumentet jepen në shtojcat në fund të raportit.) Mirënjohje e veçantë shkon për raportuesin tonë, Edward Mortimer, për mënyrën angazhuese, reaguese dhe të aftë

1. Angela Merkel, fjalim drejtuar anëtarëve të forumit rinor, Potsdam, 16 tetor 2010; David Cameron, fjalim drejtuar Konferencës së Sigurisë në Mynih, 5 shkurt 2011; Nicolas Sarkozy, intervistuar në *Paroles de Français* (TF1), 11 shkurt 2011.

me të cilën ai organizoi diskutimet tona në një argument koherent. Ndërkohë që shprehim mirënjohjen për gjithë këtë mbështetje, pa të cilën nuk do të mund ta kishim përmbushur detyrën tonë, përgjegjësia për mendimet e shprehura bie vetëm mbi ne.

<i>Joschka Fischer (Kryetar)</i>	<i>Danuta Hübner</i>
<i>Emma Bonino</i>	<i>Sonja Licht</i>
<i>Timothy Garton Ash</i>	<i>Vladimir Lukin</i>
<i>Martin Hirsch</i>	<i>Javier Solana</i>
<i>Ayşe Kadioğlu</i>	

Prill 2011

Pjesa e parë – Rreziku

Termat tona të referencës kërkojnë që ne të vlerësojmë “seriozitetin e kërcënimit ndaj vlerave të Këshillit të Evropës” dhe më pas të identifikojmë burimet e këtyre dukurive. Në pjesën e parë të raportit tonë përpiqemi të bëjmë pikërisht këtë gjë, fillimisht duke renditur dukuritë në fjalë dhe më pas, më shkurtimisht, diskutojmë arsyet.

A. Cilat janë rreziqet dhe sa serioze janë ato?²

Me vlera të Këshillit të Evropës kemi parasysh ato vlera që shprehen në Statutin e Organizatës dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut – veçanërisht ato që kanë të bëjnë me paqen, demokracinë, të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës. Ne mendojmë se këto vlera kërcënohen nga mungesa në rritje e tolerancës dhe dukuri të tjera të ngjashme, të cilat jepen më poshtë.

1. Mungesa në rritje e tolerancës

Kjo është dukuria që na alarmon më shumë dhe duket se shfaqet në trajtimin armiqësor dhe diskriminues që i bëhet pjesëtarëve të grupve të ndryshme në Evropë sot. Ne nuk pretendojmë se kemi hartuar një listë shteruese të këtyre grupeve. Për shembull, ne jemi të ndërgjegjshëm që personat lezbikë, gej, biseksualë dhe transhender (LGBT) përballen me paragjykime të rënda, armiqësi dhe diskriminim të përhapur në mbarë Evropën, dhe se në veçanti e drejta për lirinë e mbledhjes dhe atë të shprehjes së këryre personave çenohet në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës.³ Jemi gjithashtu të vetëdijshëm se grupe të tjera minoritare, përfshirë këtu minoritetet kombëtare dhe fetare, janë gjithashtu viktimë e formave të ndryshme të diskriminimit në mbarë Evropën, por në mënyrë të veçantë vërejmë përhapjen e mungesës së tolerancës dhe armiqësisë kundër grupeve të mëposhtme.

a. Romët

Romët, bashkë me Sinti-t (një grup shumë i ngjashëm të cilët erdhën në Evropë nga India gjatë Mesjetës), përbëjnë minoritetin më të madh në Evropë, 10 deri në 12

2. Në këtë pjesë kemi shfrytëzuar një shumëllojshmëri shembujsh nga të gjitha rajonet e Evropës. Megjithatë, kemi vendosur të mos japim emra apo të veçojmë shtete të caktuara anëtare. Ka shumë organe të tjera që e bëjnë një gjë të tillë, si organet e Këshillit të Evropës dhe të institucioneve të tjera, të cilave ne i referohemi. Qëllimi ynë këtu është të përshkruajmë dhe analizojmë prirjet që vihen re në një numër të madh shtetesh dhe të cilat kërkojnë reagim me shqetësim dhe vigjilencë nga të gjitha shtetet anëtare.

3. Diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identiteti gjinor, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, raport, mars 2010.

milion njerëz në të gjithë kontinentin, dhe kanë qenë të pranishëm për shumë shekuj në pothuajse të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Në disa shtete ata përbëjnë rreth 10% të popullsisë. Ndryshe nga minoritetet e tjera, ata nuk janë “të sapoardhur” dhe nuk kanë një “atdhe” të përcaktuar në të cilin mund të aspironin për vetëvendosje. Pjesa më e madhe e tyre janë qytetarë të shteteve evropiane.⁴ Ata nuk kanë një besim fetar të përcaktuar dhe as një “shtet vëlla” i cili mund t’i ofronte atyre mbështetje apo të fliste në emër të tyre. Ata dallohen nga pjesa tjetër e popullsisë pjesërisht nga paraqitja e tyre fizike, por kryesisht nga kultura dhe traditat e tyre (ndonëse pjesa më e madhe e tyre nuk janë më nomadë), dhe mbi të gjitha nga përjashtimi i tyre shoqëror. Në çdo shtet, të ardhurat e tyre mesatare, niveli arsimor dhe shkalla e punësimit i vendosin ata në fund të hierarkisë shoqërore. Asnjë grup tjetër nuk përjeton nivele kaq të larta diskriminimi dhe paragjykimi dhe asnjë shtet evropian nuk mund të jetë krenar për mënyrën se si i trajton ata. Gjendja e tyre është një turp për gjithë kontinentin dhe përbën një nga cënimet më të vazhdueshme nga ana e evropianëve të atyre që ne na pëlqen t’i quajmë “vlera evropiane”.

Romët janë në shumë raste ende viktime të mungesës së tolerancës, diskriminimit dhe mospranimit, të cilat rrjedhin nga paragjykime të rrënjësura, të cilat në disa raste vihen në dukje apo nxiten nga anëtarë qeverish apo zyrtarë të tjerë të zgjedhur, të cilët bëjnë deklarata publike në të cilat shprehen, për shembull, se Romët janë “gjenetikisht të prirur për kryer krime”. Shumë shpesh ata perceptohen në mënyrë negative nga pjesa më e madhe e popullsisë. Ashtu siç ka vënë në dukje Komisioneri për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, Thomas Hammarberg, “duhet pranuar se një aspekt kryesor i gjendjes së rëndë shoqërore të Romëve është shkalla e lartë e frymës kundër Romëve”.⁵

Në disa shtete anëtare (veçanërisht ato të cilat më parë kishin ekonomi të planifikuara) shkalla e papunësisë së Romëve aktualisht është rreth 80% – dhe 90% për gratë. Romët janë të parët që shkarkohen nga puna kur punëdhënësve ju duhet të reduktojnë numrin e punonjësve. Në shumë shtete ata kanë mundësi të kufizuara për arsimim, strehim dhe kujdes shëndetësor, në një mënyrë të tillë që shfaq prova të qarta për diskriminim. Romët shpesh jetojnë në kushte të mjerueshme, në banesa ku mungon uji i pijshëm, energjia elektrike apo kanalizimet e ujërave të zeza, dhe në zona ku ende ofrohet shërbim shëndetësor i kufizuar. Sipas grupeve të interesit të Romëve, bashkitë përdorin teknika të ndryshme për të bërë të pamundur që Romët të banojnë në lagje urbane të preferuara. Mundësia për arsimim është gjithashtu një shqetësim serioz në disa shtete anëtare. Braktisja e shkollës nga fëmijët Romë është në nivele jashtëzakonisht të larta, duke shtuar kështu rrezikun që ata të shndërrohen në viktime të trafikimit. Ka gjithashtu raste kur kryetarët e bashkive refuzojnë rregjistrimin në shkollë të fëmijëve prindërit e të cilëve jetojnë në kampe të paligjshme. Në disa vende, fëmijët Romë ndahen nga pjesa tjetër e popullsisë për qëllime arsimore, si për shembull duke u vendosur, në numër të lartë, në shkolla të veçanta për fëmijë me probleme mendore.

Si pasojë, pjesëmarrja e Romëve në jetën publike dhe politike në mbarë Evropën është e kufizuar. Në disa raste atyre u mohohet e drejta për të votuar sepse nuk janë të

4. Shënim: në këtë raport, nëse nuk shprehet në formë tjetër, shprehja “shtete evropiane” përdoret për 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

5. Komisioneri për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, Raporti i katërt tremujor 2010, shkurt 2011.

pajisur me çertifikata lindjeje, letërnjoftime apo vendbanim të rregjistruar. Ata mbeten jashtëzakonisht të papërfaqësuar në organet e zgjedhura, si dhe në kategoritë profesionale të nivelit të lartë, si për shembull juristë, mjekë dhe punonjës policie. Në disa shtete anëtare, kohët e fundit është vënë re një rritje e akteve të dhunshme dhe sulmeve fizike kundër Romëve.

Veçanërisht që prej zgjerimit të Bashkimit Evropian në vitin 2004 dhe 2007, një numër i madh Romësh kanë emigruar, në kërkim të një pune dhe kushteve më të mira të jetesës, nga Evropa lindore në atë perëndimore – ku, në pjesën më të madhe të rasteve ata nuk kanë gjetur mikpritje. Pavarësisht se janë qytetarë të Bashkimit evropian, ata janë kërcënuar, dhe në disa raste i janë nënshktruar kthimit në vendet e tyre të origjinës.

b. “Emigrantët” dhe azilkërkuesit

Kemi përdorur thonjëzat sepse, ndërkohë që “emigrantë” është termi që përdoret më shpesh nga njerëzit që shfaqin armiqësi nga këtij grupi, individët të cilëve ata u referohen shpesh nuk janë emigrantë në bazë të ndonjë përkufizimi ligjor apo teknik të termit. Në fakt, ekziston pak ose aspak paragjykim kundër të huajve të cilët vijnë të jetojnë ose të punojnë në një shtet ku ata nuk dallojnë nga pamja e jashtme nga pjesa më e madhe e banorëve të atij shteti, flasin të njëjtën gjuhë, kanë përgjithësisht të njëjtën mënyrë jetese dhe janë në gjendje të nxjerrin të ardhurat për të jetuar. Megjithatë, njerëzit, pamja apo mënyra e jetesës të të cilëve i dallon ata qartësisht nga pjesa më e madhe e popullsisë, shpesh emërtohen “emigrantë” edhe kur ata, madje në disa raste prindërit dhe gjyshërit e tyre, kanë lindur në atë vend dhe kanë kaluar aty gjithë jetën. Këta njerëz shihen si pjesë e një grupi që po rritet vazhdimisht dhe shpesh konsiderohet si kërcënim për popullsinë vendase dhe mënyrën e saj të jetesës. Në këtë grup përfshihen edhe azilkërkuesit - të cilët shpesh në media etiketohen si “fallco” dhe si “qylaxhinj” – dhe ndonjëherë konsiderohen si njerëz të cilët janë pranuar si refugjatë për shkak të përndjekjes në vendet e tyre.

Qëndrime të përhapura ndaj emigrantëve

Këndvështrimet e mëposhtme për emigrantët konsiderohen si të përhapura, mbështetur në një sërë pyetësorësh, takimesh dhe studimesh në terren në disa shtete evropiane, të realizuara për botimin e Këshillit të Evropës *Migrantët dhe pasardhësit e tyre – Udhërrëfyes për politikën e mirëqënies së të gjithëve në shoqëri pluraliste*.⁶

- i. “Emigrantët shkaktojnë rritjen e nivelit të kriminalitetit.” Kjo përsëritet gjerësisht nga media, zyrtarë dhe disa “ekspertë të sigurisë” dhe pranohet pa ngurrim nga një pjesë e madhe e popullsisë me shpreje të tilla si: “emigrantët, veçanërisht emigrantët e paligjshëm, janë kriminelë”; “emigrantët zbatojnë ligjin më pak se vendasit”; “emigrantët janë përgjegjës

6. *Migrantët dhe pasardhësit e tyre – Manual politikash për mirëqenien e të gjithëve në shoqëritë pluraliste*, Botim i Këshillit të Evropës, dhjetor 2010.

për pjesën më të madhe të krimeve që ndodhin në vend”; “ata vijnë në vendin tonë për të kryer krime” dhe “tani që ata janë këtu, qytetet dhe rrugët tona janë më pak të sigurta”.

- ii. *“Emigrantët sjellin sëmundje në vend”*, ose “emigrantët e kanë fajin për rikthimin e disa sëmundjeve të cilat u zhdukën dekada më parë në Evropë”. Mbështetësit e këtyre argumenteve pretendojnë se emigrantët e parregullt apo pa dokumentet e nevojshme dhe fëmijët e tyre shpesh vuajnë nga një shëndet më i dobët se pjesa tjetër e popullsisë dhe disa sëmundje infektive dhe të transmetueshme shfaqen më shpesh në komunitetet e emigrantëve sesa në popullsinë vendase.
- iii. *“Punëtorët emigrantë na marrin vendin e punës.”* Ky mendim është jashtëzakonisht i përhapur në shoqëritë evropiane, veçanërisht tek punëtorët, në ata sektorë ku ka një numër të madh emigrantësh. Kjo nuk vlen vetëm për emigrantët në kuptimin e ngushtë të fjalës por edhe për fëmijët e tyre, i ashtuquajtur brezi i dytë, të cilët ende konsiderohen “jo pjesë e kombit” për shkak të paraqitjes së tyre fizike, kulturës dhe lidhjeve familjare.
- iv. *“Punëtorët emigrantë na ulin rrogat.”* Shumë njerëz të cilët pranojnë se nuk ka fakte se emigrantët dhe vendasit janë në konkurrencë të drejtpërdrejtë për vende pune, i mëshojnë gjithsesi idesë se me praninë e tyre, emigrantët ulin rrogat. Ky qëndrim mbahet veçanërisht në vendet e punës dhe madje në sindikatat e punëtorëve, të paktën nga anëtarët e thjeshtë të tyre.
- v. *“Emigrantët abuzojnë me përkrahjen sociale.”* Emigrantët dhe familjet e tyre akuzohen se abuzojnë me shërbimet e ofruara nga përkrahja sociale në tre mënyra. Së pari, pretendohet se ata shfrytëzojnë në mënyrë të tepruar dhe të padrejtë shërbimet dhe asistencën publike, për të cilat besohet se kanë mundësi shfrytëzimi më të shumta, më liberale dhe më pak të rregulluara se qytetarët e tjerë. Së dyti, pretendohet se përftojnë shërbime të cilat nuk i takojnë ligjërisht dhe si rrjedhojë mashtrojnë në dëm të popullsisë vendase. Së treti, pretendohet se gjatë qëndrimit të tyre, i cili mendohet të jetë i përkohshëm dhe i nxitur kryesisht nga dëshira për të përfutur nga përkrahja sociale evropiane, ata më shumë i marrin sesa i japin ekonomisë së vendit.
- vi. *“Emigrantët sillen sikur vendi i përket atyre.”* Ky qëndrim mbahet më shumë nga njerëzit e moshuar, të cilëve i është krijuar përshtypja se të ardhurit nuk i respektojnë ata, se mënyra e tyre familjare e të jetuarit është duke u çrrënjësuar dhe se kultura dhe mënyra e jetesës së “emigrantëve” respektohet më shumë se e jona”.
- vii. *“Emigrantët ndërtojnë shoqëri paralele.”* Emigrantët përshkruhen shpesh si një grup shoqëror dhe politik i huaj për pjesëtarët e shoqërisë pritëse. I kushtohet vëmendje rasteve kur ata sillen si një komunitet i mbyllur dhe i izoluar, dhe i kushtohet shumë më pak vëmendje rasteve kur ata janë të hapur dhe kërkojnë të vendosin marrëdhënie miqësore me pjesëtarët e grupeve të tjera. Pretendime tipike janë se “ata duan të qëndrojnë vetëm”, “ata nuk kanë dëshirë të integrohen”, “ata nuk mund të flasin gjuhën tonë” dhe “ata duan vetëm të drejta dhe jo detyrime”.

- viii. *“Fëmijët e emigrantëve po ulin standardin në shkollat tona.”* Thuhet se fëmijët e emigrantëve “kanë rezultate të ulëta në shkollë sepse prindërit e tyre nuk kanë aftësinë dhe arsimimin për t’i rritur ata në mënyrën e duhur”, dhe shpesh fajësohen për vështirësitë e tyre: “ata nuk flasin gjuhën e vendit pritës”; “ata regjistrohen në shkollë në mes të vitit shkollor”; dhe “ata nuk dinë se cilës kulturë i përkasin vërtet”.
- ix. *“Gratë emigrante jetojnë si minoritet.”* Emigrantët jo-evropianë shpesh konsiderohen si “të prapambetur” për sa i përket civilizimit në përgjithësi dhe barazisë gjinore në veçanti. Tani ky paragjykim është kryesisht për myslimanët dhe arabët.

Mund të ketë një farë të vërtete në disa nga këto pohime, në disa kontekste të veçanta. Do ta shqyrtojmë këtë çështje kur të trajtojmë burimet e rreziqeve. Megjithatë, të gjitha janë përgjithësime gjithëpërfshirëse që përdoren në mbarë Evropën, si në diskutime private ashtu edhe në ato publike. Së bashku, ato shprehin një armiqësi të thellë ndaj një kategorie shumë të gjerë njerëzish, dhe si rrjedhojë, këta të fundit mund të vuajnë si në aspektin moral ashtu edhe në atë material.

c. Myslmanët

Rritja e qëndrimeve negative ndaj myslimanëve në Evropë konfirmohet nga sondazhet e kryera nga Projekti Pew Global Attitudes.⁷ Në disa shtete evropiane, përqindja e personave të intervistuar të cilët kanë ose mendim “disi negativ” ose “shumë negativ” për myslimanët është rritur ndjeshëm midis viteve 2004-05 dhe 2010 ose, në raste të veçanta, ka mbetur në nivele të larta, në disa raste rreth 50%.

Sondazhe të tjera të kryera në Evropë konfirmojnë mbizotërimin e mendimeve negative për minoritetet myslimane. Feja islame perceptohet nga shumë evropianë madje si një rrezik kryesor për Evropën, pasi ata e ndiejnë se ky minoritet është në rritje dhe se Islami nuk përputhet me “jetën moderne evropiane”.

Raporti i vitit 2009 i Agjensisë për të Drejtat Themelore të BE-së konfirmon se kjo ndjenjë e vazhdueshme anti-myslimane në mbarë Evropën nuk kufizohet me shprehjen e mendimit. Një në tre myslimanë që morën pjesë në sondazh thanë se ata e kishin përjetuar diskriminimin dhe 11% u shprehën se kishin qenë viktimë të krimeve (sulme fizike, kërcënime apo ngacmime të rënda) personale për arsye racore, të paktën një herë në 12 muajt e fundit. Nivelet më të larta të diskriminimit gjendeshin në fushën e punësimit dhe shërbimeve të ofruara nga sektori privat.⁸ Sondazhe të tjera flasin gjithashtu për numër gjithmonë e më të madh sulmesh dhe rastesh diskriminimi kundër myslimanëve, si dhe mitingje apo mbledhje publike ku transmetohen mesazhe anti-myslimane.

7. Rritja e mendimeve negative ndaj hebrenjve dhe myslimanëve në Evropë, raporti i përgatitur nga Pew Global Attitudes Project, shtator 2008.

8. European Union Minorities and Discrimination Survey (EU-MIDIS) – Data Focus Report/Muslims, Agjensia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2009.

Shumë vëzhgues dhe organizata, përfshirë këtu Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës,⁹ janë të mendimit se ka një rritje drastike të armiqësisë kundër myslimanëve në mbarë Evropën. Ata shpesh përdorin termin “Islamofobi” për të përshkruar këtë dukuri. Kemi zgjedhur të mos përdorim këtë term në raportin tonë pasi kjo mund të perceptohet sikur nënkupton se Islami si i tillë duhet të përjashtohet nga kritika, apo që ata të cilët e kritikojnë atë janë domosdoshmërisht të motivuar nga paragjykime racore apo fetare. Ne nuk mbështesim këtë pikëpamje pasi besojmë se në një shoqëri të lirë dhe pluraliste njerëzit duhet të jenë të lirë të kenë çdo lloj besimi apo asnjë besim dhe të shprehin mendimet e tyre rreth Islamit, ashti si edhe për çdo besim tjetër fetar. Njëkohësisht, është e rëndësishme të vihet në dukje se përshkrimet e shtrembëruara apo të pasakta të besimeve apo praktikave fetare, apo deklaratat se ato të grupeve apo individëve të caktuar janë karakteristike për një fe në tërësi, janë shpesh shprehje paragjykimi dhe ndihmojnë gjithashtu për ta përhapur atë. Deklaratat për besimin apo praktikën hebreje, për shembull, kanë qenë historikisht një mjet kryesor për anti-Semitizmin; shumë deklarata të ditëve të sotme rreth Islamit duket se përfshihen në të njëjtën kategori.

Partitë e ekstremist të djathtë (shih më poshtë) kanë shfrytëzuar me shumë sukses frikën nga terrorizmi (veçanërisht pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit të vitit 2001 në Shtetet e Bashkuara, 15 dhe 20 nëntorit të vitit 2003 në Stamboll, 11 marsit të vitit 2004 në Madrid, 7 korrikut të vitit 2005 në Londër, si dhe një sërë sulmesh të ngjashme në Federatën Ruse) dhe ndryshimet demografike (rritja e popullsisë myslimane në shumë shtete të Evropës, kryesisht nëpërmjet emigracionit. Edhe në shumë parti kryesore, kritikën ndaj Islamit janë bërë të shpeshta, për të mos thënë se janë kthyer në standard. Duke qenë se rritja e numrit të emigrantëve myslimanë në Evropë dekadat e fundit ka sjellë ekzistencën e komuniteteve myslimane më të “dukshme” dhe ka përkuar me rritjen e Islamit politik, shumë evropianë kanë krijuar bindjen se Islami në vetvete është radikal, militant dhe që nuk përputhet me vlerat evropiane, dhe si rrjedhojë emigrantët myslimanë dhe pasardhësit e tyre nuk mund të integrohen në shoqëritë evropiane ashtu siç janë integruar valët e mëparshme të emigrantëve.

Në tetor të vitit 2010, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës deklaroi se këto paragjykime “ndërthuren me qëndrime raciste – të drejtuar kundër njerëzve me origjinë nga Turqia, vendet arabe dhe Azia Jugore. Myslimanët nga këto vende diskriminohen në tregun e punës dhe në sistemin arsimor në disa shtete evropiane. Ekzistojnë raporte sipas të cilave ata i nënshtrohen kontrolleve të përsëritura për dokumentacion dhe kërkimeve të bezdishme nga ana e policisë. Ky është një problem serioz për të drejtat e njeriut”.¹⁰

d. Hebrenjtë

Anti-Semitizmi ka pllakosur botën për shekuj me radhë. Në Evropë, ai është një tipar i thellë kulturor, i cili në shekullin e 19-të gjeti shprehje të veçantë politike në kuadrin

9. Islami, Islamizmi dhe Islamofobia në Evropë, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, raport, Maj 2010.

10. Komisioneri për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës, Komenti për të Drejtat e Njeriut, 28 tetor 2010.

e një nacionalizmi etnik, si dhe teorive raciste të zhvillimit njerëzor. Kjo gjë kulmoi me ideologjinë e nacional socializmit. Kur arriti ekstremin e tij më të dhunshëm, Holokausti, anti-Semitizmi shkaktoi vdekjen e gjashtë milion hebrenjve dhe vuajtje për shumë e shumë të tjerë. Forma më të lehta, me karakter më të ulët gjenocidi, por përsëri forma negative anti-Semitizmi, kanë shkatërruar jetë, kanë asgjësuar komunitete fetare, kanë krijuar ndarje shoqërore dhe politike, si dhe kanë ndërlikuar marrëdhëniet midis shteteve dhe punën e organizatave ndërkombëtare.

Megjithëse mendimet negative për hebrenjtë janë më të pakta në Evropë krahasuar me disa pjesë të tjera të botës, vitet e fundit ato janë rritur, në bazë të të dhënave të Pew Global Attitudes Project.

Një sondazh i kryer në vitin 2009 në disa shtete evropiane nga Lidhja Kundër Shpifjes flet gjithashtu për tendencën alarmante të fajësimit të hebrenjve në industrinë financiare për krizën ekonomike globale në ditët e sotme. Një pjesë tjetër beson se hebrenjtë kanë “tepër pushtet” në biznes dhe financa dhe nuk janë besnikë ndaj vendit të tyre.¹¹

Në Evropën Perëndimore në përgjithësi, grupet tradicionale të ekstremit të djathtë janë ende përgjegjëse për një pjesë të madhe të sulmeve ndaj hebrenjve dhe pronave të hebrenjve, por vitet e fundit këto sulme kryhen gjithmonë e më shumë nga të rinj myslimanë.

Në Evropën Lindore, ekstremistët dhe anëtarët e grupeve politike radikale janë përgjegjës për pjesën më të madhe të incidenteve anti-semite.

e. Të krishterët

Në pjesën më të madhe të shteteve evropiane, aty ku Krishtërimi ka qenë feja mbizotëruese në pothuajse mijëvjeçarin e fundit, pjesa më e madhe e popullsisë ose është e krishterë ose ka prejardhje të krishterë dhe mendimi i përgjithëm publik për të krishterët është kryesisht pozitiv. Megjithatë, ka disa shtete evropiane, përgjithësisht shtete me shumicë myslimane, ku të krishterët ende përjetojnë disa forma diskriminimi ose janë viktimat të armiqësisë dhe dhunës së herëpashershme për arsye fetare por edhe etnike (sulme fizike, sulme kundër kishave, kufizime të lirisë së mbledhjes dhe lirisë së shprehjes).

Ambasadori Janez Lenarčič, Drejtor i Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE-ODIHR), deklaroi në mars të vitit 2009 se “mungesa e tolerancës dhe diskriminimi kundër të krishterëve manifestohen në forma të ndryshme në zonën e OSBE-së. Ndërkohë që mohimi i të drejtave mund të jetë një çështje e rëndësishme atje ku të krishterët përbëjnë pakicë, përjashtimi dhe marginalizimi mund të përjetojnë gjithashtu nga të krishterët atje ku ata përbëjnë shumicën në shoqëri”.¹²

11. Shih: www.adl.org/PresRele/ASInt_13/5465_13.htm.

12. Tavolina e rrumbullakët e OSBE-ODIHR me temë “Mungesa e Tolerancës dhe Diskriminimi kundër të Krishterëve: Fokusimi tek Përjashtimi, Margjinalizimi dhe Mohimi i të Drejtave”, mars 2009.

Dukuritë e tjera që jepen në vazhdim janë deri diku të gjitha rezultat i mungesës së tolerancës dhe paragjykimit, por kanë gjithashtu tendencën për t'i përkeqësuar ato, në një sërë rrathësh viciozë që përforcojnë njëri tjetrin.

2. Rritja e mbështetjes për partitë ksenofobike dhe populiste

Në pjesën e mësipërme dhamë një përshkrim të shkurtër dhe skematik të paragjykimit popullor kundër disa grupeve të caktuara të popullsisë. Në këtë pjesë, marrim në shqyrtim partitë politike në pjesë të ndryshme të Evropës që kanë lindur apo ato për të cilat mbështetja është rritur në mënyrë të konsiderueshme, duke i përfaqësuar politikisht këto paragjykime dhe duke i nxitur ato. Lindja e këtyre partive, dhe impakti i tyre në politikën “kryesore” është ndoshta dukuria që ka shkaktuar më shumë shqetësim tek liberalët evropianë, duke nxitur kështu frikën se “natyra demokratike” e Evropës mund të jetë në rrezik.

Pa dyshim, në peizazhin politik të Evropës po ndodhin ndryshime të mëdha shoqërore dhe ideologjike. Nga Evropa e Veriut deri në Mesdhe vihet re një valë populizmi radikal. Partitë në fjalë përgjithësisht i përkasin spektrit politik të djathtë apo ekstremit të djathtë, por do të ishte gabim t'i klasifikonim ato si neo-fashiste. Pavarësisht se ka elementë që i lidhin ato me lëvizjet “tradicionale” neo-naziste apo neo-fashiste të Evropës së pas luftës, të cilat përgjithësisht mbetën një dukuri e kufizuar, partitë e reja kanë një bazë shumë më të gjerë, duke u shtrirë thuajse në të gjitha shtresat e shoqërisë, pavarësisht nivelit arsimor, gjinisë apo statusit. Ato mund të tërheqin pothuajse të gjitha ata që ndiejnë se mjetet apo mënyra e tyre e jetesës kërcënohet nga kriza ekonomike dhe nga emigracioni. Në fakt, disa prej tyre i ndërthurin këto qëndrime ksenofobike me pëlqimin e tyre për liberalizmin social, mbrojtjen e shtetit social dhe, me sa duket, politika ekonomike të krahut të majtë (si dhe qëndrime shumë pozitive ndaj Izraelit). Në Evropën Perëndimore, armiqësia ndaj emigracionit është tema e tyre kryesore. Në shumë shtete të Evropës qendrore dhe lindore, shqetësime të ngjashme vihen re kundër Romëve dhe në disa raste kundër minoriteteve kombëtare, përfshirë hebrenjtë.

Muajt e fundit, partitë anti-emigracion kanë pësuar një rritje të madhe, edhe në vende të cilat shquhen për politikë liberale dhe elektorat tolerant. Gjatë dy viteve të fundit, rezultatet e zgjedhjeve dhe të dhënat e sondazheve në shumë shtete evropiane kanë treguar një rritje të mbështetjes nga ana e votuesve për lëvizje të cilat pretendojnë se mbrojnë interesat dhe kulturën e shumicës “vendase” kundër emigracionit dhe përhapjes së Islamit. Ndonëse jo ende shumicë, këto parti janë një forcë në rritje në politikën evropiane. Në disa shtete ato madje kanë dalë si parti të dyta me rreth 30% të votave; në disa raste duke i pamundësuar rivalëve të tyre formimin e një shumice qeverisëse, duke siguruar kështu formimin e një qeverie që është e varur nga mbështetja e tyre, apo edhe duke marrë pjesë në koalicione qeverisëse. Gjithmonë e më shumë, suksesi i tyre elektorat i nxit politikanët e partive politike kryesore të garojnë me ta në retorikën kundër emigracionit apo atë ksenofobike, gjë që legjitimon dhe ndikon në përhapjen e qëndrimeve raciste në popullsi.

3. Diskriminimi

Paragjykimi ndaj emigrantëve, njerëzve me origjinë emigranti të kohëve të fundit dhe pjesëtarëve të minoriteteve, reflektohet shpesh në diskriminim, ku njerëzve në fjalë u mohohen shërbimet apo të mirat të cilat u takojnë, dhe të cilat u ofrohen pjesëtarëve të grupeve të tjera. Ky lloj trajtimi shërben për armiqësimin dhe izolimin e tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë. Kjo është në kundërshtim me parimet themelore për të cilat janë angazhuar të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, dhe përbën në vetvete një nga pengesat më serioze për krijimin dhe mbajtjen e shoqërive të hapura dhe harmonike në Evropë. Diskriminimi duket se është veçanërisht i përhapur dhe ka efekte shumë të dëmshme në fushat e mëposhtme: punësim; strehim; arsimim; shërbimet shëndetësore dhe ato sociale; si dhe veprimet nga ana e policisë dhe gjykatave.

Punësimi. Në thuajse të gjitha shtetet evropiane, shkalla e papunësisë tek Romët, emigrantët dhe njerëzit që perceptohen se kanë origjinë të huaj, është shumë më e lartë se shkalla e papunësisë së popullsisë së përgjithshme. Kjo nuk është gjithmonë pasojë e diskriminimit të drejtpërdrejtë nga ana e punëdhënësve, pasi në disa raste ajo është shkaktuar nga falimentimi i bizneseve, veçanërisht atij të ndërtimit, në të cilën punonin përgjithësisht emigrantët; nga zbatimi i politikës se kush punësohet i fundit largohet i pari; apo në rastin e Romëve, me zhdukjen e bizneseve tradicionale të tyre, si dhe me ndarjen në vendbanime të veçanta, i cili është tipar i përjashtimit të tyre shoqëror. Në disa vende, edhe kur rastet e veçanta të diskriminimit racor gjatë marrjes në punë janë përcaktuar nga gjykatat, organizatat joqeveritare kundër racizmit mendojnë se ndëshkimet nuk janë gjithmonë bindëse, veçanërisht kur bëhet fjalë për korporata të mëdha; ndërsa në vende të tjera, punësimi vazhdon të jetë sfera e jetës shoqërore ku vërehet më shumë diskriminimi.

Strehimi. Raportet nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Mungesës së Tolerancës të Këshillit të Evropës vënë në dukje me shqetësim se, sipas disa burimeve, diskriminimi racor i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë ndaj emigrantëve, personave me origjinë emigranti dhe grupeve të tjera të dallueshme minoritare, mbetet problem, si në sektorët privatë, ashtu dhe në ata publikë të strehimit, në disa shtete evropiane. Edhe në ato shtete ku diskriminimi në lidhje me strehimin mbështetet tek përkatësia etnike, OJQ-të raportojnë se disa bashki zbatojnë rregulloret bashkiake në mënyrë të tillë që diskriminojnë disa grupe të pafavorizuara sociale, përfshirë këtu rastet kur vendimet për strehimin merren në bazë të reputacionit të aplikuesit apo familjes së tij/saj në vendbanimet e mëparshme.

Strehimi. Ky konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për të luftuar racizmin dhe mungesën e tolerancës, por ai shihet gjithashtu si një fushë ku racizmi dhe diskriminimi racor dhe ai fetar mund të ekzistojë, me pasoja të dëmshme për fëmijët dhe gjithë shoqërinë. Kemi përmendur tashmë gjendjen e fëmijëve Romë, të cilët në disa raste arsimohen në shkolla të veçuara apo në shkolla për fëmijë me probleme mendore. Në disa shtete evropiane duket se ka gjithashtu një përfaqësim jo në përpjestim të drejtë të fëmijëve me prejardhje emigranti në disa shkolla, gjë që lidhet dukshëm me formimin e zonave geto dhe me rezultatet më të dobëta në shkollë të fëmijëve emigrantë apo fëmijëve me prejardhje emigranti.

Përfitimet dhe shërbimet sociale. Hartuesit e politikave shpesh përpiqen të reagojnë ndaj ankesave se emigrantët janë duke bërë abuzime, apo duke shkaktuar një barrë jo të përshtatshme për ndihmat sociale, duke përcaktuar kufizime për mundësinë e emigrantëve për të marrë përfitime apo shërbime – për shembull duke e kushtëzuar atë me një numër shumë të madh kriteresh, si kohëzgjatja e qëndrimit (zakonisht jo më pak se pesë vjet); statusi ligjor (përfshirë lejen e punës dhe si rrjedhojë e zotërimit e të ardhurave), kombësinë, dëshminë se nuk kanë kryer vepra penale, kufizimi vetëm për shërbime thelbësore ose urgjente; duke i bërë testet për të ardhurat më strikte se për pjesën tjetër të popullsisë. Edhe atje ku banorët e huaj formalisht gëzojnë të njëjtat të drejta si të tjerët, klima është shpesh kaq armiqësore dhe vështirësitë burokratike aq të mëdha sa ata ngurrejnë të aplikojnë që në fillim. Në fakt, edhe në pikat e hyrjes në një shtet, vetëm fakti se dikush ka nevojë për asistencë sociale shërben si arsye e mjaftueshme për të mos i pranuar ata.

Policia dhe gjykatat. Raportohet se emigrantët apo pjesëtarët e minoriteteve i nënshtrohen jo në përpjestim të drejtë kontrolleve policore në disa shtete evropiane dhe në disa raste abuzohen verbalisht në mënyrë raciste, ngacmohen apo edhe abuzohen fizikisht nga zyrtarët e zbatimit të ligjit. Fakti që këto grupe i nënshtrohen më shpesh ndalimeve dhe kontrolleve rrit mundësinë që ata të përfundojnë para organeve të sistemit të drejtësisë. Në të vërtetë, këto grupe duket se përbëjnë numrin më të madh në thuajse të gjitha burgjet e Evropës. Gjithsesi, “çështja e diskriminimit dhe drejtësisë është një nga çështjet politike kryesore, së cilës ende nuk i është kushtuar shumë rëndësi”, sipas Sebastian Roche, i cili ka studiuar diskriminimin gjyqësor si drejtor i studimeve për Qendrën Kombëtare Franceze të Studimeve Shkencore. Ai shton gjithashtu se “nuk mund të fajësojmë një shtet nëse kompanitë e tij kryejnë diskriminim; megjithatë, ne mund të fajësojmë shtetin nëse sistemi i tij i drejtësisë dhe policia e këtij shteti kryejnë diskriminim”.¹³

Duket qartë nga raportet e shteteve të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës se në disa vende, minimalisht, policia nuk është aktive sa duhet në regjistrimin e ankesave të viktimave të sulmeve raciste apo gjuhës së urrejtjes. Ata shpesh refuzojnë të marrin ankesat ose nuk i regjistrojnë ato në mënyrën e duhur. Në raste të tjera, viktimat që i përket një minoriteti të dukshëm, i cili ka shkuar në polici për t’u ankuar për një veprim racist, gjendet në një situatë të vështirë sepse policia, në vend që të kryejë hetime lidhur me sjelljen e autorit të pretenduar të veprimeve raciste, fillon të ngacmojë viktimën. Për më tepër, punonjësit e policisë të cilët akuzohen për sjellje jo etike kundër emigrantëve apo pjesëtarëve të grupeve të minoriteteve etnike nuk procedohen gjithmonë, dhe më rrallë procedohen në mënyrë të suksesshme.

4. Prania e një popullsie pothuajse pa të drejta

Pothuajse të gjitha shtetet evropiane, të gjendur nën tryshninë e opinionit publik, kanë bërë gjithçka kanë mundur për të kontrolluar emigracionin dhe për ta kufizuar atë për disa kategori njerëzish. Sigurisht që ata kanë të drejtë të bëjnë një gjë të tillë. Megjithatë, duke qenë se prosperiteti relativ i Evropës dhe tkurrja e fuqisë punëtore

13. Cituar në *Washington Post*, 29 prill 2008.

vazhdojnë të krijojnë mundësi punësimi, të cilat joshin për të ardhur një numër gjithmonë e më të madh emigrantësh, efekti është ai i krijimit të migracionit të paligjshëm, pasi njerëzit i shmangen kontrolleve dhe fitojnë të drejtën e qëndrimit në kontinent, qoftë kjo e përkohshme apo e përhershme. Kjo shkakton një situatë e cila është e vështirë të jetë në përputhje me qëndrimin e Evropës për të mbështetur të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës. Emigrantët “e paligjshëm”, “të parregullt” apo “pa dokumente” shkaktojnë një ekzistencë gjysmë-klandestine, gjë gjë vështirëson mbledhjen e të dhënave të sakta, por sigurisht që numri i tyre është i lartë. Disa tregues mund të merren nga të dhënat e Komisionit të BE-së, sipas të cilit, gjatë viteve 2005-07 rreth 1.4 milion njerëz u ndaluan për qëndrim të paligjshëm në vendet e BE-së dhe rreth 760 000 u deportuan. (Ka shumë pak të dhëna për shtetet jashtë BE-së por të paktën në disa prej tyre shifrat janë pothuajse të ngjashme.) Nëse supozojmë se personat e ndaluar përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të numrit të përgjithshëm, atëherë është e qartë se bëhet fjalë për një popullsi prej shumë milionësh.

Duket po ashtu qartë se kjo popullsi nuk vuan vetëm mungesën e të drejtave civile dhe politike, por në realitet edhe të drejtat më themelore të njeriut. Ata në fakt janë “pa ligjin” në kuptimin më të drejtpërdrejtë: përderisa ligji i kërcënon ata me ndalim dhe deportim, ata nuk mund të kërkojnë mbrojtjen e tij. Është e qartë se ky fakt i bën ata më tërheqës për punëdhënësit; duke pasur pak burime dhe asnjë të drejtë, ata kanë pak mundësi zgjedhjeje por të pranojnë çdo lloj pune që mund të gjejnë, pavarësisht pagesës së ulët apo faktit nëse kushtet janë të pasigurta, të pashëndetshme apo poshtëruese. Me pak fjalë, ata mund t’i nënshtrohen çdo lloj shfrytëzimi. Në të njëjtën kohë, statusi i tyre “i paligjshëm” i bën ata edhe më shumë të papëlqyer se emigrantët e tjerë nga pjesa tjetër e popullsisë - ndonëse krijohet lidhja që edhe emigrantët e tjerë janë fajtorë.

Ashtu si emigrantët e tjerë, por në një shkallë edhe më të lartë, emigrantët e parregullt mund të bëjnë disa nga punët më të rrezikshme, më të vështira dhe të pista. Ata zakonisht punojnë në ferma, në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, në sektorin e shërbimeve (restorante, hotele, shërbime shtëpiake) dhe shumë emigrante gra pa dokumente punojnë në industrinë e seksit.

Lindjet e fëmijëve të emigrantëve pa dokumente shpesh nuk regjistrohen, duke bërë që vetë fëmijët të jenë pa dokumente që në lindje. Më pas atyre mund t’u mohohet shërbimi shëndetësor apo arsimimi. Një numër gjithmonë e më i lartë duhet të flerë në rrugë. Ata mbeten veçanërisht të rrezikuar nga abuzimi nga grupet kriminale të përfshira në kontrabandë, trafikim të qenieve njerëzore dhe format moderne të skllavërisë.

Gratë emigrante përballen me kërcënime të tjera të kufizimit, humbjes së vendeve të punës dhe deprivimi nga të drejtat ekonomike dhe sociale. Shumë biznese nuk u japin të njëjtën pagë për kryerjen e të njëjtës punë dhe grave u mungon mbrojtja ligjore. Sipas të dhënave që kemi, ka gjithashtu shumë raste të dhunës kundër grave të papajisura me dokumente dhe ato janë viktimat kryesore të krimit të neveritshëm të trafikimit të qenieve njerëzore.

Megjithëse jo plotësisht pa dokumente, azilkërkuesit – nga të cilët 355 000 gjendeshin në shtetet e OSBE-së në vitin 2008, me shifra gjithmonë e në rritje në vendet e Mesdheut – janë në shumë mënyra në një situatë të ngjashme, dhe të ekspozuar ndaj

shumë prej të njëjtave rreziqeve. Kërkesa për azil perceptohet përgjithësisht nga opinionioni publik, nën nxitjen e madhe të medias, thjesht si një përpjekje për t'i bërë bisht kontrollit të emigracionit. Në shumë raste kjo mund të jetë shumë e saktë - ashtu siç është e vërtetë që rrethanat individuale ndryshojnë shumë dhe ekziston një sipërfaqe e madhe gri midis refugjatit “të pastër” politik dhe emigrantit “të pastër” ekonomik. Fatkeqësisht, shtetet evropiane kanë një tendencë të lartë për t'i trajtuar azilkërkuesit si fajtorë (se bëjnë deklaramë “fallco”) deri sa të provohet pafajësia e tyre dhe të vendosin barrën e provës tek ata, edhe pse ekzistojnë shumë arsye pse refugjatët e vërtetë politikë nuk mund të japin gjithmonë prova përfundimtare për atë çka i ka ndodhur.

Shumë azilkërkues i nënshtrohen ndalimit ndërkohë që deklaramet e tyre janë duke u verifikuar dhe madje edhe kur janë “të lirë” nuk u lejohet të punojnë dhe u jepet, në qoftë se ka, një sigurim shoqëror minimal – përsëri, kryesisht në respekt të një opinionit publik i kushtëzuar për t'i konsideruar ata “lypës”. E gjithë kjo i vendos ata në një situatë shumë të ngjashme me atë të emigrantëve pa dokumente. Të ndaluar të sigurojnë jetesën me rrugë të ligjshme, ata janë pothuajse të detyruar të përpiqen ta sigurojnë atë në rrugë joligjore; dhe çdo ankesë që ata mund të bëjnë, ka mundësi të pritët me përgjigjen se ata janë “të lirë” të kthehen në vendlindjen e tyre – një përgjigje kjo e cila paragjykon çështjen që është duke u shqyrtuar. Kështu, edhe atyre u bëhet një mbrojtje ligjore shumë e kufizuar dhe janë të rrezikuar nga shumë prej atyre abuzimeve që u bëhen emigrantëve pa dokumente. Në të dyja rastet, mungesa e alternativave ndaj ndalimit dhe prirja e ngjashme për të ndaluar çdokënd që ka hyrë në një shtet në mënyrë jo të rregullt, përfshirë këtu gratë shtatzëna dhe familjet me fëmijë të vegjël, e bëjnë situatën edhe më të vështirë për të qenë në harmoni me parimet e njohura evropiane.

Edhe atyre të cilëve u është pranuar kërkesa për azil, ose që u është dhënë “leje e përkohshme qëndrimi”, shpesh ju duhet të largohen si pasojë e kërcënimit me deportim nëse ata nuk e bëjnë një gjë të tillë “vullnetarisht”, në rast se, ose kur vendi pritës gjykon se kushtet që i detyruan ata të lënë vendin e tyre kanë ndryshuar. Gjykime të tilla janë shpesh të debatueshme, nëse mund të quhen kështu, pasi edhe kur janë të bazuara, efektet e tyre mund të jenë shumë jonjerëzore, veçanërisht kur fëmijëve që janë rritur në vendin pritës u duhet të kthehen në një shtet “amë” për të cilin ata kanë shumë pak njohuri të drejtpërdrejta.

Rrjeti Evropian kundër Nacionalizmit, Racizmit, Fashizmit dhe në Mbështetje të Migrantëve dhe Refugjatëve publikon në mënyrë të rregullt një listë të personave që humbin jetën në kufijtë e Evropës apo në kampet e ndalimit duke pritur për deportimin. Që prej vitit 1993 janë regjistruar më shumë 11 000 vdekje të tilla, me ndihmën e një numri të madh organizatash. Nuk ka dyshim që shumë prej këtyre vdekjeje ishin natyrale dhe sigurisht që jo për të gjitha ato mund të fajësohen autoritetet evropiane. Megjithatë, është e vështirë mos t'i konsiderosh këta njerëz, të paktën pjesërisht, si viktimë të mungesës nga ana e Evropës të një politike të qartë, koherente dhe njerëzore migracioni, dhe disa prej tyre si viktimë të një egërsie tronditëse që gjendet në politikën kombëtare ekzistuese. Shumë prej të cilëve janë mbytur në det për shembull mund të ishin shpëtuar nëse varkave të papërshtatshme në të cilat ndodheshin do t'ju ishte dhënë ndihmë në kohën e duhur, ashtu siç kërkohet nga e drejta humanitare ndërkombëtare. Përgjegjësia për vdekjet e tyre, në shumë

raste, duhet gjithashtu të ndahet me shtetet nga të cilat ata nisen, të cilat mund dhe duhet të kishin marrë masa më të rrepta për parandalimin e tyre.

5. Shoqëritë paralele

Fjala “geto”, e cila historikisht është përdorur për lagjen hebreje në qytete të ndryshme evropiane, sot përdoret për një zonë kompakte urbane në të cilën pjesëtarët e komuniteteve etnike, fetare, kombëtare, etj., të cilat janë minoritete në shkallë kombëtare, përbëjnë shumicë të konsiderueshme në popullsinë e zonës.

Përqëndrime të këtij lloji nuk janë gjithmonë ose domosdoshmërisht të dëmshme. Historikisht ato kanë qenë të zakonshme në shumë shoqëri dhe shpesh kanë qenë një fazë e dobishme për integrimin gradual të grupeve emigrante në një shoqëri pritëse.

Megjithatë, termi “geto” përdoret zakonisht me një kuptim më keqësues, në rastin kur një zonë pëson një ndarje të madhe nga pjesa tjetër e qytetit, ku ekziston përjashtimi (apo vetë-përjashtimi) shoqëror dhe ekonomik. Getoja tipike është një zonë e varfër brenda qytetit, me nivel të lartë papunësie dhe kriminaliteti tek moshat e reja. Nga ana tjetër, ajo mund të nënkuptojë gjithashtu një zonë, banorët e së cilës qëndrojnë të izoluar, të cilët pothuajse nuk flasin gjuhën kryesore të vendit; ku pjesëtarët e popullsisë “vendase”, nëse futen ndonjëherë aty, ndjehen jo të mirëpritur dhe të pasigurtë, ndërkohë që shkollat e zonës shpesh mbushen vetëm me fëmijë që i përkasin minoriteteve, dhe atyre i mungojnë burimet për të siguruar që fëmijët e tyre të jenë plotësisht të rrjedhshëm në gjuhë dhe të njohin gjuhën kombëtare. Kjo është bërë një strukturë e njohur në qytetet e Evropës perëndimore dhe ndikon shumë në frikën dhe zemërimin ndaj emigrantëve dhe minoriteteve, e cila shprehet nga shumë evropianë.

Zemërimi shtohet më tej nga besimi që ekziston se këto komunitete kanë zgjedhur të vetëizolohen dhe qëllimisht kërkojnë të jetojnë në një shoqëri “paralele”, duke minimizuar kontaktet me pjesën tjetër të popullsisë, ndërkohë që “kolonizojnë” gradualisht pjesë nga qyteti – ndonëse, të paktën në disa raste, pjesëtarët e komunitetit në fjalë ndiejnë se është shoqëria pritëse që i ka refuzuar dhe izoluar ata.

Në realitet, getot dhe shoqëritë paralele janë dy dukuri të veçanta, të cilat ndonjëherë por jo gjithmonë gjenden së bashku. Në shumë raste getoja nuk është monoetnike, por përfshin disa minoritete që jetojnë të përzier dhe shpesh në konflikt me njëri tjetrin. Nga ana tjetër, shoqëritë paralele mund të jenë në disa raste të shpërndara gjeografikisht, duke jetuar bashkë me komunitetin më të madh, por duke minimizuar kontaktet e vërteta shoqërore me ta.

Lindja e shoqërive paralele ka një sërë pasojash të rrezikshme. Së pari, deprivimi social dhe ekonomik mund të sjellë trazira, të cilat nuk lidhen domosdoshmërisht me problemet kulturore apo fetare. Së dyti, pjesëtarët e klasës së mesme të re, të edukuar mirë, të cilët rriten në një shoqëri të mbyllur brenda një shoqërie të hapur, zemërohen gjithmonë e më shumë për mungesën e ngritjes shoqërore, dhe mund të vuajnë nga një lloj “skizofrenie kulturore”. Pjesëtarët e këtij grupi janë të prirur për radikalizëm. Së

tre, si pasojë e natyrës së tyre të mbyllur, shoqëritë paralele shpesh i ofrojnë strehë aktiviteteve kriminale dhe në disa raste rrjeteve terroriste. (Shih pjesën tjetër.)

Sigurisht që një izolim i tillë shkakton ftohje të ndërsjellë midis shoqërisë në fjalë dhe komunitetit më të madh që e rrethon. Kjo bie në kundërshtim me çdo nocion të kuptimshëm të “bashkëjetesës”. Pavarësisht faktit nëse ajo është rezultat i politikave të qëllimshme “multikulturore”, çdo politikë serioze integrimi duhet të synojë ta tejkalojë atë.

6. Ekstremizmi islamik

Megjithëse Islami ka ekzistuar për shumë vjet në Evropë, sulmet terroriste të 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara, si dhe sulme të ngjashme që ndodhën më pas në Evropë (veçanërisht ato në Madrid, mars 2004; Londër, korrik 2005; dhe një seri e tërë sulmesh në Moskë, ku rasti më i fundit është ai në aeroportin e Domodedovo-s në shkurt të vitit 2011), kanë rritur perceptimin se terrorizmi është një tipar i Islamit. Në disa raste deklarohet se “jo të gjithë myslimanët janë terroristë por pothuajse të gjithë terroristët janë myslimanë”.

Megjithatë, statistikak zyrtare flasin ndryshe. Një raport i Europolit i vitit 2009 doli në përfundimin se “terrorizmi islamik ende perceptohet si kërcënim më i madh në mbarë botën, pavarësisht faktit se BE-ja është përballur vetëm me një sulm terrorist në vitin 2008. Separatizmi, më shumë se besimi fetar, mbetet motivi i pretenduar për numrin më të madh të sulmeve në BE”; një vit më vonë i njëjti raport vuri në dukje se në vitin 2009, ndonëse terroristët islamikë kishin kërcënuar pa dallim shtetet anëtare të BE-së për sulme terroriste, me synimin për të shkaktuar viktima në masë, “numri i arrestimeve që lidheshin me terrorizmin islamik u ul me 41% krahasuar me vitin 2008, dhe vazhdon tendencën e një uljeje të vazhdueshme që prej vitit 2006”.¹⁴

Megjithatë, impakti i terrorizmit nuk mund të matet thjesht me numrin e sulmeve, por më shumë me numrin e viktimave që ato shkaktojnë dhe mbi të gjitha me suksesin e tyre për të traumatizuar shoqërinë, duke krijuar një klimë frike dhe – nëse është e mundur - duke provokuar reagime të cilat kanë prirjen të radikalizojnë dhe zgjerojnë grupin e njerëzve tek të cilët, me anë të sulmeve, grupi mund të shpresojë për të fituar mbështetje për ideologjinë e tij dhe rekrutë të rinj për për aktivitetet e tij – në rastin e terrorizmit islamik, myslimanë të zemëruar në Evropë dhe ata në botën islame të cilët ndiejnë zemërim kundër Perëndimit. Gjykuar në bazë të këtyre kriterëve, terrorizmi islamik është qartësisht më efikas dhe më i rrezikshmi në Evropë sot. Niveli i lartë i viktimave në disa sulme të kryera në fillim të dekadës së shkuar dhe paralajmërimet e përsëritura për sulme të reja të mundshme, si nga grupet islamike si al-Qaeda dhe nga autoritetet në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë – të gjitha të raportuara dhe komentuara në mënyrë intensive në media si dhe nga propagandues anti-amerikanë – kanë bërë që publiku ta shikojë islamin radikal ose militant si një kërcënim të madh për sigurinë. Si rrjedhojë, ekzistenca e ekstremizmit islamik – i cili përfshin jo vetëm komplotet reale terroriste apo mbrojtjen e hapur të dhunës, por edhe grupet dhe predikuesit që

14. Europol, TE-SAT 2010, Situata e Terrorizmit në BE dhe Raporti i Prirjeve, 2010.

denoncojnë vlerat perëndimore apo bëjnë thirrje për “xhihad” (shpesh, por jo gjithmonë përkthehet saktësisht si “luftë e shenjtë”) – është një kërcënim serioz për bashkëjetesën paqësore midis myslimanëve dhe jo-myslimanëve në Evropë, sepse përforcon, dhe duket se justifikon frikën dhe zemërimin e popullsisë jomyslimane për myslimanët.

7. Humbja e lirive demokratike

Të torturuar nga frika e dyfishtë e “mbytjes” nga një fluks i pakontrolluar emigrantësh dhe/ose të masakruar nga terroristët islamikë, evropianët presin që shteti t’i mbrojë ata dhe udhëheqësit politikë i druhen faktit se kanë shumë pak mundësi rizgjedhjeje nëse konsiderohen se kanë dështuar në ndonjërin nga frontet. Si rrjedhojë, shtetet gjenden nën një trysni të vazhdueshme për të forcuar kontrollet kundër emigracionit dhe për t’i mbajtur terroristët potencialë, apo ata të dyshuar, nën vëzhgim të rreptë. Në shumë raste besohet se ekziston një lidhje përjashtuese midis sigurisë dhe lirive të qytetarit, dhe qeveritë ndjehen të detyruara për të kufizuar këtë të fundit me shpresë se do të garantojnë të parën. Megjithatë, kjo lidhje përjashtuese është shumë e diskutueshme: liritë e qytetarit janë kushti thelbësor për demokracinë dhe liria për të jetuar ashtu siç ai ose ajo zgjedh përbën thelbin e asaj se çfarë duhet të mbrojë siguria. Megjithëse shumica në disa raste mund të ketë nevojë të mbrohet nga veprimet e një pakice të vogël dhe të dhunshme, nëse pjesëtarët e pakicave nuk ndjehen të lirë dhe të sigurtë, numri i atyre që do të përdorin dhunën ka të ngjarë të rritet. Si rrjedhojë, ne besojmë se reagimi i tepruar nga ana e shtetit dhe ushtrimi i kontrolleve të tepërta përbëjnë në të vërtetë një rrezik serioz për mbarëvajtjen dhe forcën e demokracive evropiane.

Duke u përpjekur të kufizojnë emigracionin, shumë shtete evropiane kanë zgjedhur të ndalojnë azilkërkuesit dhe emigrantët e “paligjshëm” për periudha gjithmonë e më të gjata kohore, shpesh pa i ngritur atyre akuzë për ndonjë shkelje, dhe në disa raste në kushte shumë të dëmshme për shëndetin dhe në mjedise të mbipopulluara. Në të paktën një rast kjo ka tërhequr vëmendjen e Komisionit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimit Çnjerëzor apo Poshtëruar të Këshillit të Evropës, i cili zbuloi se këto kushte “mund të konsideroheshin edhe trajtim çnjerëzor apo poshtëruar”. Qeveritë apo organet e pushtetit vendor kanë përdorur buldozerët për të shkatërruar kampet ku ishin mbledhur emigrantët pa dokumente dhe arrestuan ata të cilët nuk mund të largoheshin në kohë; kanë penalizuar hyrjen e parregullt në shtetet e tyre dhe më pas kanë nxitur patrullat me qytetarë që të ndihmojnë për ndalimin e “kriminelëve”; kanë dhënë dënime të gjata me burgim për pronarët që japin godina me qira për emigrantët pa dokumente; dhe kanë filluar zbatimin e “proceseve të përsheptuara” për përcaktimin e statusit të refugjatit, duke cënuar kështu një sërë garancish proceduriale për të drejtat e njeriut që përfshihen në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Disa nga masat e ndërmarra në emër të parandalimit të terrorizmit janë edhe më të rënda. Në Konferencën e Parë të Këshillit të Evropës me Ministrat Përgjegjës për Median dhe Shërbimet e Reja të Komunikimit (zhvilluar në Rekjavik, Islandë, më 28 dhe 29 Maj 2009) shtetet anëtare morën angazhimin, ndonëse me vonesë, “për të rishikuar në mënyrë të rregullt legjislacionin e tyre kombëtar dhe/ose praktikën për të siguruar që çdo impakt i masave kundër terrorizmit në të drejtën për lirinë e shprehjes

dhe informimit të jetë në përputhje standardet e Këshillit të Evropës, duke i kushtuar rëndësi të veçantë vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Megjithatë, sigurisht që kjo nuk është e vetmja liri që çenohet nga këto masa. Në shumë shtete, periudha gjatë së cilës qytetarët mund të ndalohen pa u akuzuar për dyshim për përfshirje në komplete për akte terroriste është zgjatur vazhdimisht dhe janë shtuar gjithashtu vazhdimisht të drejtat e policisë për të ushtruar mbikëqyrjen e të dyshuarve, apo për të hyrë në banesat e tyre, duke çenuar kështu privacinë që ata gëzojnë.

Gjithashtu, shumë shtete evropiane kanë qenë tepër të gatshme për të pranuar operacionet e shërbimeve të huaja të sigurisë. Qytetarët janë marrë peng, janë mbajtur në mënyrë arbitrare në burgje sekrete dhe janë transferuar në juridiksione të tjera, ku ata mund t’i nënshtroheshin torturave vetëm në bazë të dyshimeve për terrorizëm dhe në shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Dy hetime të kryera nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për programin e të ndaluarve shumë të vlefshëm, të ngritura nga Administrata Amerikane pas sulmeve të 11 shtatorit, kanë zbuluar një “rrjet merimange” me përmasa globale, të thurur nga Agjensia Qendrore e Zbulimit (CIA). I ashtuquajti programi “transferim i jashtëzakonshëm” ka shkaktuar shumë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Ai ka qenë në gjendje të funksionojë vetëm nëpërmjet bashkëpunimit të disa shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, pavarësisht faktit se ata duhet të veprojnë në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

8. Një përplasje e mundshme midis “lirisë së besimit” dhe lirisë së shprehjes

Ekziston gjithashtu një kërcënim për lirinë – në mënyrë të veçantë, lirinë e shprehjes – nga një grup tjetër, e që janë pikërisht ndjeshmëritë e grupeve të cilat kërkojnë që liria të kufizohet në emër të respektit për besimin e tyre fetar apo simbolet e tyre. Fillimisht kjo u shfaq si problem i rëndësishëm në kohën e “problemit të “Rushdie-s” në vitin 1989, kohë kur shumë myslimanë, edhe nga ata të cilët nuk mbështesnin fatwa-n nga Ayatollah Khomeini dhe kërcënime të ngjashme për vrasje ose dhunë, kërkuan ndalimin apo censurimin e librit të Salman Rushdie-s *Vargjet Satanike* për shkak të një pjese të librit, ku në një ëndërr të një prej personazheve të librit, gratë e profetit Muhamed shfaqen si prostituta. (Pozicioni i tyre u forcua në disa shtete nga fakti se ligjet të cilat ndalonin blasfeminë kundër besimit të krishterë ishin ende në fuqi, ndonëse zbatoheshin rrallë.) Një faktor i rëndësishëm për protestat ishte zemërimi i madh që përjetohej nga pjesëtarët e minoritetit të diskriminuar, të cilët ndjenin përbuzjen e dukshme të shumicës për ta dhe për fenë e tyre. Në të paktën një shtet, kjo çoi në propozimin për forcimin e ligjeve për “nxitjen e urrejtjes fetare”, të cilat konsideroheshin gjerësisht si dhunim i lirisë së shprehjes.

I njëjti problem u shfaq përsëri në periudhën 2005-06, madje në një formë më të ashpër, lidhur me botimin nga një gazetë daneze të karikaturave tallëse të profetit Muhamed. Këtë herë nuk kishte dyshime se botimi ishte qëllimisht provokues. Në të vërtetë, një pjesë e mirë e specialistëve të medias mendonin se gazeta ishte sjellë në mënyrë të papërgjegjshme. Megjithatë, kishte njëkohësisht një ndjenjë të fortë, edhe jashtë sferës së medias, se liria e shprehjes, për të qenë e tillë, duhet të përfshijë të

drejtën për të thënë dhe bërë ato gjëra që mund të kundërshtohen nga të tjerët dhe duhet të kufizohet vetëm kur është qartësisht dhe objektivisht e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Nga këndvështrimi i myslimanëve, u vu në dukje se Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili ka të bëjë me lirinë e shprehjes, paraprihet nga neni 9, i cili mbron “lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit”; por ky argument nuk gjeti mbështetje nga pjesa më e madhe e jo-myslimanëve, apo edhe nga të gjithë myslimanët, pasi ishte e vështirë të vërtetoje se si botimi i karikaturave mund të ndalonte dikë, siç shprehet në nenin 9, “të manifestojë fenë ose besimin e tij, në adhurim, mësim, praktikë dhe vëzhgim”. (U vu gjithashtu në dukje fakti se shumë prej njerëzve të cilët mbronin lirinë e besimit kundërshtonin nga ana tjetër lirinë për të *ndryshuar* fenë apo besimin e tyre, gjë që përfshihet në lirinë e besimit fetar sipas të njëjtin nen.)

Ekziston kështu rreziku që një liri themelore, siç është liria e shprehjes, të mund të reduktohet si pasojë e ankthit të disa elitave evropiane për të shmangur zemërimin e një minoriteti të rëndësishëm, ose si pasojë e frikës së provokimit të akteve të dhunës. Konflikti i pretenduar midis lirisë së shprehjes dhe lirisë së besimit fetar, si dhe mungesa e konsensusit se në ç’mënyrë dhe ku duhet të vendosen kufijtë e lirisë së shprehjes, përbëjnë rrezik për disa nga vlerat më të mëdha evropiane.

B. Cilat janë shkaqet e këtyre rreziqeve?

1. Pasiguria

Evropa sot, me gjithë kontrastet dhe kontradiktat e saj, është një nga pjesët e botës ku mund të jetohet në mënyrën më të sigurt, më të lirë, më të shëndetshme, më të begatë, të rehatshme dhe njerëzore. Megjithatë, shumë evropianë nuk duket se ndiejnë të njëjtën gjë - ose edhe nëse e ndiejnë një gjë të tillë, ata kanë të njëjtin qëndrim me atë të Doktor Knock-ut: “La santé est un état précaire qui ne présage rien de bon.” (Shëndeti është një gjendje e paqëndrueshme, i cili vetëm sa mund të përkeqësohet.) Pasuria e Evropës sigurisht që nuk është e ndarë në mënyrë të barabartë dhe si rrjedhojë shumë evropianë i shikojnë ata që janë më të pasur me xhelozë dhe zemërim, ndërsa ata që janë nën nivelin e tyre i shikojnë me nervozizëm. Shumë, për të mos thënë pjesa më e madhe e tyre, janë prekur nga kriza ekonomike globale. Disa prej tyre kanë humbur vendet e punës, ndërkohë që shumë të tjerë janë prekur nga shkurtimet në shpenzime dhe shërbimet publike, në një kohë kur qeveritë luftojnë për të rifituar ekuilibrin e tyre financiar dhe fiskal. Pavarësisht shenjave të përmirësimit në disa shtete (veçanërisht Gjermania), në fund të vitit 2010, shkalla e përgjithshme e papunësisë në Evropë mbeti në nivelin 10% – më e larta në 12 në vjet.

Evropianët janë gjithashtu shumë të vetëdijshëm për këtë – sepse politikanët, ekspertët e ekonomisë dhe media janë duke i thënë atyre vazhdimisht – se pozicioni i tyre në klasifikimin botëror është duke zbritur, pasi ekonomitë në zhvillim, veçanërisht në Azinë Lindore dhe Jugore, e marrin veten shumë më shpejt nga kriza se vendet tashmë të industrializuara, duke konkurruar në mënyrë të suksesshme për tregje eksporti dhe duke tërhequr investime nga punëdhënësit të cilët në disa raste mbyllin

bizneset e tyre në Evropë dhe hapin biznese të reja në “Jugun global”. Ata e dinë se shoqëria e tyre është duke u plakur dhe se sistemi i tyre arsimor është duke u bërë gjithmonë e më pak konkurrues në tregun botëror. Ata janë gjithashtu më të vetëdijshëm se njerëzit e tjerë në pjesën më të madhe të botës se mënyra e tyre aktuale e jetesës mund të mos jetë e përhershme sepse ata janë duke konsumuar burimet e parinovueshme dhe rrezikojnë ndryshime klimaterike katastrofike.

Reagimi i tyre është rrjedhimisht mbrojtës – të shqetësuar për të ardhmen e tyre në një botë që ndryshon shpejt; në ankth për të mbrojtur pasurinë e tyre; të shqetësuar për të ardhmen e fëmijëve të tyre në një botë që globalizohet me hapa të shpejtë; dhe duke u ndjerë të kërcënuar në mënyrën e tyre të jetesës nga kultura dhe tradita të panjohura të fqinjëve të rinj që jetojnë mes tyre.

2. Emigrimi

Ndërkohë që vështirësitë ekonomike dhe pasiguria rritin konkurrencën për burimet e pakta ndërmjet individëve dhe grupeve në përgjithësi, sot në shumë pjesë të Evropës vihet re një tendencë e lartë për të fajësuar “emigrantët” në veçanti. (Shih qëndrimet e publikut ndaj “emigrantëve” dhe azilkërkuesve të përmbledhur më lart në pjesën A.1.b) Për të identifikuar burimet e dukurive të përshkruara në pjesën A, është e rëndësishme që të trajtohet si realiteti i emigracionit në Evropë, ashtu edhe mënyrat se si shoqëria ka reaguar ndaj tij.

Emigrimi në drejtim të shteteve evropiane, dhe veçanërisht në ato të Bashkimit Evropian, është rritur ndjeshëm në dy dekadat e fundit falë ndërthurjes së një sërë faktorësh, si: rritja globale e mobilitetit, ndihmuar nga lehtësia në udhëtimet ndërkombëtare; vështirësitë ekonomike pas rrëzimit të komunizmit në shumë vende të Evropës Lindore; konfliktet e dhunshme dhe mungesa e stabilitetit në Evropën juglindore dhe zona të tjera. Për më tepër, anëtarësimi në BE i 12 vendeve të reja – kryesisht vende ish-komuniste – në vitin 2004 dhe 2007, ka lehtësuar integrimin ekonomik dhe mobilitetin e punës, duke sjellë një rritje të konsiderueshme të migrimit brenda Evropës, kryesisht nga lindja në perëndim.

Kështu, numri i emigrantëve që jetojnë Evropë dhe Azinë Qendrore u rrit nga 67.5 milion në vitin 2005 në 72.6 milion në vitin 2010. Një në tre emigrantë ndërkombëtarë në botë sot jeton në Evropë dhe emigrantët përbëjnë 8.7% të popullsisë së përgjithshme të Evropës.

Të gjitha pjesët e Evropës e kanë ndjerë këtë rritje të numrit të emigrantëve që prej vitit 2005, por Evropa jugore përfshin pjesën më të madhe të tyre (3.4 milion njerëz, me një rritje mesatare vjetore prej 5.2%).

Sigurisht që pjesa më e madhe e emigrantëve gjenden në qendrat urbane. Londra, Parisi dhe Moska kanë secila më shumë se 1 milion banorë që nuk kanë lindur në këto vende. Nga 85 qytete në botë të cilat kanë nga 100 000 deri në 1 milion banorë të lindur jashtë këtyre shteteve, 30 gjenden në Evropë. Në Amsterdam, Bruksel, Frankfurt dhe Londër, personat e lindur jashtë këtyre vendeve përbëjnë mbi një të katërtën e popullsisë së përgjithshme. Megjithatë, kjo dukuri mund të prekë gjithashtu

qytete shumë të vogla apo edhe komunitete rurale, si për shembull në rastet kur qeveritë kombëtare këmbëngulin që ato të ofrojnë strehim për refugjatët dhe azilkërkuesit.

Ndikimi në punësim

Sipas disa studimeve akademike, emigrimi ka një ndikim shumë të vogël në punësimin e popullsisë vendase. Megjithatë, ai mund të ketë një farë ndikimi tek punësimi i të rinjve në ata sektorë ku punëdhënësit preferojnë emigrantët në vend të punonjësve vendas, për shkak se “ata zakonisht kanë qëndrim më të mirë ndaj punës”. Kjo ka bërë që disa njerëz të dalin në përfundimin se “ndonëse është në dobi të punëdhënësve, emigrimi i cili është në interesin më të mirë të punëdhënësve të veçantë nuk është gjithmonë në interesin më të mirë të ekonomisë në përgjithësi”.¹⁵

Në disa shtete, si Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania, të cilat kanë importuar punën e emigrantëve për disa dekada me rradhë, ka nivele relativisht të larta të papunësisë në një kohë kur ka edhe mungesa të mëdha të fuqisë punëtore në sektorë të veçantë, të cilët kërkojnë kryesisht punëtorë të kualifikuar. Kështu, disa kanë shprehur qëndrimin se lejimi i më shumë punonjësve të kualifikuar për të ardhur si emigrantë dhe për të mbushur këto hapësira do të ndihmonte në krijimin e *më shumë* vendeve të punës për popullsinë vendase,¹⁶ ndërkohë që ka të tjerë njerëz që e shohin këtë gjë më negativisht, pasi sipas tyre, “duke qenë se emigracioni zhvillon ekonominë e përgjithshme, nuk mund të pritet që ai të jetë një politikë efikase për reduktimin në mënyrë të konsiderueshme të vendeve të lira të punës. Vendet e lira të punës janë, deri diku, shenjë e një tregu të shëndetshëm pune dhe e një ekonomie të shëndoshë. Ato nuk mund të jenë një arsye e fortë për nxitjen e emigracionit të fuqisë punëtore në shkallë të gjerë”.¹⁷

Në vende të tjera, përvoja e të cilëve me emigracionin është më e vonë, ka një ndërthurje më të madhe në tregun e punës midis emigrantëve dhe banorëve vendas. Në Spanjë, për shembull, pjesa më e madhe e emigrantëve bëjnë punë me kualifikim të ulët apo punë pa kualifikim, dhe si rrjedhojë, hyjnë rrallë në konkurrencë me punonjësit vendas. Punonjësit e pakualifikuar përbëjnë 15% të punonjësve vendas dhe 37% janë emigrantë— shifrat rriten në 42% për gratë emigrante. Pra, duket qartë se punonjësit emigrantë janë të përqendruar tek punët e pakualifikuara ose me nivel të ulët kualifikimi. Gjatë periudhës 2001 - 2006 kishte një rritje të dukshme të numrit të punonjësve të huaj në sektorin e shërbimeve, por kjo e fundit përjetoi gjithashtu rritjen më të lartë të punësimit nga spanjollët vendas.

Në përgjithësi, studimet që kanë të bëjnë me mënyrën se si emigracioni ndikon tek pagat dhe mundësitë e punësimit të punonjësve vendas japin rezultate të ndryshme

15. Dhoma e Lordëve, 2008: 33.

16. “Synimi kryesor i politikave të emigracionit nga një këndështrim i tregut të punës është të lejojë punësimin e fuqisë së kualifikuar punëtore, në mënyrë që të krijohen mundësi të reja punësimi për punonjësit vendas” (Süssmuth, 2001: 4).

17. Dhoma e Lordëve, 2008: 34.

dhe ndonjëherë të paqarta, por në përgjithësi përfundimet e tyre mbështesin idenë se ndikimi i tyre është i vogël.

Shkalla e kriminalitetit

Statistikat tregojnë se vërtet ka shkallë kriminaliteti më të lartë se mesatarja tek disa minoritete (veçanërisht ai Rom) dhe emigrantët, apo njerëzit me prejardhje të afërt emigranti. Megjithatë, këto statistika duhen analizuar me kujdes. Ekzistojnë prova të shumta paragjykimi dhe diskriminimi brenda sistemeve të drejtësisë penale në shumë (ndoshta pjesa më e madhe) shtete evropiane. Dikush që identifikohet si emigrant apo pjesëtar i një minoriteti ka më shumë të ngjarë të ndalohej dhe të kontrollohet nga policia; si dhe ka më shumë mundësi të arrestohet apo edhe të akuzohet për një vepër penale më shumë se sa një pjesëtar i ngjashëm i popullsisë “vendase”. Kështu, besimi i përgjithshëm se këto grupe janë më të prirura për të kryer krime është deri diku vetëpërmbushës. Me shumë gjasa ekziston një bazë për këtë, por kjo nuk do të thotë se njerëzit kryejnë krime *për shkak të* origjinës së tyre apo prej statusit të tyre të emigrantit. Në rastin e emigrantëve pa dokumente dhe disa azilkërkuesve, ata mund të kenë shumë pak mundësi zgjedhjeje pasi sistemi i ka paracaktuar ata si “të paligjshëm” dhe nuk i ka lënë asnjë mjet të ligjshëm për të ushqyer veten dhe familjet e tyre. Në raste të tjera, lidhja domethënëse ekziston midis shkallës së lartë të kriminalitetit dhe nivelit të lartë të papunësisë tek të rinjtë apo treguesve të tjerë të përjashtimit ekonomik dhe shoqëror. Njerëzit e diskriminuar nga ana ekonomike në përgjithësi përqendrohen në disa zona të caktuara të qyteteve, të cilat kthehen në “geto”, ku një numër i madh “emigrantësh” apo pjesëtarësh të minoriteteve etnike përkrijnë me një shkallë të lartë papunësie, standard të ulët jetese, shkolla apo shërbime të tjera sociale të dështuara apo në dështim e sipër, vendstrehime të mbipopulluara apo të lëna pas dore – dhe nivele të larta kriminaliteti, veçanërisht tek të rinjtë. Qytetarët e komunitetit kryesor largohen nga këto zona nëse janë në gjendje ta bëjnë një gjë të tillë, duke përforcuar kështu karakterin “etnik” dhe perceptimin se krimi lidhet me tiparet gjenetike ose kulturore të popullsisë tjetër.

Si pasojë e krizës ekonomike, gjendja aktuale e emigrantëve në Evropë është shumë e vështirë. Një nga arsyt kryesore për emigrimin është kërkimi i një vendi pune, por – ndoshta për shkak se punëdhënësit ndjekin një politikë “kush ka hyrë i fundit në punë largohet i pari” – janë emigrantët të cilët aktualisht po përjetojnë *reduktimin* e vendeve të punës, veçanërisht në shtetet që janë prekur më shumë nga kriza. Nëse kjo gjendje vazhdon, atëherë ka mundësi që integrimi i tyre afatgjatë në vendet e tyre të reja të bëhet edhe më i vështirë. Ndonëse kanë qenë kontribues të rëndësishëm për ekonominë e vendit në periudha zhvillimi, tani ata shpesh konsiderohen barrë, apo si një konkurrencë e padëshiruar me punonjësit vendas për ato pak vende pune që kanë mbetur (ndonëse studimet tregojnë se efekti real i një konkurrence të tillë tek punësimi i punonjësve vendas është shumë i vogël). Kjo ushqen paragjykimet kundër emigrantëve dhe si rrjedhojë sjell një diskriminim gjithmonë e më të madh kundër tyre.

Së fundi, një pjesë e madhe e armiqësisë publike ndaj emigrantëve, dhe njerëzve me origjinë emigranti të kohëve të fundit, mund të shkaktohet nga argumenti rreth të drejtave. Emigrantët – dhe veçanërisht pasardhësit e tyre që kanë lindur në atë shtet – besojnë në mënyrë të natyrshme se, si kontribues për ekonominë kombëtare, ata kanë të njëjtat të drejta për trajtim, shërbime sociale dhe solidaritet të barabartë kur goditen nga papunësia ose vështirësi të tjera ekonomike ashtu si banorët apo qytetarët e tjerë. Megjithatë, shumica “vendase” e popullsisë në çdo shtet kërkon, në mënyrë të vetëdijshme ose jo, të përjashtojë personat me origjinë të huaj nga të drejtat sociale ose të paktën të kufizohet akses i tyre tek këto shërbime, duke besuar kështu në mënyrë instiktive se në fillim duhen përmbushur nevojat e “njerëzve tanë”. Si rrjedhojë, ata reagojnë ndaj pretendimeve të të “ardhurve” duke i akuzuar ata për “zhvatjen e taksapaguesve” apo se “varen nga vendasit”, dhe/ose nuk janë plotësisht besnikë ndaj vendit pritës dhe si rrjedhojë nuk meritojnë të drejtat që u janë dhënë.

3. Imazhi i shtrembëruar i minoriteteve në media dhe stereotipet e dëmshme

Pa dyshim që ndërthurja e pasigurisë ekonomike dhe asaj fizike me emigracionin masiv do të ishte e mjaftueshme për të shkaktuar një shkallë të caktuar paragjykimi dhe armiqësie kundër emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigranti të kohëve të fundit, si dhe më shumë viktima tradicionale të racizmit, si romët apo hebrenjtë. Megjithatë, kjo nuk do të kishte arritur nivelin aktual në Evropë pa ndërhyrjen aktive të medias. Shumë prej tyre, në pjesë të ndryshme të Evropës, kanë ndërmarrë vetë nismën për të demonizuar emigrantët dhe minoritetet e tjera, jo vetëm duke transmetuar shqetësimet dhe mitet që qarkullojnë tek njerëzit rreth këtyre grupeve, por duke i vënë gjithashtu theksin “skandaleve” reale ose të supozuara që lidhen me krimin apo abuzimet me ndihmat sociale, dhe njëkohësisht akuzojnë autoritetet se i fshehin ato dhe janë duke lejuar hyrjen e një numri tepër të madh të huajsh në vendin e tyre.

Media e shkruar dhe ajo elektronike kanë bërë që të përforcohet shumë ndjenja se emigrantët janë duke “zhvatur” sistemin, duke denoncuar në mënyrë të vazhdueshme raste të mashtrimit me përfitimet që kryhen nga emigrantët. Duke lënë mënjanë faktin se këto mashtrime të pretenduara janë pjesërisht rezultat i ligjeve gjithmonë e më të ashpra që kushtëzojnë lejet e qëndrimit dhe të drejtat për ndihma sociale me punësimin dhe nivelin e të ardhurave, dhe se mashtrime të ngjashme apo edhe më të rënda kryhen gjithashtu nga vendasit, lajmet që fokusohen tek krimet e kësaj kategorie shfrytëzohen me zell të madh sepse ato ndihmojnë që të justifikohen kufizimet e të drejtave sociale të emigrantëve. Në pjesën më të madhe të rasteve, njerëzit që vendosen në qendër të këtyre historive janë azilkërkuesit.

Në shumë raste media duket se është formalisht ose joformalisht e lidhur me partitë ksenofobike ose konservatore, të cilat përdorin këtë frikë për të fituar mbështetje elektorale, duke paralajmëruar se kundërshtarët e tyre janë “të butë me krimin” apo të gatshëm të “hapin portat” për valët e reja të emigracionit.

Studime të ndryshme¹⁸ tregojnë se: fotografitë e të dyshuarve që duken “të huaj” apo që i përkasin minoriteteve shfaqen më shpesh në media se ata të cilët duken “vendas”; krimeve që kryhen nga emigrantët apo pjesëtarët e minoriteteve kundër “vendasve” i kushtohet shumë më tepër vëmendje nga media se krimeve që kryhen brenda të njëjtit grup etnik; krimet raportohen në mënyrë më intensive në periudhën para zgjedhjeve se në periudhën pas tyre (edhe kur statistikat zyrtare tregojnë se shkalla e kriminalitetit ka pësuar rënie); dhe publiku evropian është më i prirur për të lidhur frikën e tij ndaj krimit me shqetësimet rreth emigracionit gjatë viteve zgjedhore sesa në periudha të tjera kohore – gjë që është dëshmi e padiskutueshme e forcës së ligjërit politik dhe përfaqësimit në media për të krijuar perceptimin publik rreth dukurive shoqërore.

Media ka një përgjegjësi të madhe në krijimin e imazhit që shoqëria shumicë ka për të tjerët, përfshirë këtu emigrantët dhe pasardhësit e tyre. Mund të lindë pyetja se pse ata e ushtrojnë kaq shpesh këtë përgjegjësi në mënyrë kaq negative. Një arsye mund të jetë sepse në kushtet e konkurrencës së një tregu mediatik të dominuar nga kompani private, gazetarët – veçanërisht ata që punojnë në mediat me tirazh apo audiencë të lartë – kanë gjithmonë e më pak mundësi për të vazhduar trajnimin e tyre profesional, të kryejnë studime të thelluara, apo të njihen plotësisht me një tematikë, dhe gjenden kështu nën tryshninë për t’i dhënë hapësirë dhe kohë historive më sensacionale, edhe kur ato çenojnë saktësinë, për të mos folur për “balancën”, kontekstin apo analizën e kujdesshme.

Së dyti, grupet në fjalë kanë shumë pak akses në median kryesore, kanë nivel të ulët përfaqësimi në të dhe përgjithësisht konsiderohen më pak të besueshëm nga vetë ajo. Media, ashtu si industria e reklamave, ka prirjen të shpërfillë emigrantët dhe minoritetet dhe bën shumë pak përpjekje për të trajtuar problemet që ata kanë, apo që të transmetojë pikëpamjen e tyre lidhur me problemet me interes të përgjithshëm. Kështu, gazetarët, shpesh në mënyrë shumë të paqëllimshme, ndihmojnë në përjashtimin e miliona qenieve njerëzore nga “bashkëbisedimi kombëtar”.

Media e re

Problemi nuk kufizohet vetëm tek media “tradicionale” – gazetatat dhe radiotelevizioni. Sot, këto janë duke u zëvendësuar gjithmonë e më shumë si burimi kryesor i informacionit, komunikimit dhe argëtimit nga interneti. Kjo është shumë më e vështirë për t’u kontrolluar dhe fatkeqësisht, një numër gjithmonë e më i madh përdoruesish të internetit janë duke e shfrytëzuar atë për të përhapur propagandë raciste ose ksenofobike, si dhe për të nxitur urrejtjen tek të tjerët – në një shkallë të tillë që tashmë interneti është bërë mjeti kryesor për përhapjen e fjalorit të urrejtjes dhe krijimit të gjendjes së frikës.¹⁹ Për më tepër, shërbimet e reja interaktive të internetit 2.0 i japin mundësinë ekstremistëve të përdorin teknologji të tilla si blogjet dhe përhapjen e videove për të promovuar axhendën e tyre në faqe të njohura të “medias sociale” si Facebook, MySpace, Twitter dhe YouTube. Sipas “Raportit të Urrejtjes Dixhitale” të vitit 2010, interneti u bë 20% më i keq në vitin 2009, me terroristë dhe racistë që gjithmonë e më shumë i drejtoheshin faqeve të medias sociale

18. Për shembull, Fitzgerald, Curtis dhe Corliss (2009).

19. Rrjeti Ndërkombëtar Kundër Urrejtjes në Internet (INACH), Nëntor 2010, www.inach.net/INACH_report_2010.pdf.

dhe kishin objektiv fëmijët.²⁰ (Sigurisht që ka shembuj më pozitivë të përdorimit të medias, si asaj të re ashtu edhe asaj të vjetër. Shih “Masmedia” në pjesën e dytë.)

4. Kriza e udhëheqjes

Së fundi, nëse Evropa është duke reaguar në një mënyrë mbrojtëse dhe të ngurtë ndaj sfidave të shekullit të 21-të, përfshirë këtu divergencën e saj, kjo duhet të jetë kështu pjesërisht sepse duket se ekzistojnë shumë pak drejtues – si në nivel kombëtar apo në institucionet evropiane, si politikë ashtu edhe fetarë, si tek opinionistët ashtu edhe tek fushat e tjera të shoqërisë civile – të cilët mund të krijojnë besim duke shprehur një vizion të qartë të së ardhmes së Evropës dhe një strategji bindëse për realizimin e këtij vizioni. Kjo mungesë udhëheqjeje mund të jetë deri diku simptomë e krizës, por ajo gjithashtu kontribuon për të dhe sigurisht që ndihmon për të shpjeguar afrimin tek partitë populiste dhe ksenofobike, të cilat bëjnë fushatë me slogane në dukje të thjeshtë. Shumë shpesh, personat të cilët drejtojnë partitë politike “kryesore” dhe zgjidhen në një post të lartë, duke ditur se kundërshtarët e tyre dhe media janë gati të hidhen në sulm sapo ata të bëjnë një lëvizje të gabuar, besojnë se shpresa e tyre e vetme për të mbajtur postin gjendet tek ndjekja e opinionit publik në vend që ta orientojnë atë.

Kjo është pa diskutim më e dukshme tek mënyra se si ata trajtojnë politikat e emigracionit. Ndoshta nuk ka asnjë drejtues apo qeveri në Evropë që nuk beson në mënyrë individuale se demografia e Evropës, me një rënie të vazhdueshme të numrit të punonjësve në moshë pune në krahasim me ata që kanë nevojë për mbështetje, e bën të pashmangshëm faktin se do të ketë nevojë për më shumë emigrantë gjatë dekadave në vazhdim; apo që nuk i është thënë në mënyrë të qartë nga drejtuesit e biznesit në vendet e tyre se mosdhënia e vizave për punonjësit e kualifikuar nga jashtë vendit do të thotë frenim i biznesit dhe ngadalësim i rimëkëmbjes ekonomike. Sigurisht që ata duhet të jenë në gjendje dhe të gatshëm t’ia shpjegojnë këtë publikut në mënyrë të qartë dhe të këmbëngulin në zbatimin e politikave që ata e dinë se janë të nevojshme dhe të drejta, ndërkohë që duhet t’i japin gjithashtu përgjigje bindëse shqetësimeve reale dhe legjitime të publikut. Ata pa dyshim duhet të kenë kurajon për t’u përballur me populizmin ksenofobik që kemi përshkruar më lart dhe t’i rezistojnë tundimit për t’u përpjekur të konkurojnë me ta duke ndjekur modelin e tyre.

Historia tregon se qasja e dytë, e cila sakrifikon parimet në dëm të rezultatit, është rrallë e suksesshme në këndvështrimin afatgjatë dhe shpesh madje as në atë afatshkurtër. Sapo shpallen politikat, elektorati ka prirjen t’ia besojë zbatimin e tyre, personave që vërtet i mbështesin ato.

20. Shih: www.foxnews.com/scitech/2010/03/15/terrorists-targeting-children-via-facebook-twitter/#.

Pjesa e dytë– Reagimi

A. Parime orientuese

Ne besojmë se në një shoqëri të lirë bashkëjetesa paqësore midis njerëzve që i përkasin racave, besime fetare dhe kulturave të ndryshme mund të arrihet nëse të gjithë bien dakort të pranojnë disa parime thelbësore, të cilat jepen më poshtë.

1. Minimalisht, duhet të bihet dakort se ligji duhet respektuar, si dhe duhet të kuptohet nga të gjithë se çfarë është ligji dhe si mund të ndryshohet ai. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë rënë dakort të mbështeten tek Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe secili prej tyre pret që qytetarët dhe banorët e tyre të respektojnë ligjet kombëtare për sa kohë që ato janë në fuqi.
2. Asnjë individ apo grup nuk mund të pretendojë që të përjashtohet nga ky detyrim për shkak të veçantisë së tij kulturore. Gjithashtu, asnjë individ nuk duhet të trajtohet si pjesëtar i një grupi kulturor ose fetar të cilën ai/ajo nuk zgjedh t'i përkasë me vullnet të lirë. Gjithsesi, qytetarët kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hartimit të ligjeve, ose si individë ose si pjesëtarë grupesh, kur ata vendosin për një gjë të tillë.
3. Parimi themelor i demokracisë është se ata të cilët preken nga vendimet duhet të shprehin mendimin e tyre për to. Të gjithë banorët në territorin e një shteti duhet të respektojnë ligjet e tij, dhe si rrjedhojë, sa më shumë nga ata duhet të shprehin mendimin e tyre gjatë hartimit të ligjeve. Rrjedhimisht, të gjitha shtetet duhet të zgjerojnë të drejtat dhe detyrimet e shtetësisë, përfshirë këtu të drejtën për të votuar. Si një hap drejt realizimit të kësaj, ata që nuk janë shtetas të një vendi, të çfarëdo lloji origjine qofshin, duhet të lejohen të votojnë në zgjedhjet për pushtetin vendor në çdo qytet apo rajon ku banojnë - ashtu siç ndodh me qytetarët e Bashkimit Evropian të cilët banojnë në një shtet tjetër anëtar.
4. Dhënia e shtetësisë duhet të kushtëzohet nga kritere civile, të cilat zbatohen njëllëj për të gjithë, dhe jo në bazë të kulturës, përkatësisë etnike, fesë apo vendit të origjinës së aplikuesit.
5. Pasi jepet shtetësia, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj duhet të jenë të barabarta për të gjithë.
6. Të drejtat e barabarta për burrat dhe gratë, të shpallura në preambulën e Kartës së Kombeve të Bashkuara, nuk mund dhe nuk duhet të mohohen apo shpërfillen, e veçanërisht në një shoqëri demokratike. Në asnjë rrethanë nuk mundet që respekti për identitetin e grupit apo besimi fetar të mund të justifikojë përjashtimin e vajzave nga çdo lloj forme arsimimi që është e

disponueshme për djemtë, apo përjashtimin e grave nga ndërveprimi normal me shoqërinë jashtë shtëpisë së tyre.

7. Të gjithë njerëzit – shumicë apo minoritet, shtetas apo të huaj, rezidentë apo jo-rezidentë – zbatojnë ligjin e shtetit në të cilin gjenden dhe shtetet duhet të zbatojnë ligjin në mënyrë të barabartë për të gjithë. Kjo nuk do të thotë se ligji duhet të përdoret për të forcuar uniformitetin kulturor në popullsi. Si parim i përgjithshëm, ai duhet të mbrojë lirinë e zgjedhjes së individit për sa kohë që ai ose ajo nuk vë në rrezik lirinë ose sigurinë e të tjerëve. Ashtu si për çdokënd tjetër, emigrantët apo njerëzit me origjinë emigranti të kohëve të fundit priten të respektojnë ligjin, të mësojnë gjuhën zyrtare të vendit ku ndodhen (apo të paktën një, kur ka më shumë se një gjuhë zyrtare) si dhe të bëjnë diçka të dobishme për bashkëqytetarët e tyre.
8. Megjithatë nuk pritet që ata të hedhin poshtë besimin, kulturën apo identitetin e tyre. As Islami dhe as ndonjë fe tjetër nuk duhet të konsiderohet a priori si jo në përputhje me vlerat evropiane. Askush nga ne nuk ka një identitet të vetëm – ne identifikohemi ndryshe në varësi të kontekstit. Amerikanët “me vizë në mes” – qytetarë amerikanë krenarë dhe patriotë, të cilët gjithsesi vlerësojnë dhe shprehin lidhjen e tyre me shtetin apo rajonin e origjinës së tyre, apo të familjeve të tyre – konsiderohen shumë normalë. Pse të mos ketë “evropianë me vizë në mes”?
9. Qytetarët e çdo shteti duhet të vendosin me njëri tjetrin, nëpërmjet proceseve të tyre kushtetuese kombëtare, nivelin e duhur të rregullave dhe vlerave që ata kanë nevojë të ndajnë me njëri tjetrin për të jetuar së bashku në demokraci. Megjithatë, ata duhet ta bëjnë këtë në mënyrë të tillë që t’i japin mundësinë pjesës më të madhe të tyre për t’u ndjerë se pranohen plotësisht si qytetarë të atij vendi, pavarësisht identitetit apo identiteteve që ata i njohin vetes, dhe jo t’ju kërkohet të hedhin poshtë identitetin e tyre apo të përshtaten me kulturën e dikujt tjetër.
10. Duhet të minimizohet detyrimi. Duhet të bëjmë dallimin midis asaj çka kërkohet nga ligji dhe asaj që është e dëshirueshme për qytetari të mirë dhe për “bashkëjetesë” jo vetëm në paqe, por përmirësim të ndërsjellë. Kategoria e parë përfshin të drejtat dhe liritë themelore, siç janë ato që garantohen nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa kategoria e dytë përfshin aspekte të tilla si “respekti i ndërsjellë” – i cili sigurisht që është i rëndësishëm, por duhet të ekzistojë në zemrat dhe mendjet e njerëzve. Respekti duhet të reflektohet gjithashtu në sjelljen e jashtme, por nuk është i mundshëm dhe mund të jetë kundërproduktiv nëse e trajtojmë atë si një të drejtë që mund të kërkohet apo të zbatohet ligjërisht. Njerëzit duhet të tregojnë respekt ndaj njëri tjetrit, por realizimi i një gjëje të tillë është një çështje subjektive, përveç rasteve kur ai arrin një masë të tillë që çënon dukshëm të drejtat e përcaktuara, dhunimi i të cilave mund të përcaktohet objektivisht. Barra e provës duhet të bjerrë gjithmonë tek ata të cilët kërkojnë të shtojnë kufizimet ligjore dhe të krijojnë shkelje të reja të ndëshkueshme, duke vendosur në këtë mënyrë kufizime të reja për të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

11. Duhet maksimizuar puna bindëse. Ekzistojnë tashmë ligje shumë të mira në Evropë, duke filluar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mund të ketë raste kur legjislacioni kombëtar ose nën-kombëtar ka nevojë të përmirësohet në mënyrë që të përshtatet me standardet evropiane. Megjithatë, sipas këndvështrimit tonë, detyra më urgjente është zbatimi i standardeve ekzistuese ligjore dhe atyre që lidhen me të drejtat e njeriut – dhe të sqarohet arsyeja pse në shumë raste një gjë e tillë nuk është duke u realizuar. Justifikime mund të gjenden gjithmonë. Shtetet anëtare të cilat nuk arrijnë të vënë në jetë konventat, do të shprehen, për shembull, se atyre i mungojnë mundësitë për të bërë një gjë të tillë apo se duhet të merren parasysh rrethana të veçanta kombëtare. Por në fund të fundit kjo është gjithmonë një çështje prioritetesh. Organet do të zbatojnë ligjin kur ato të jenë plotësisht të bindura se ai është i drejtë dhe i nevojshëm, dhe në demokraci pikëpamja e tyre për këtë çështje është në mënyrë të pashmangshme e ndikuar nga opinioni publik, ose nga ajo çka ata besojnë se publiku do të pranojë. Ligjet, të cilat nga pjesa më e madhe e publikut perceptohen si të padrejta, të tepërta apo të paarsyeshme, shpesh është e pamundur të zbatohen. Kështu për shembull, edhe ligjet më të mira janë shumë pak të dobishme nëse opinioni i përgjithshëm nuk është i bindur se ato janë të drejta. Për këtë arsye, ne besojmë se një jetë e përbashkët më e mirë në shekullin 21 varet relativisht pak nga detyrimi por varet shumë më tepër nga të bindurit e njerëzve me kultura dhe besime të ndryshme se ata vërtet kanë nevojë të jetojnë së bashku, si dhe të gjejnë mënyrat për ta bërë një gjë të tillë sa më të lehtë.
12. Të gjitha qeniet njerëzore gëzojnë mbrojtjen e ligjit dhe personat më të dobët apo ata që ekspozohen më shpesh ndaj abuzimeve apo shfrytëzimit të paligjshëm kanë të drejtë të pretendojnë që autoritetet të bëjnë përpjekje të veçanta në emër të tyre. Duhet të jetë e qartë nga shembujt e dhënë në pjesën e parë se kjo lidhet veçanërisht me pjesëtarët e minoriteteve – veçanërisht atë Rom – dhe me emigrantët, apo ata me prejardhje emigranti të kohëve të fundit.
13. Njëkohësisht, duhet të jetë e qartë se të gjithë qytetarët dhe – përveç rasteve kur të drejtat rezervohen qartësisht me ligj për ta – të gjithë banorët gëzojnë trajtim të barabartë sipas ligjit dhe mundësi të barabarta arsimimi dhe punësimi, si dhe të mundësi të barabarta për të mira dhe shërbime, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Diskriminimi i përshkruar në pjesën e parë është i papranueshëm dhe tregon qartë nevojën për vigjilencë publike dhe vendosmëri në emër të grupeve të rrezikuara.
14. Megjithatë, është gjithashtu e qartë se në disa raste, vetëm barazia ligjore nuk mjafton për t'i dhënë mundësi emigrantëve apo pjesëtarëve të minoriteteve të gëzojnë barazi të plotë mundësish dhe të gëzojnë pjesëmarrje të plotë në jetën e përditshme të shoqërive evropiane, për shkak se ata përjetojnë vështirësi sociale-ekonomike, të cilat sjellin përjashtimin apo izolimin e tyre në skaj të shoqërisë. Probleme të tilla sociale-ekonomike kanë prirjen të bëhen të trashëgueshme dhe të përhershme nëse nuk merren masa të veçanta për të përmirësuar gjendjen e këtyre grupeve, dhe veçanërisht për të siguruar që karriera dhe mundësitë e tjera të jenë vërtet të hapura për fëmijët e tyre dhe brezin e ri. Kjo justifikon, dhe në fakt bën të domosdoshme marrjen e masave

të veçanta nga ana e autoriteteve publike në mbështetje të këtyre grupeve, duke ndarë të mirat publike në mënyrën e duhur, veçanërisht në fushat e arsimit parashkollor dhe atij shkollor si dhe arsimit profesional; ndoshta edhe në punësim, apo të paktën në formën e granteve që do t'i jepnin mundësinë këtyre njerëzve të zhvendoseshin në zona me mundësi më të shumta punësimi.

15. Pavarësisht faktit se masat e mësipërme janë të nevojshme, ato mund të mos jenë të mjaftueshme për të siguruar që njerëzit me përkatësi të ndryshme kulturore, fetare dhe gjeografike, të jetojnë së bashku në harmoni dhe miqësi të vërtetë në të gjitha shtetet dhe qytetet e ndryshme të Evropës. Ekziston ende rreziku që njerëzit e një kategorie të caktuar të kufizohen në disa vende apo të kufizojnë vetveten, në një ekzistencë të veçuar kolektive, dhe se njerëzit e komuniteteve të tjera, veçanërisht ata që e konsiderojnë veten se i përkasin shumicës historike apo vendase të popullsisë së vendit, të shprehin mendime të pavërteta apo armiqësore rreth pjesëtarëve të minoriteteve dhe emigrantëve, apo njerëzve me origjinë emigranti të kohëve të fundit, bazuar në thashetheme, takime të shkurtra, apo raporte dhe deklarata të pavërteta në media. Studimet dhe rezultatet e zgjedhjeve në shumë pjesë të Evropës kanë treguar se paragjykimet dhe mendime të tilla të gabuara janë më të dukshme në zonat ku ka një numër relativisht të ulët pjesëtarësh të këtyre grupeve, ose atje ku “komunitete” të ndryshme bëjnë një jetë kryesisht të veçantë, dhe është më pak e dukshme në zonat ku njerëzit kanë kontakte të përditshme me pjesëtarët e grupeve të tjera, si dhe kanë mundësi të punojnë së bashku dhe t'i njohin ata. Pra, ne besojmë se ndër mënyrat më të mira me të cilat evropianët e kategorive të ndryshme mund të ndihmohen për të jetuar së bashku, janë ato të cilat, veçanërisht në nivel qytetesh apo nivel lokal, i vendosin pjesëtarët e grupeve të ndryshme në kontakt të ngushtë dhe konstruktiv. Vetëm kur e njohim njëri tjetrin si bashkëqytetarë të veçantë, si kolegë dhe miq, dhe jo nëpërmjet imazheve apo stereotipeve, mund të thuhet se vërtet “jetojmë së bashku”.
16. Liria e shprehjes qëndron në themel të një shoqërie të lirë dhe është një e drejtë themelore e njeriut. Sipas Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ushtrimi i kësaj të drejte “përfshin detyrime dhe përgjegjësi”, dhe si rrjedhojë “mund t'i nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve apo ndëshkimeve që parashikohen nga ligji dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në të mirë të sigurisë kombëtare, integritetit territorial apo sigurisë publike, për parandalimin e trazirave apo krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, për mbrojtjen e reputacionit apo të drejtat e të tjerëve, për parandalimin e nxjerrjes së informacionit i cili është marrë në mënyrë konfidenciale, apo për ruajtjen e autoritetit dhe paanësisë së sistemit gjyqësor”. Besimtarët e përkushtuar të një feje mund të lëndohen thellë apo të ndiejnë se identiteti apo komuniteti i tyre është duke u viktimizuar, nëse feja e tyre, themeluesi apo simbolet e shenjta të saj, bëhen objekt talljeje publike apo shpifjeje. Si rrjedhojë, liria e shprehjes duhet të ushtrohet në mënyrë të përgjegjshme, duke i kushtuar vëmendjen e duhur këtyre ndjenjave, veçanërisht në masmedia. Megjithatë, nuk është në kompetencë të ligjit apo autoriteteve publike që të vënë një gjë të tillë në zbatim.
17. Megjithatë, ne mendojmë se është shumë e rëndësishme që deklaratat publike të cilat kanë tendencën të rritin apo përforcojnë paragjykimet publike kundër

pjesëtarëve të çdo grupi – dhe veçanërisht pjesëtarëve të minoriteteve – nuk duhet të lihen pa marrë përgjigje. Ne besojmë se të gjithë qytetarët, veçanërisht ata me pushtet, apo që gëzojnë mundësi të veçantë të komunikimit me publikun, kanë detyrimin të dënojnë abuzimin me baza racore ose fetare, dhe të hedhin poshtë përgjithësimet apo stereotipet e gabuara, sa herë që ata përballen me to. Nëse beteja për opinionin publik nuk bëhet kryesisht në gjykata, ajo duhet të zhvillohet në vendin që i takon, pikërisht në debatet mediatike dhe publike.

Shënim: Pranojmë se ka kontekste në të cilat zbatimi i këtyre parimeve nuk është i qartë. Megjithatë, ekziston ende çështja se deri në ç'masë, gjatë hartimit të ligjeve, shtetet duhet të marrin parasysh pikëpamjet, besimet apo traditat e ndryshme të grupeve minoritare. Për të tilla çështje, qytetarët e çdo demokracie duhet të vendosin se ku do të vendosin kufirin. Sigurisht që mendimet mund të jenë të ndryshme, dhe të paktën për një çështje të tillë – nëse gratë (apo edhe burrat) duhet të lejohen të shfaqen në publik me fytyrë plotësisht të mbuluar – edhe pjesëtarët e Grupit tonë nuk ishin në gjendje të ishin në një mendje.

B. Aktorët kryesorë të ndryshimit

Në këtë pjesë identifikojmë sektorët e veçantë të shoqërisë dhe institucioneve, të cilët besojmë se kanë mundësinë për të ndryshuar mënyrën se si njerëzit në Evropë mendojnë për njëri tjetrin, dhe në këtë mënyrë të bëjnë të mundur që ata të jetojnë më mirë së bashku.

1. Arsimtarët

Ndërkohë që njohja jonë fillestare për grupet e tjera shpesh vjen nga masmedia, perceptimet tona minimale rreth tyre dhe mënyra se si ne asimilojmë apo reagojmë ndaj informacioneve të reja janë shpesh të formësuara në vitet e para të jetës. Sigurisht që në këtë rast mjedisi familjar mund të jetë vendimtar dhe përgjegjësia e prindërve për transmetimin e qëndrimeve tek fëmijët e tyre është shumë e madhe. Megjithatë, po aq i rëndësishëm është edhe arsimimi formal.

Arsimi luan një rol të qartë dhe thelbësor për të përgatitur njerëzit – veçanërisht të sapoardhurit, dhe në mënyrë të veçantë gratë dhe fëmijët – të gjejnë vende pune dhe rrjedhimisht të marrin pjesë në shoqëri. Megjithatë, përveç kësaj, ai duhet t'i pajisë ata me njohuri rreth rolit dhe funksionimit të institucioneve dhe rregullave të shoqërisë, por edhe normat dhe vlerat që formojnë elementin lidhës në funksionimin e shoqërisë. Dështimet në këtë aspekt transmetohen lehtësisht nga një brez tek tjetri. Si rrjedhojë, është shumë e rëndësishme që personave të cilët hasin vështirësi brenda sistemit shkollor – nxënësit me rezultate të ulëta apo ata të cilët rrezikojnë të braktisin shkollën apo të bëhen shkelës të ligjit – t'u kushtohet vëmendje e veçantë.

Sipas *Letrës së Bardhë për Dialogun Ndërkulturor*, “Të jetojmë së bashku si të barabartë me dinjitet”,²¹ nga Këshilli i Evropës në vitin 2008, për të jetuar së bashku në paqe njerëzit kanë nevojë për aftësi apo “kompetenca” të cilat nuk fitohen automatikisht, por duhen mësuar dhe praktikuar që në moshë të hershme, në mënyrë që të ruhen për gjithë jetën. Sigurisht që mësuesit e shkollave duhet të luajnë një rol thelbësor për të ndihmuar fëmijët të zhvillojnë këto aftësi, por edukimi joformal dhe programet edukative gjatë gjithë jetës mund të luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm për kultivimin e tyre; si dhe për të ndihmuar të rriturit të cilët nuk e kanë marrë këtë lloj edukimi me koë të plotë.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për emigrantët ose pjesëtarët e minoriteteve (përfshirë ata me origjinë emigranti të kohëve të fundit), të cilët shpesh kanë një nevojë të madhe për arsimim të përshtatshëm, i cili t'i ndihmojë ata të bëhen më të suksesshëm dhe pjesëmarrës më aktivë në shoqëri. Nevoja më urgjente është përmirësimi i integritetit në sistemin arsimor të fëmijëve të sapoardhur të emigrantëve, duke i mësuar atyre shprehjet e nevojshme gjuhësore në nivelin parashkollor, duke i

21. Me iniciativën e Ministrave të Jashtëm të Këshillit të Evropës në Sesionin e 118 Ministror (Strasburg, 7 maj 2008).

përgatitur për një kalim të suksesshëm nga shkolla në tregun e punës ndërkohë që i afrohen moshës së përfundimit të shkollës, dhe në këtë mënyrë ata ndihmohen të tejkalojnë vështirësitë që hasin kur jetojnë në zona të izoluara ose të diskriminuara.²²

Portrete²³

La mallette des parents

La mallette des parents²⁴ është një eksperiment interesant i zhvilluar në shkollat e mesme në Créteil (në periferi të Parisit) nga laborator i “J-Pal” në Shkollën e Ekonomisë së Parisit. Qëllimi ishte të tregohej se si rezultatet e arritura nga nxënësit mund të përmirësoheshin kur prindërit e tyre ishin më aktivë. Dy grupe klasash, me më shumë se 5 000 nxënës në secilin grup u krahasuan gjatë vitit shkollor 2008-09. Në njërin grup, prindërit u ftuan të merrnin pjesë në takimet me grupin e mësuesve. U morrën përkthyes për ata të cilët nuk flisnin frëngjisht. Këto takime trajtonin mënyrën se si funksiononte shkolla dhe mënyrën më të mirë për të ndihmuar fëmijët të ndërvepronin me mësuesit e tyre. Gjatë vitit u organizuan tre deri në pesë takime, në mënyrë që të mos kishte nevojë për shpenzime të larta (rreth €1 500 në vit për çdo shkollë), por efekti ishte shumë befasues: më shumë prindër linin takime për të biseduar me mësues të veçantë, më shumë prej tyre u regjistruan për t’u antarësuar në shoqatat e prindërve dhe fëmijët mbaheshin nën kontroll më të mirë prindëror. U vu re një përmirësim i dukshëm në sjelljen e nxënësve: më pak mungesa, më pak pezullime, më pak paralajmërime zyrtare dhe më shumë nxënës që përgëzoheshin për rezultate të mira. Ky efekt ishte i dukshëm si tek fëmijët prindërit e të cilëve kishin dalë vullnetarë për të marrë pjesë në eksperiment, ashtu edhe për ata të cilët morrën pjesë sepse programi u bë pjesë e kurrikulës së shkollës. Programi, i vlerësuar nga një grup i pavarur studiuesish, ishte aq i suksesshëm sa vitin tjetër u vendos që ai të shtrihej në të gjitha shkollat e mesme të Francës për një periudhë tre vjeçare.

Kampet Rinore të Paqes të Këshillit të Evropës

Që prej vitit 2004, Kampet Rinore të Paqes të Këshillit të Evropës²⁵ kanë mbledhur çdo vit të rinj nga rajone të ndryshme që janë duke përjetuar, apo sapo kanë dalë nga konflikte të thella. Ata janë mbledhur për kurse një javore trajnimi për zgjidhjen e konflikteve, të drejtat e njeriut, arsimin dhe dialogun ndërkulturor. Vitet e fundit, pjesëmarrësit kanë qenë të rinj nga komunitetet e ndryshme të Kosovës;²⁶ Izraeli dhe territoret nën drejtimin e Autoritetit Palestinez; pjesa veriore dhe jugore e Qipros; Armenia dhe Azerbajxhani. Në pothuajse të gjitha rastet, pjesëmarrësit takuan bashkëmoshatarët e tyre për herë të parë në jetën e tyre, në një mjedis të qetë dhe të mbrojtur. Duke sjellë së bashku aktivistë të rinj nga zona në konflikt ose pas konflikteve, dhe duke i ftuar ata të diskutojnë për përvojën, perceptimet dhe aspiratat e tyre, kampet vënë në lëvizje një proces dinamik, si dhe japin një kontribut të vlefshëm për zhvillimin demokratik dhe atë komunitar. Pjesëmarrësit i nënshtrohen një procesi shumë

22. Rekomandimi CM/Rec(2008)4 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare lidhur me përmirësimin e integritetit të fëmijëve të emigrantëve dhe atyre me të shkuar emigranti, shkurt 2008.

23. Në portretet gjatë kësaj pjese të raportit, nxjerrim në pah shembuj grupesh dhe individësh në disa nga kategoritë e përmendura, të cilë kanë ndërmarrë apo janë duke ndërmarrë veprime për të nxitur “bashkëjetesën” në mënyra praktike, të cilat ne i konsiderojmë të lavdërueshme dhe që duhet të merren si shembull.

24. Shih: www.parisschoolsofeconomics.eu/en/news/final-report-the-effect-of-a/?lang=en and www.education.gouv.fr/cid52640/mene1000704c.html (vetëm frëngjisht).

25. Komunikatë për Grupin e Personave të Shquar nga Gabriella Battaini-Dragoni, Drejtoreshë e Përgjithshme për Arsimin, Kulturën dhe Trashëgiminë, Rininë dhe Sportet, Këshilli i Evropës, Madrid, 14 shkurt 2011.

26. Të gjitha referencat për Kosovën, si për territorin, institucionet apo popullsinë, në këtë tekst do të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe duke mos paragjykuar statusin e Kosovës.

intensiv të mësuar për një periudhë shumë të shkurtër kohe. Ata ndjehen të detyruar të shohin “tjetrin” – një pjesëtar i komunitetit të cilin ata më parë e perceptonin si armiqësor apo madje të rrezikshëm për jetën – si një qenie njerëzore me aspirata dhe pritshmëri të ngjashme. Lënia e stereotipeve në këto kushte është shumë e dhimbshme dhe destabilizuese. Është shumë e rëndësishme që të ketë një qasje arsimore shumë të kujdesshme.

2. Masmedia

Tridhjetë vjet më parë shkencëtari politik Benedict Anderson krijoi shprehjen “komunitete të imagjinuara” si titull për veprën e tij të rëndësishme mbi nacionalizmin. Është e vërtetë se çdo shoqëri e cila është shumë më e madhe se një familje apo një fshat i vogël, duhet të jetë në pjesën më të madhe “e imagjinuar” nga pjesëtarët e kësaj shoqërie, pasi përveç një pjese shumë vogël, nuk mund të njihemi personalisht me të gjithë. Kjo do thotë se lidhur me bashkëqytetarët tanë, dhe shumë nga ata të cilët ne i quajmë - ndoshta në mënyrë metaforike – fqinjët tanë, mbështetemi tek mënyrat jo të drejtpërdrejta të njohjes me ta, mënyrën se si ata sillen dhe çfarë mendojnë. Këtë informacion e marrim kryesisht nga masmedia. Rrjedhimisht, masmedia dhe ata që punojnë për të, kanë një përgjegjësi të jashtëzakonshme për atë çka ne dimë, apo mendojmë se dimë, rreth grupeve të ndryshme nga të cilat përbëhen shoqëritë tona. Në pjesën e parë, pamë se sa shpesh ato nuk e përmbushnin këtë përgjegjësi, dhe përkundrazi janë shpesh përgjegjëse për krijimin apo forcimin e supozimeve të pavërteta, por shumë të përhapura tek një numër i madh evropianësh, për grupe të cilat ata nuk i përkasin vetë.

Sipas Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (FNG), është e nevojshme gjetja e mënyrave të reja për të nxitur dhe rrënjësuar parimet e para të gazetarisë në kulturën e medias moderne. FNG-ja i përmbledh këto parime si më poshtë:

“1. Thënia e së vërtetës – dhënie pas saktësisë së fakteve; verifikime të dyfishta; aftësi për t’i paraprirë mundësisë për gabime; arritja e autenticitetit nëpërmjet pyetjeve; të jesh gati për të pranuar dhe korrigjuar gabimet; të pranosh faktin se të vërtetat mund të zbulohen vetëm nëpërmjet kërkimeve intensive, intervistave të plota dhe të kuptuarit e mirë të çështjeve.

2. Të pavarur dhe të drejtë – histori që janë të plota, pa fshehjen e fakteve domethënëse; të luftohet për shmangien e anësisë; të mos përdoren termat keqësues; të lejohet hapësira për debat të vlefshëm dhe të arsyeshëm; t’i jepet personave që sulmohen hapësira për të dhënë mendimin e tyre; të mos ketë asnjë dorëzim ndaj ndikimit joshës të interesave komerciale dhe politike.

3. Sjellje e njerëzishme dhe solidaritet – mos i shkaktohet të tjerëve dëm i drejtpërdrejtë dhe i qëllimshëm; të minimizohet dëmi; të jenë mendjehapur dhe të ndjeshëm ndaj të tjerëve; t’i kushtojnë vëmendje të veçantë të drejtave të publikut dhe cilësisë morale të vetë gazetarisë.”

Portrete

Fondacioni Romedia

Që prej vitit 2006, Fondacioni Romedia,²⁷ i mbështetur nga Instituti për Shoqëri të Hapur dhe në bashkëpunim me kanalet televizive satelitore hungareze, transmeton çdo muaj një dokumentar të shkurtër për komunitetet Rome, çdo radhë nga një shtet të ndryshëm. Ky është i vetmi serial dokumentarësh informues për Romët që transmetohet në një kanal televiziv kryesor në Evropë.

Me anë të këtyre filmave të shkurtër, fondacioni ka qenë në gjendje t'i ofrojë teleshikuesve shumë informacione të reja rreth komuniteteve Rome, dhe një mënyrë të treguari që ndryshon nga ajo e mediave kryesore, të cilat kanë tendencën t'i përmendin Romët vetëm në kuadrin e krimi, dhe gazetarët e të cilave rrallë gjejnë kohën për të vizituar komunitetet Rome, apo të analizojnë thelbin e gjendjes së tyre. Fondacioni përpiqet të jetë zëri i këtyre njerëzve, duke vizituar shtete të ndryshme, duke shkuar në vendbanimet e tyre dhe duke i pyetur Romët rreth zgjidhjeve të mundshme për problemet që ata kanë.

Fondacioni dërgon filmat e tij në festivalet e mediave dhe organizon shfaqje filmash në të gjithë Evropën. Në vitin 2009, ai u nominua për Çmimin Civil Evropian të Parlamentit Evropian dhe ka fituar gjithashtu çmime në Festivalin Televiziv të Monte Karlos (2008) dhe dy herë në Festivalin Ndërkombëtar të Programeve Audiovizive (FNPA). Të gjitha filmat e tij gjenden në internet por ato shpesh nuk transmetohen në kanalet kryesore evropiane. “Ne na mungon lobimi nga një shtet i madh apo mbështetja e fortë politike nga dikush të cilit i dëgjohet zëri për këto punë”, i tha Grupit drejtoresha e Fondacionit Katalin Bársony. Në tre vitet e fundit, ajo ka hyrë dhe ka dëgjuar komunitetet Rome në rreth 30 shtete anëtare të Këshillit të Evropës. Ajo e përshkruan punën e saj si “një luftë të përditshme për të bërë të mundur përhapjen e gazetarisë objektive ssepse mediat kryesore nuk janë të hapura për këtë mënyrë të re”. Ajo sugjeroi se duhet bërë një përpjekje për të monitoruar programet e rregullta argëtuese dhe telenovelat për të parë nëse, dhe mënyrën se si, ato përfaqësojnë minoritetet (kjo është bërë në mënyrë të suksesshme në SHBA dhe deri diku në Mbretërinë e Bashkuar). Ajo vuri gjithashtu në dukje se është e rëndësishme të binden njerëzit që qëndrojnë në majë të burokracisë televizive – drejtorët, zyrtarët e lartë dhe njerëzit që merren me organizimin e festivaleve mediatike të nivelit të lartë.

Mekanizmi Mediatik i Reagimit të Shpejtë

Mekanizmi Mediatik i Reagimit të Shpejtë (MMRSh)²⁸, i vënë në jetë nga Aleanca e Civilizimeve e Kombeve të Bashkuara, ka si qëllim të tregojë se nëpërmjet transmetimit të balancuar të lajmeve, analizave dhe debateve, gazetarët dhe botuesit mund të luajnë një rol pozitiv në uljen e tensioneve ndërkulturore, si dhe të bëjnë të mundur dëgjimin e një shumëllojshmërie zërash lidhur me çështjet e debatueshme. Mekanizmi përbëhet nga tre pjesë:

1. T'i jepet gazetarëve mundësia për të kontaktuar një sërë individësh të cilët mund të flasin rreth çështjeve të debatueshme ndërkulturore (si karikaturat daneze apo komentet e Papës për Islamin) me një nivel të tillë njohurie dhe analize që përmirëson të kuptuarit e ndërsjellë. Kjo realizohet nëpërmjet një baze të dhënash në internet me ekspertë, e cila përmban profilet dhe intervistat e ekspertëve lidhur me çështje të shumta, përfshirë këtu globalizimin, integrimin, fushën e së drejtës, e kështu me rradhë.
2. T'i ofrohet trajnim mediatik ekspertëve të përmendur më sipër në mënyrë që ata të jenë më të përgatitur për intervista në radio, televizion dhe shtyp.
3. Realizimi, përkthimi dhe vendosja e opinionëve dhe deklaratave nga ekspertë në kohë

27. Komunikatë për Grupin nga Katalin Bársony, Drejtoreshë e Fondacionit Romedia, Budapest, 2 dhjetor 2010, www.mundiromani.com.

28. Informacion i mundësuar nga Jorge Sampaio, Përfaqësues i Lartë për Aleancën e Civilizimeve të Kombeve të Bashkuara në takimin e Grupit në Madrid, 15 shkurt 2011, www.unaoc.org/content/view/91/126/lang,english.

krizash ndërkulturore. Në bashkëpunim me partnerët e shoqërisë civile dhe organizatat mediatike, aleanca prodhon opinione nga ekspertë globalë dhe personalitete të profil të lartë, dhe i publikon ato në media ndërkombëtare dhe rajonale.

3. Punonjësit dhe sindikatat

Në pjesën e parë të këtij raporti vumë në dukje se pjesëtarët e minoriteteve, përfshirë këtu emigrantët dhe pasardhësit e tyre, ka shumë të ngjarë të bëhen objekt i frikës dhe zemërimit nga ana e pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë kur ata përjashtohen nga ana ligjore, sociale dhe ekonomike, apo edhe marginalizohen; dhe një frikë dhe zemërim i tillë shpesh reflektohet në diskriminim kundër tyre në tregun e punës, ndërkohë që përjashtimi i bën ata më të ekspozuar ndaj shfrytëzimi në vendin e punës, gjë të cilën kanë aspak ose shumë pak mundësi për ta rregulluar. Ndërkohë që zgjidhja për një gjë të tillë gjendet pjesërisht tek ligji apo organet shtetërore – të cilat duhet të marrin masa më të ashpra kundër diskriminimit dhe shfrytëzimit të qytetarëve dhe banorëve – një përgjegjësi e rëndësishme bie tek punëdhënësit dhe kolegët e punës, të cilët duhet të respektojnë ligjin pa pritur që të detyrohen për t'a bërë një gjë të tillë, dhe duhet t'i trajtojnë njerëzit e tjerë në mënyrë të drejtë dhe njerëzore, pavarësisht ligjit. Sindikatat mund të luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm për të ndihmuar punonjësit pa dokumente, duke i ofruar atyre këshillim dhe asistencë ligjore për pretendimet që ata kanë lidhur me mospagimin e rrogës, shfrytëzimin, abuzimin, aksidentet në vendin e punës, e kështu me rradhë.

4. Shoqëria civile

Studimet e kryera si brenda ashtu edhe jashtë Evropës²⁹ kanë treguar se konfliktet etnike janë më të pakta, apo izolohen më lehtësisht, në ato vende ku ka grupe të fuqishme të shoqërisë civile, të cilat bashkojnë njerëzit e komuniteteve të ndryshme. Këto grupe mund të variojnë nga sindikatat dhe shoqatat profesionale tek klubet sportive, qendrat e bamirësisë dhe organizatat vullnetare që punojnë për zgjidhjen e problemeve lokale, për të ndihmuar njerëzit e moshuar apo të paaftë për punë, apo për të përmirësuar fqinjësinë me sa më shumë mënyra të jetë e mundur. Ata janë të rëndësishëm sepse formojnë ura lidhëse për dallimet etnike dhe kulturore, duke siguruar që në çdo komunitet të ketë një numër të madh njerëzish, shpesh me rol udhëheqës, të cilët janë në kontakt me pjesëtarët e komuniteteve të tjera. Kështu, pozicioni i këtyre njerëzve është që të thonë të vërtetën kur ka raportime të pavërteta apo thashetheme rreth komunitetit të tyre, apo edhe të verifikojnë raportimet për të tjerët – duke i refuzuar ato kur është e nevojshme, ose duke i vendosur ato në kontekst. Shoqata të tilla me përzierje etnike zakonisht nuk janë të suksesshme kur organizohen “nga lart poshtë”, nga organe zyrtare, apo të financuara nga shteti, por janë shumë më të suksesshme kur bëhen në mënyrë vullnetare, apo krijohen nga njerëzit e zakonshëm.

29. Shih Ashutosh Varshney, *Konflikti Etnik dhe Jeta Civile: Hindutë dhe Myslimanët në Indi*, Yale University Press, 2002 dhe 2003.

Kështu, roli i disa aktorëve të shoqërisë civile në zgjidhjen e çështjeve të trajtuara në këtë raport – sfida për shoqëri të lira dhe të larmishme, vështirësitë “për të jetuar së bashku” dhe e ardhmja e vlerave evropiane – është më i rëndësishëm sesa ai i vendimmarrësve apo opinionistëve kryesorë në Evropë. Shoqëria civile shpesh përcakton axhendën e debateve publike për aspekte të ndryshme të këtyre sfidave: nga trajtimi zyrtar i azilkërkuesve dhe njerëzve të tjerë me prejardhje emigranti, tek reagimi ndaj gjuhës së urrejtjes, politikave ksenofobike dhe ato të ekstremit të djathtë. Shoqëria civile lehtëson komunikimin horizontal dhe vertikal midis komuniteteve të ndryshme dhe shpesh ka më shumë mjete se institucionet shtetërore për të identifikuar dhe denoncuar dhunimet e rënda të të drejtave të njeriut dhe atyre civile. Shumë shpesh, grupet e shoqërisë civile ofrojnë shërbime për viktimat më të prekura dhe më të shpreshta të diskriminimit. Shoqëria civile mobilizon gjithashtu opinionin publik për dialog ndërkulturor në nivele të ndryshme, nga i kombëtar tek ai brenda lagjeve. Megjithatë, të gjitha këto veprimtari janë në një rrezik të vazhdueshëm nëse politikëbërësit thjesht përshëndesin rolin e shoqërisë civile dhe në realitet e shpërfillin atë. Kush do të mobilizojë njerëzit për përfshirje reale të tyre nëse këtë gjë nuk e bëjnë organizatat dhe nismat e shoqërisë civile? Kush do të fillojë të diskutojë tema jo të pëlqyeshme – që nuk të japin vota në zgjedhje – nëse këtë gjë nuk e bëjnë aktorët e shoqërisë civile (duke punuar me dhe nëpërmjet një masmedie të përgjegjshme dhe serioze)? Kush do t’i ndihmojë qytetarët me prejardhje emigranti të shprehen nëse aksionet dhe organizatat e tyre civile nuk merren seriozisht? Kush do të ndërtojë bashkëpunim me këto organizata përveç homologëve të tyre nga popullsia lokale? Kush do të mbrojë dhe do të mobilizohet për diversitetin dhe për vlerat themelore evropiane nëse shoqëria civile nuk kuptohet dhe pranohet si një partner i denjë për realizimin e së ardhmes së projektit evropian?

Portrete

Qendra Kulturore Bielany

Qendra Kulturore Bielany³⁰ në Varshavën veriperëndimore është një shembull i mirë i masave që kanë si objektiv përmirësimin e integritit në nivel lokal, nëpërmjet një institucioni kulturor lokal dhe publik. Disa vjet më parë ajo filloi një seri aktivitetsesh të quajtura Poznajemy kulturę i obyczaje innych narodów (“Le të njohim kulturën dhe traditat e kombeve të tjera”). Aktualisht këto aktivitete zhvillohen çdo dy muaj dhe organizohen nga komunitete të ndryshme lokale. Pjesëmarrja është e lirë dhe çdokush është i mirëpritur të marrë pjesë. Aktivitetet përfshijnë leksione, filma, shfaqje artistike, kurse informuese për kulturën dhe civilizimin e vendeve të caktuara, takime me diplomatë, artistë, udhëtarë, si dhe ekspozita fotografish apo artistike.

Qëllimi kryesor i organizimit të këtyre veprimtarive është të sigurohet që njerëzit të cilët i përkasin komuniteteve të ndryshme të mësojnë më shumë për njëri tjetrin duke u njohur me dallimet dhe ngjashmëritë, si dhe me veçantitë kulturore, por edhe për të eliminuar apo shpjeguar drejt stereotipe të tilla si “suedez i ftohtë” apo “anglez flegmatik”. Nuk ka censurë apo preferencë për ndonjë shtet. “Ne takohemi me të gjithë, edhe atëherë kur mund të duket e diskutueshme.” Pas mbrëmjes në Korenë e Jugut, shumë shpejt një e tillë u organizua në Korenë e Veriut. Pas një mbrëmjeje kubane, kishte edhe një mbrëmje kolumbiane. Ishte ftuar Kina dhe pak më muaj më vonë ishte ftuar një grup që kërkonte pavarësinë e Tibetit. Mbrëmja izraelite vazhdoi (u zhvillua në kohën kur po shpërthente konflikti në Lindjen e Mesme) edhe pse institucioni u rrethua nga një kordon me punonjës të sigurisë. Në takimin

30. Shih www.yepp-community.org/yepp/cms/index.php.

iranian, diskutimet lidhur me diskriminimin kundër grave vazhduan deri natën vonë. Përballje të tilla të nxehta por paqësore i dhanë shumë prej pjesëmarrësve mundësinë për të njohur më mirë njëri tjetrin dhe botën komplekse moderne.

Shoqata Vëllazërore Evropiane Rome e Punonjësve të Zbatimit të Ligjit

Shoqata Vëllazërore Evropiane Rome e Punonjësve të Zbatimit të Ligjit³¹ u themelua në Budapest në vitin 2006, me mbështetjen e Institutit për Shoqëri të Hapur, Ministrisë Hungareze të Drejtësisë dhe Zbatimit të Ligjit si dhe Shoqatave Kombëtare të Policëve me Ngjyrë të Britanisë dhe Shteteve të Bashkuara. Nisma u ndërmor nga punonjës policie hungarezë me origjinë Rome dhe jo Rome, por e mbështetur që nga fillimi në mënyrë aktive nga përfaqësues të agjensive të zbatimit të ligjit nga gjashtë shtete evropiane: Bullgaria, Republika Çeke, Hungaria, Rumania, Sllovakia dhe Mbretëria e Bashkuar. Pritet që shtete të tjera t'i bashkohen kësaj nisme.

Shoqata jep ndihmë të drejtpërdrejtë në luftën kundër diskriminimit, por njëkohësisht nxit arsimimin dhe punësimin e Romëve, si dhe përmirësimin e kushteve të tyre të strehimit, dhe u jep atyre një mundësi për t'u larguar nga varfëria duke u bërë pjesë e profesioneve të zbatimit të ligjit. Ajo kërkon mundësi të barabarta në agjensitë e zbatimit të ligjit të Hungarisë dhe shteteve të tjera evropiane. Qëllimet e saj janë:

- të reduktojë paragjykimin e ndërsjellë midis agjensive të zbatimit të ligjit dhe komuniteteve Rome;
- të shtojë numrin e punonjësve me origjinë Rome në agjensitë e zbatimit të ligjit;
- të përmirësojë kushtet e jetesës dhe shërbimeve të punonjësve aktualë Romë, si dhe t'i ndihmojë ata të tejkalojnë problemet e tyre të identitetit;
- të luajnë rolin e ndërmjetësit në rastet e konflikteve Romë-polici;
- të reduktojë paragjykimin kundër Romëve në shoqëritë e shumicës, duke nxitur në këtë mënyrë integrimin e minoritetit Rom si në nivel kombëtar ashtu dhe në atë evropian;
- të mbështesë pjesëmarrjen e Romëve në kurse trajnimi kombëtare dhe ndërkombëtare për punonjësit e zbatimit të ligjit;
- të mbledhë praktikatat më të mira nga forcat e policisë në të gjithë Evropën.

31. Komunikatë për Grupin nga Majori i Policisë Gyorgy Makula, Sekretar i Përgjithshëm i Faerleo, Budapest, 2 dhjetor 2010, www.fajerleo.com/node/23.

Shpresë, jo urrejtje – fushata e revistës Searchlight kundër racizmit dhe fashizmit³²

Revista Searchlight është botuar çdo muaj që nga viti 1975 dhe është pika e parë e kontaktit për aktivistët, gazetarët, politikanët dhe akademikët që kërkojnë të dhëna rreth racizmit të organizuar në Britani.

Fushat e revistës Searchlight “Shpresë, jo urrejtje” mobilizon të gjithë ata që janë kundër “politikës së urrejtjes” të nxitur nga Partia Kombëtare Britanike (PKB) dhe Lidhja e Mbrojtjes Angleze (LMA). Ajo u themelua në vitin 2005 si kundërreagim pozitiv ndaj PKB-së dhe gëzon mbështetjen e gazetës *Daily Mirror*, sindikatave, njerëzve të famshëm dhe grupeve të komunitetit në mbarë vendin.

Përkrahësit e saj besojnë në fushata të lokalizuara, duke punuar brenda komuniteteve - për shembull duke shkuar në bare dhe duke u ulur me njerëzit apo duke marrë pjesë në biseda – aty ku racistët e organizuar janë duke fituar mbështetje. Ata përpiqen të ndërtojnë marrëdhënie, i japin besim atyre që nuk pëlqejnë racizmin dhe fuqizojnë komunitetet për të siguruar një alternativë më pozitive se politika e dëshpërimit. Ata sfidojnë mitet dhe dhe gënjeshttrat e ofruara nga PKB-ja dhe ata të llojit të tyre dhe gjithashtu mobilizojnë pozitivisht njerëzit që janë kundër racizmit. Searchlight dëshiron të sigurojë që njerëzit ta dinë historinë e plotë se kush është PKB-ja dhe LMA-ja dhe çfarë përfaqësojnë ata në të vërtetë.

Grupi 484

Grupi 484³³ është një organizatë jo-qeveritare (OJQ), e themeluar në vitin 1995 për të mbështetur organizimin e 484 familjeve refugjatësh të cilët kishin gjetur strehim në Serbi pasi ju larguan Operacionit Stuhia të ushtrisë kroate në Krahinë. Që atëherë, ajo ka punuar në më shumë se 70 qytete në Serbi dhe ka ofruar mbështetje dhe ndihmë për mbi 100 000 përfitues. Asistenca e drejtpërdrejtë i ka hapur gradualisht rrugën punës arsimore dhe kërkimore që synon të ketë ndikim tek vendimmarrësit. Grupi 484 punon gjithashtu me emigrantë, banorë vendas – sidomos me të rinjtë, organizatat dhe individët të cilët ndajnë vlerat e saj për të ndërtuar një shoqëri të mundësive të barabarta, ku respektohet diversiteti dhe të drejtat e barabarta. Për shembull, përmes programit “Ne dhe të tjerët”, të rinjtë janë nxitur për të mbledhur objekte dhe materiale nga bashkëqytetarët e tyre dhe institucionet kulturore, veçanërisht ato që tregojnë se “të ardhurit” dhe përfaqësuesit e grupeve të ndryshme etnike kishin sjellë me vete diçka që ka pasuruar komunitetin. Ata kanë mbledhur informacion në lidhje me jetën e njerëzve të zakonshëm, si dhe jetën e përditshme të personazheve historike - duke bërë kërkime në arkiva dhe muze, por edhe në familjet dhe lagjet e tyre, duke shkruar historitë e të moshuarve të qytetit, duke parë fotografi të vjetra familjare dhe duke lexuar libra dhe gazeta të vjetra.

32. Informacion i dhënë nga Catherine Fieschi, Drejtoreshë e Counterpoint (Mbretëri e Bashkuar), në takimin e Grupit në Madrid, 15 shkurt 2011, <http://www.hopenothate.org.uk/about-us/what-is-searchlight>.

33. Shih: www.grupa484.org.rs/index.php?option=com_content&task=view&id=2&Itemid=156&lang=english.

5. Kishat dhe grupet fetare

Kur mostoleranca dhe diskriminimi kanë bazë fetare, grupet dhe drejtuesit fetarë kanë përgjegjësi të veçantë për t'i luftuar ato. Kjo vlen jo vetëm për ata që përfaqësojnë besimin e deklaruar (të paktën nominalisht) nga shumica – në pjesën më të madhe të Evropës, kisha të krishtera – por jo më pak vlen edhe për ata të cilët përfaqësojnë (dhe mund të japin mbështetje shpirtërore) viktimat. Shumë kisha në Evropë - përfshirë në mënyrë të veçantë, që prej Këshillit të dytë të Vatikanit në vitet 1960, Kishën Katolike Romane – kanë bërë përpjekje për të përfshirë në dialog përfaqësues të besimeve të tjera, dhe për disa çështje kanë punuar së bashku kundër disa prirjeve në shoqëri dhe në politikat shtetërore, të cilat ata i konsiderojnë materialiste dhe “jo prej besimtari”. Në të njëjtën kohë, disa përfaqësues të besimeve të minoriteteve – veçanërisht Islamit – janë përpjekur të nxisin pikëpamje liberale dhe moderne brenda vetë komunitetit të tyre, si për të mirën e tyre ashtu edhe për të hedhur poshtë stereotipet apo keqkuptimet mbizotëruese në shoqëri.

Portrete

Lidhja e evropianëve dinamikë e të suksesshëm dhe Modelet për t'u ndjekur – Rrjeti i Profesionistëve Myslimanë Evropianë (Cedar)

Nuk është e qartë nëse Cedar-i³⁴ duhet të përshkruhet si një organizatë fetare ose jo.³⁵ Ajo e përshkruan veten si “një nismë e rëndësishme e shoqërisë civile” por edhe si “rrjeti i parë i profesionistëve myslimanë të Evropës”. Kështu, megjithëse nuk organizon veprimtari të caktuara fetare, ajo mbledh së bashku njerëz që identifikohen me besimin e tyre fetar, dhe kërkon të riparojë imazhin negativ të Islamit që mbizotëron në shoqërinë e shumicës evropiane dhe krizën e identitetit që prek shumë myslimanë evropianë dhe i bën një pjesë prej tyre të rrezikuar nga ideologjitë ekstremiste dhe fundamentaliste.

E themeluar në vitin 2008 në një konferencë të organizuar nga Seminari Global i Salzburgut, Cedar synon të përfaqësojë një gjeneratë në rritje të profesionistëve të rinj e të suksesshëm myslimanë në Evropë, si dhe të rritë ndikimin e tyre në rrjete më të gjera profesionale, politike dhe sociale. Ajo gjithashtu lehtëson angazhimin e anëtarëve të saj si modele dhe këshillues të rinjve në komunitetet e marginalizuara, duke zgjeruar në këtë mënyrë rrugët për mundësitë e karrierës dhe zhvillimin për brezin e ardhshëm.

Ky “rrjet rrjetesh” lehtëson një sërë projektesh për:

- të mbështetur zhvillimin profesional të pjesëtarëve të rrjetit dhe komuniteteve më të gjera myslimane;
- të shtuar aspiratat dhe për të rritur mundësitë e karrierës për të rinjtë myslimanë të marginalizuar nëpërmjet skemave të këshillimit dhe trajnimeve; të rritur njohjen nga ana e publikut të përgjithshëm evropian të profesionistëve të suksesshëm myslimanë, dhe si modele të shquara për t'u ndjekur brenda komuniteteve lokale;
- të kthyer idetë në vepra, duke u bërë një platformë për zhvillimin e sipërmarrjeve të rëndësishme sociale dhe sipërmarrjeve të biznesit, të cilat do t'i fuqizojnë myslimanët evropianë nëpërmjet zhvillimeve në teknologjinë e informacionit,

34. Shih: www.thecedarnetwork.com.

35. Ky është një problem për shumë myslimanë në Evropë. Ligjërimi aktual rreth “Islamit” i detyron ata të zgjedhin midis distancimit nga feja e tyre dhe konsiderimit të tij si identitet kryesor. Kjo nuk është një zgjedhje që dikush duhet të detyrohet të bëjë.

6. Njerëzit e famshëm dhe “modelet”

Ndërkohë që arsimtarët dhe media kanë përgjegjësinë më të madhe për formimin e qëndrimeve publike, edhe roli i grupeve vullnetare për bashkimin e njerëzve me besime dhe kultura të ndryshme në lagjet dhe vendet e tyre të punës është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Duhet të pranojmë faktin se një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë, ndoshta të rinjtë në veçanti, qëndron kryesisht jashtë grupeve të ndryshme të përmendura më sipër. Shumë fëmijë dhe të rinj dalin nga sistemi arsimor të pabindur prej tij, ose – veçanërisht sapo arrijnë adoleshencën – reagojnë kundër tij. Ndërkohë që disa mund të përfshihen, si shoqëria civile apo grupet fetare, shumë të tjerë qëndrojnë në apati, apo edhe kanë prirjen për t’iu bashkuar grupeve ksenofobike – në kërkim të entuziazmit, apo gjetjes së një mënyre për të shprehur ndjenjat e pasigurisë dhe agresivitetit. Këta njerëz “shpërfillin” lehtësisht çdo mesazh të rëndësishëm që i drejtohet atyre nga ana e drejtuesve politikë ose fetarë, por shpesh ata janë shumë të dhënë pas sportit, muzikës rok dhe llojeve të tjera të argëtimit popullor.

Individëve të shquar në këto zona i kushtohet një rëndësi e madhe mediatike, përfshirë aktivitetet dhe deklaratat e tyre jashtë fushës së veçantë në të cilën ata shkëlqejnë, dhe shumë pak drejtues në botë do të refuzonin mundësinë për të qenë bashkë me ta në vëmendjen e medias. Pra, këta njerëz të famshëm kanë një mundësi unike për të pasur një audiencë që të tjerët nuk mund ta kenë, dhe shpesh mund të marrin edhe premtim për mbështetje nga drejtues të vendit për një fushatë të caktuar. Ata të cilët janë vetë pjesë e minoriteteve apo kanë prejardhje emigranti kanë një mundësi të dyfishtë: ata mund të veprojnë si modele për pjesëtarët e tjerë të atyre grupeve, duke i treguar atyre se përpjekja për integrim ja vlen, dhe të përmirësojnë imazhin e grupit të tyre në sytë e shumicës apo shoqërisë “pritëse”, duke i treguar atyre se njerëzit e atij grupi mund të japin një kontribut të vlefshëm, apo madje mbresëlënës, nëse u jepet mundësia ta bëjnë një gjë të tillë.

Portrete

Fatih Akın – Regjisor gjerman filmi

Fatih Akın³⁶ lindi në vitin 1973 në Hamburg nga prindër me prejardhje turke. Në kinemanë e Akın-it, jetët e turko-gjermanëve, bashkë me betejet dhe paqartësinë e tyre për dy kulturat e ndryshme, janë tema të zakonshme. Tek *Head-On (Gegen die Wand, 2004)*, paraqiten dy kultura të ndryshme: pikëpamjet konservatore myslimane dhe turke të familjes së Sibelit (Sibeli luhet nga Sibel Kekilli), dhe vetë idetë e përparuara të Sibelit rreth seksit. Cahit (Biral Ünel), aktori kryesor mashkull, paraqitet si një përzierje e këtyre dy ideve dhe kulturave, duke përfaqësuar kështu një turk në vështirësi. Në vitin 2007 *The edge of heaven*, një histori ndërkulturore gjermano-turke për humbjen, vajtimin dhe faljen (titulli origjinal në gjermanisht: *Auf der anderen Seite*, titulli në turqisht: *Yaşamın Kıyısında*), fitoi çmimin për skenarin më të mirë në Festivalin e 60-të të Filmit në Kanë. Vetë Akın-i nuk i ka mohuar kurrë rrënjët e tij turke dhe madje e pranoi çmimin në Kanë në emër të kinemasë turke.

36. Shih: <http://en.wikipedia.org>.

Andrei Arshavin – Futbollist rus

Andrei Arshavin³⁷ luan për skuadrën e Arsenalit në Premier Ligën Angleze dhe është kapiten i ekipit kombëtar rus. Ai ishte një nga njerëzit e shquar që mbështeti fushtatën e Këshillit të Evropës “Ngrije zërin kundër diskriminimit”: “Dua që të gjithë të mbështesin fushatën kundër diskriminimit,” deklaroi Arshavin-i, duke vazhduar më tej se: “Futbolli i jep mundësinë çdo lojtari të shprehë talentin e tij/e saj dhe të ndihmojë skuadrën, pavarësisht racës, besimit apo prejardhjes shoqërore. Ai është gjithashtu një sport që i jep mundësinë çdo lojtari të garojë në bazë të aftësive. Kështu duhet të jetë jeta.”

Mbështetja që dha Arshavini konfirmoi emrin e mirë të Arsenalit si një klub që është aktiv në luftën kundër ekstremizmit dhe paragjykimeve. (Manaxheri i klubit Arsène Wenger kishte shpallur tashmë mbështetjen e tij për fushatën e Këshillit të Evropës).

Famile Arslan – Juriste hollandeze

Grupi mësoi rreth Cedar-it të përmendur më sipër nga një anëtare e bordit të tij drejtues, faqja e internetit e së cilit e përshkruan atë si “juristja e parë në Hollandë që mban shami”. Ajo na tregoi se familja e saj ishte zhvendosur nga Turqia për në Hollandë kur ishte fëmijë i vogël. Ajo u arsimua si një qytetare hollandeze por zbuloi se shoqëria holandeze e konsideronte atë turke dhe më vonë ajo u bë më e ndërgjegjshme për identitetin e saj mysliman. “Personalisht mendoj se identiteti im është i shumëfishtë. Kur isha e re, Islami ishte vetëm një pjesë e identitetit tim dhe nuk mund ta imagjinoja se një ditë unë do të isha më radikale dhe strikte se familja ime nga Turqia lindore. Kjo është pjesërisht rezultat i jetës time në Evropë, dhe unë do të doja të falënderoja Evropën për këtë.” Znj. Arslan erdhi në Stamboll për të takuar Grupin dhe na tregoi se kur lidhi rripin e sigurimit në taksi duke ardhur nga aeroporti, shoferi i kishte thënë “Ah, e shoh që qenke nga Evropa”.³⁸

Cem Özdemir – politikan gjerman

Cem Özdemir,³⁹ bashkëkryetar i Partisë së Gjelbër /*Die Grünen* (Gjermani), është kryetari i parë i një partie politike në Gjermani që ka prejardhje emigranti dhe që është bërë në fakt ekspert për çështjet e emigrimit dhe integritit për partinë e tij. Özdemir-i ka lindur në Bad Urach, Swabia, në vitin 1957. Prindërit e tij erdhën të punonin në Gjermani si *Gastarbeiter*, apo punonjës të ftuar. Ky term nënkuptonte se këta njerëz do të qëndronin në Gjermani përkohësisht dhe do të ktheheshin në vendin e tyre në kohën e caktuar. Edhe ata që kishin lindur apo ishin rritur në Gjermani nuk shiheshin si gjermanë, por si turq.

Sot njerëzit po fillojnë të kuptojnë se ekziston më shumë se një lloj gjermani. Problemet nuk janë zgjidhur ende, siç pohon dhe vetë Özdemir-i: “Ka disa gjermanë që mendojnë se dikush me emrin Cem Özdemir nuk mund të jetë gjerman.” Ai thotë se ka probleme në të dyja krahët: “Ka disa njerëz në anë të turke të cilët mendojnë se në qoftë se quhesh Cem Özdemir, duhet të jesh njeriu i turqve. Duhet të përfaqësosh vetëm turqit. Nuk jam dakort me këtë lloj të menduarit me baza etnike.”

Kur brezi i prindërve të Özdemir-it erdhi për të punuar në Gjermani, ata ruajtën gjuhën dhe traditat. Për ta, të ishte njëkohësisht turk dhe gjerman do të kishte qenë e paimagjinueshme. Megjithatë, kjo është diçka që tani është duke ndryshuar. Parukierja e Özdemir-it, Canan

37. Shih: <http://arshavin.eu/en/>.

38. Takim i zhvilluar në Stamboll, 15 janar 2011.

39. Shih: www.oezdemir.de/.

Ozgün, është rritur në Turqi dhe Gjermani dhe ndjehet njëlloj në të dyja vendet, ashtu si shumë banorë të Berlinit në vitet 20 dhe 30. Ajo shprehet se gjërat kanë ndryshuar shumë: “E di si ishte gjendja 20 vjet më parë nga prindërit e mi. Ata ishin këtu vetëm si punëtorë të ftuar, në punë të vështira. Tani, turqit dhe të huajt e tjerë janë bërë edhe punëdhënës. Cem Özdemir-i i tregon gjermanëve se dikush mund të integrohet në shoqërinë gjermane.”

Lilian Thuram – futbollist francez

Lilian Thuram, i lindur në Guadeloupe (Antilet franceze) në vitin 1972, është futbollisti francez që ka luajtur numrin më të madh të ndeshjeve me ekipin kombëtar francez. Ai ka luajtur gjithashtu për disa nga klubet më të mira në Evropë – Monako, Parma FC, Juventus dhe FC Barcelona. Është këshilltar i Komisionit të Lartë për Integrimin e Emigrantëve në Francë, një pozicion që i jep atij mundësinë të mbrojë lojtarët e tjerë kur bien viktimë e sulmeve raciste. Ai ishte gjithashtu i ftuar në një seminar sportiv të Këshillit të Evropës me temë “Sporti dhe diskriminimi: perspektiva mediatike” në vitin 2008. Në të njëjtin vit, ai themeloi Fondacionin Lilian Thuram: “Arsimi kundër Racizmit”.⁴⁰

Tomi Ungerer – artist nga Alsasa

Tomi Ungerer,⁴¹ artisti me famë ndërkombëtare nga Alsasa, u emërua Ambasador i Vullnetit të Mirë i Këshillit të Evropës për Fëmijët dhe Arsimin në tetor të vitit 2000. Në librat e tij për fëmijë si *Flix, Otto and the small blue cloud*, si dhe në shumë prej vizatimeve të tij, Ungerer bën përpjekje të lavdërueshme për të promovuar tolerancën dhe për t'i njohur fëmijët me idenë e të drejtave të njeriut.

7. Qytezat dhe qytetet

Gjatë historisë, qytezat dhe qytetet kanë qenë qendrat kryesore të diversitetit njerëzor, ku njerëz me kultura dhe prejardhje të ndryshme gjeografike mblidheshin së bashku dhe jetonin pranë njëri tjetrit. Ato janë vendet ku shkëmbehen mallrat dhe idetë, dhe kjo ka qenë gjithmonë motori kryesor i përparimit ekonomik dhe kulturor. Latinishtja dhe gjuhët që kanë rrjedhur prej saj nuk janë të vetmet në të cilat fjalët për “qytet”, “qytetar”, “civil” dhe “civilizim” lidhen me njëra tjetrën.

Sot, qytezat dhe qytetet janë gjithashtu vendet ku jeton pjesa më e madhe e evropianëve. Pra, janë ato vendet ku përgjithësisht gjenden bashkë njerëz me besime, kultura apo identitete etnike të ndryshme. Ndërkohë që debatet rreth “multikulturalizmit” zhvillohen në nivel kombëtar apo evropian, janë pikërisht qytezat dhe qytetet e Evropës vendet ku përjetohet ditë pas dite realiteti i shoqërive me shumëllojshmëri kulturash, bashkë me entuziazmin dhe kreativitetin, por edhe me problemet e tij. Ideja e një vendi është një element jetësor për formimin e identitetit – dhe kjo mund të përfshijë vendin ku njerëzit jetojnë aktualisht, si dhe vendin nga i cili ata e kanë prejardhjen. Duke i ndihmuar të përcaktojnë vendin, drejtuesit e qyteteve mund të ndihmojnë gjithashtu çdo banor të përcaktojë identitetin e tij/e saj.

Si rrjedhojë, një përgjegjësi e veçantë bie mbi zyrtarët e zgjedhur dhe ata profesionistë, të cilët qeverisin qytezat dhe qytetet në nivel lokal. Drejtuesit në nivel kombëtar mund të përcaktojnë kuadrin ligjor për veprimet e tyre, dhe deri diku të përcaktojnë temat e debatit. Megjithatë, janë kryetarët e bashkive apo këshillat

40. Shih: www.thuram.org/index.php?idioma=in&seccion=.

41. Shih: www.tomiungerer.com/.

bashkiake, të cilët punojnë me grupet e ndryshme vullnetare të përmendura më sipër, që duhet të trajtojnë problemet kur ato shfaqen. Në fund, është shpesh mençuria e tyre, apo mungesa e saj, që përcakton nëse njerëzit në një zonë të caktuar mund të jetojnë së bashku në mënyrë të suksesshme, pa konflikte apo stres të pakontrollueshëm.

Qytetet mbajnë përgjegjësinë kryesore për të bërë të mundur që shoqëritë me shumëllojshmëri kulturash të jenë shoqëri të hapura, në të cilat njerëzit që i përkasin grupeve të ndryshme kulturore, përfshirë ata që perceptohen si të ardhur apo banorë të përkohshëm, të ndjehen mirë dhe të japin kontributin e tyre, në mënyrën e tyre, për kohezionin e përgjithshëm social të qytetit. Kështu, organet lokale dhe rajonale duhet të luajnë një rol kyç në procesin e ndërtimit të marrëdhënieve harmonike dhe në uljen e tensioneve, të cilat shpesh lindin për arsye etnike, fetare apo kulturore. “Bashkëjetesa” do të thotë ndërveprim, dhe që kjo të ndodhë në mënyrë paqësore dhe efikase, në komunitete të shumëllojshme duhet të ekzistojë dialogu midis pjesëtarëve të grupeve të ndryshme etnike, fetare dhe kulturore. Është domosdoshmërisht e dyanshme: popullsia shumicë duhet të pranojë minoritetet, ndërsa ata duhet të pranojnë disa “rregulla loje” të zonës dhe përgjegjësi që për ata mund të jenë të reja. Ky proces përshtatjeje të ndërsjellë mund të përfshijë mosmarrëveshje dhe vështirësi, me të cilat duhet të merren organet lokale dhe rajonale.

Pjesëmarrja e e banorëve të huaj në jetën lokale dhe në politikë

E drejta e banorëve të huaj për të votuar në zgjedhjet për pushtetin vendor është në përgjithësi një çështje e legjislacionit kombëtar. Duhet të vihet në dukje se Konventa e Këshillit të Evropës e vitit 1992 për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal ka si qëllim të sigurojë që banorët e huaj që janë banorë të ligjshëm në një territor, në vend që të përjashtohen nga jeta publike lokale, të njihen si partnerë të çmuar në një demokraci lokale funksionale. Kjo mund të përmirësojë marrëdhëniet midis banorëve të huaj dhe sektorëve të tjerë të komunitetit (autoritetet politike, organet administrative “vendësit”), duke përfituar kështu jo vetëm banorët e huaj por e gjithë shoqëria. Demokracia fillon në nivel lokal dhe demokracia e vërtetë lokale kërkon pjesëmarrjen e të gjithë banorëve të komunitetit.

Portrete

Neuchâtel

Kantoni Neuchâtel⁴² në pjesën frëngjishtfolëse të Zvicrës ka rreth 170 000 banorë, nga të cilët 40 000 janë të huaj. Në Zvicër, emigracioni shihet me frikë nga shumë qytetarë “vendas”, të

42. Në vitin 2008, Këshilli i Evropës filloi programin “Qytetet ndërkulturore” (www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/culture/Cities/Default_en.asp), i cili synonte të transformonte mënyrën se si qytetet kuptojnë dhe i përgjigjen diversitetit kulturor. Ai filloi si një skemë pilot, ku përfshiheshin 11 qytete në pjesë të ndryshme të Evropës, por tani rrjeti është duke u hapur jo vetëm ndaj qyteteve të reja evropiane por edhe ndaj qyteteve në pjesë të tjera të botës. Përgjithësisht, në ato qytete ku është zbatuar projekti ekziston paqja dhe respekti i ndërsjellë midis komuniteteve, ku këto të fundit marrin të gjitha pjesë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror; ka shumë më pak dhunë; të ardhura për frymë mbi mesataren. Në këto përshkrime jepen katër shembuj

cilët mendojnë se ai mund të zbehë vlerat e tyre kombëtare dhe se emigrantët mund të mos jenë besnikë ndaj vendit të tyre të ri. Për këtë arsye tani kantoni është duke propozuar një kartë qytetarie dhe vlerash civile të cilat i shpjegohen të porsaardhurve.

Neuchâtel-i ka ngritur themele të shëndosha ligjore dhe funksionale për politikat e integritimit, ku përfshihen:

- një Zyrë të Komisionerit për të Huajt, stafi prej 11 personash i së cilës është i gjithi me prejardhje etnike apo kombësi të huaj dhe flasin me njëri tjetrin shumë nga 95 gjuhët që fliten në komunitet;
- një Komision për Integrimin e të Huajve, me 40 anëtarë, i cili funksionon si një organ këshillues për Këshillin Shtetëror (qeveria kantonale).

Qeveria nxit, por nuk detyron banorët që të mësojnë frëngjisht. Mësimi i gjuhës shihet si rezultat i integritimit shoqëror dhe kulturor, por jo një kusht për ta arritur atë – dhe kjo qasje funksionon. Në një referendum të vitit 2007, shumica e qytetarëve vendosën t'i jepnin të drejtën e votës të gjithë banorëve – duke treguar kështu se të huajt shihen me sy më pozitiv se më parë. Kjo mund të jetë pjesërisht rezultat i fushatës nëntë mujore Neuchâtoi (“Neuchâtel-i është i yti”) vitin e kaluar, e cila pati sukses të jashtëzakonshëm, duke mbledhur 260 000 njerëz në aktivitete të tilla si shfaqje teatrale, veprimtari shkollore, shfaqje filmash, ushqime ekzotike në restorantet e zonës, transmetime në radio dhe televizion, libër me poezi dhe artikuj të shkruar nga gazetarë, ekspozita, konferenca dhe debate, fushata me postera, si dhe konferenca shtypi.

Situata e përgjithshme e punësimit në kanton është e kënaqshme, pjesërisht falë dinamizmit ekonomik të rajonit, por edhe si pasojë e përpjekjeve të vazhdueshme nga ana e autoriteteve në të mirë të integritimit të punëtorëve, e cili është fokusi i id e projekteve lokale.

Shkollat janë pjesë e përpjekjeve për integrim, si për shembull duke organizuar orë mësimore me program të përshtetshëm të gjuhës franceze, për të cilën ata mund të kërkojnë mbështetje nga shërbimi “ndërmjetësimi ndërkulturor” i kantonit. Organizohen seanca informacioni për prindërit dhe ka një klasë “të rinjtë në tranzicion” për nxënësit që kanë kaluar moshën e arsimit të detyruar dhe që kanë nevojë për të përmirësuar shprehitë gjuhësore përpara se të fillojnë arsimin e rregullt.

Shërbimi Délégue aux Etrangers ofron një shërbim ndërmjetësimi për individët apo grupet që e kërkojnë atë (dhe në disa raste edhe për ata të cilët nuk e kërkojnë një gjë të tillë). Ai luan një rol aktiv në bisedimet midis palëve të përfshira në konflikte të caktuara. Ai funksionon nëpërmjet ndërmjetësve dhe përkthyesve pa pagesë, si dhe një qendre për këshillime në gjuhën amtare.

E gjithë kjo mund të ketë lidhje me faktin se Neuchâtel-i ishte një nga katër kantonet në Zvicër që votoi kundër ndalimit të minareve në vitin 2009.

Rexho-Emilia

Rexho-Emilia, një qytet i pasur në Italinë veriqendrore (Emilia-Romanja), ka përqindjen më të lartë të banorëve të huaj në popullsinë e tij se çdo qytet tjetër italian. Përparësitë aktuale të politikave të tij publike janë: trajnim për të mbështetur integrimin ndërkulturor; kohezion social; përmirësim i kualifikimeve; dhe shërbime kulturore. Këto politika synojnë t'i japin qytetarëve një sërë mundësish kulturore, duke nxitur kështu një model zhvillimi që shmang përjashtimin shoqëror dhe i jep të gjithëve mundësi të barabarta për të mira dhe shërbime.

nga qytetet që janë pjesë e këtij rrjeti: Neuchâtel (Zvicër), Reggio-Emilia (Itali), Subotica (Serbi) dhe Tilburg (Hollandë).

Falë këtyre politikave, Rexho-Emilia ka fituar reputacionin si një “qytet i hapur, i sigurt dhe bashkëpunues”. Politikat e tij arsimore nxitin një qasje pozitive ndaj diversitetit tek të rinjtë dhe shpjegojnë se si krijohen stereotipet dhe paragjykimet që mund të çojnë në sjellje diskriminuese. Për sa i përket strehimit, qyteti ka formuar një Pakt të Kuadrit Lokal me lagjet e ndryshme. Një grup pune i shoqërisë civile dhe shërbimeve sociale është duke i përqendruar përpjekjet tek çështjet e fëmijëve, duke propozuar një parlament të fëmijëve, si projekt kryesor pilot. Nëpërmjet festivaleve vjetore Mondinpiazza dhe një aktiviteti sportiv, “Due calci al razzismo” (“dy gjuajtje kundër racizimit”), qyteti nxit bashkëpunimin ndërmjet operatorëve bashkiakë, shoqatave lokale, qytetarëve, artistëve, komuniteteve të ndryshme minoritare, forcave të policisë, grave italiane dhe/ose të huaja, individëve me paafësi të ndryshme, administratorëve lokalë, nxënësve të shkollave të mesme, e kështu me rradhë. Është arritur progres i veçantë në bërjen e sistemit shëndetësor më të hapur për komunitetin kinez. Gjashtë spitalet rreth Rexhos përfitojnë nga shërbimi i ndërmjetësimit ndërkulturor, me një strategji të hollësishme, një plan veprimi, si dhe me të dhëna të publikuara për arritjet e shërbimit. Ka gjithashtu një projekt, në bashkëpunim me organet vendore të shëndetësisë, për të përmirësuar marrëdhëniet gjuhësore dhe kulturore midis qytetarëve të huaj dhe shërbimit shëndetësor. Ofrohen kurse bazë të gjuhës italiane për nënat e fëmijëve që ndjekin shkollën fillore, në mënyrë që t’i mundësohet mbështetje fillestare për gjuhën dhe komunikim të mirë me shkollën. Ka gjithashtu aktivitete verore ku i mësohet gjuha italiane nxënësve të shkollave të mesme të cilët zotërojnë njohuri jo të mjaftueshme për gjuhën.

Subotica

Subotica është një qytet multi-etnik in Serbinë Veriore (Vojvodinë). Në vitin 1999 periferia e Peskarës kishte 5 000 banorë me prejardhje etnike hungareze, kroate, serbe, boshnjake dhe Bunjevace, dhe vetëm pak Romë, në kohën kur më shumë se 500 Romë erdhën aty nga Kosova*. Problemet filluan kur u bë e qartë se ata ishin vendur në atë tokë (e cila ishte shumë e lirë) dhe nuk dëshironin të ktheheshin. Në shkurt të vitit 2006, 147 banorë jo-Romë të Peskarës nënshkruan një ankesë kundër të sapoardhurve dhe sjelljes së tyre të përditshme. Drejtori i Qendrës për Arsimimin e Romëve në Subotica thirri një mbledhje të përbashkët të përfaqësuesve të të gjithë qytetarëve nga Peskara, të pushtetit vendor, policisë, Qendrës për Punë Sociale, shkollës dhe qendrës shëndetësore të zonës. Ata ranë dakort që Romët duhet të zgjidhnin problemet për të cilat ishin të shqetësuar nënshkruesit e peticionit, si mbledhjen së bashku të të rinjve Romë natën vonë, muzika e lartë, etj. Në të njëjtën kohë, ata ranë dakort të ngrinin Komisionin me nëntë anëtarë për Marrëdhëniet Ndëretnike (i cili ende vepron sot) dhe dolën në përfundimin se problemi kryesor i të gjithë zonës ishte mungesa e një rruge të përshtatshme. Me një grant prej 1 000 eurosh të organizatës Save the Children, me mbështetjen e autoriteteve të qytetit dhe me punën vullnetare të të gjithë qytetarëve (Romë dhe jo Romë), ata përfunduan rrugën dhe e festuan atë në nivel qyteti dhe lagjeje.

Romët vazhdojnë të jenë pjesë e komisioneve që merren me çështjet sociale, arsimore dhe ndëretnike në Peskara dhe tani janë të integruar mirë në jetën e komunitetit. Shkolla fillore e zonës ka më shumë se 100 nxënës Romë, ku më shumë se 90% e tyre janë fëmijë të Romëve nga Kosova* – ndërkohë që para këtyre zhvillimeve e njëjta shkollë refuzonte të pranonte edhe fëmijët Romë të zonës. Sot prindërit Romë marrin pjesë në Këshillin e Prindërve dhe fëmijët Romë janë gjithashtu pjesë e programit parashkollor, me ndihmën e një asistenti Rom.⁴³

* Shih shënimin 26 në fund të faqes.

43. Informacion nga Stevan Nikolic, Drejtor i Qendrës për Arsimimin e Romëve nga Subotica.

Tilburg

Tilburgu është një qytet në jug të Hollandës me mbi 200 000 banorë, 23% e të cilëve nuk kanë prejardhje hollandeze, dhe që vijnë nga rreth 200 shtete të ndryshme.

Përvoja e Tilburgut me trajtimin e emigrantëve apo njerëzve me prejardhje emigranti është shembull i mirë i një qyteti, i cili për shumë vite ndërmoi një qasje komuniteti apo etnike, duke pasur si objektiv disa grupe të veçanta emigrantësh në politikat e tij për arsimimin, punësimin dhe sigurinë. Megjithatë, në vjeshtën e vitit 2010, siç i shpjegoi Grupit Alderman Berend de Vries,⁴⁴ këshilli bashkiak i Tilburgut vendosi të braktiste këtë politikë dhe të kishte një qasje të re, “Të gjithë Banorët e Tilburgut”, sipas së cilës, në vend që papunësia, largimi i hershëm nga shkolla, pengesat gjuhësore dhe sjelljet antishoqërore, të trajtohen si probleme etnike që kërkojnë zgjidhje etnike, ato duhet të jenë përgjegjësi e shërbimeve të përgjithshme dhe institucioneve.

Z. de Vries shtoi se “parimi kryesor prapa kësaj qasjeje është se përgjegjësia për pjesëmarrje të plotë në shoqëri duhet të bjerë mbi individët e veçantë. Kjo do të kërkojë që institucionet tona të mos i kushtojnë rëndësi prejardhjes etnike. Kur një banor i Tilburgut me origjinë turke vjen tek zyra e informacionit për bizneset e vogla, atij ose asaj duhet t’i jepet ndihma e nevojshme si një sipërmarrës dhe jo siç ndodh tani herë pas here, duke i drejtuar ata tek shërbimi i integritetit. Në të njëjtën kohë, shërbimet dhe institucionet duhet të bëhen gjithashtu më të ndjeshme ndaj kulturës. Një punonjës i shërbimit social apo i kujdesit në shtëpi duhet të pranojë faktin se disa banorë të qytetit janë ndryshe nga të tjerët. Kur bëhen përpjekje për të ndihmuar grupet në nevojë, është e rëndësishme që njerëzit me prejardhje të ndryshme etnike të kenë gjithashtu mundësinë të përfitojnë. Në vitet në vazhdim ne do të monitorojmë një gjë të tillë në disa zona dhe kjo do të thotë se do të vazhdojmë të kemi parasysh prejardhjen etnike. Duke bërë një gjë të tillë, sigurisht që përkatësia etnike nuk është përgjigjja, por duhet pranuar deprivimi përpara se mund të krijosh mundësi.

Metodës së re do t’i jepet kryesisht formë konkrete në qasjen për zonën. Do të përcaktohen tre qëllime kryesore për pesë zona të deprivuara: të rinjtë të kenë rezultate të mira në shkollë dhe të diplomohen; çdo familje të ketë një pjesëtar që nxjerr të ardhurat; dhe banorët të jetojnë mbi kufirin e varfërisë. Nuk do të bëhet asnjë dallim për sa i përket prejardhjes etnike, por do të përqendrohemi vetëm tek problemet. Këshilli bashkiak dhe partnerët e tij (korporatat e strehimit, agjensitë e përkrahjes sociale dhe shërbimeve shëndetësore) kanë përcaktuar një periudhë kohore prej 10 vjetësh për përmbushjen e këtyre objektivave. Do të përdorim metodën e Përgjegjësisë në bazë të Rezultatit. Kur përdoret kjo metodë, përqendrohesh tek qëllimet dhe monitoron në mënyrë periodike efektin e ndërhyrjeve që kryen. Nëse gjykohet se efekti nuk është i mjaftueshëm, modifikon ndërhyrjet menjëherë.

Deklarata zyrtare e Tilburgut për politikën e tij ndërkulturore: “Çdo banor i Tilburgut, pavarësisht prejardhjes, është pjesë e komunitetit të qytetit të Tilburgut, mban përgjegjësinë për të ruajtur cilësinë e jetës së këtij qyteti, si dhe punon për të. Në të njëjtën kohë, ne pranojmë dhe vlerësojmë diversitetin e njerëzve dhe grupeve në qytet sepse jemi të gjithë banorë të Tilburgut.”

8. Shtetet anëtare

Të gjithë aktorët e dhënë më sipër veprojnë nën nivelin e shtet-kombeve të pavarura, dhe për të qenë efikasë ata duhet të jenë realisht të pavarur dhe të vetëmotivuar.

44. Komunikatë për Grupin, Bruksel, 17 mars 2011.

Megjithatë, ata gjithashtu mund të përfitojnë, dhe shpesh do të kenë nevojë, për mbështetje financiare dhe morale nga qeveritë, dhe në përgjithësi kuadri ligjor për integrimin përcaktohet në nivel kombëtar. Si rrjedhojë, është shumë e rëndësishme që autoritetet kombëtare të kenë strategji integrimi dhe të jenë të gatshme për të marrë masa të caktuara kur është e nevojshme. Këto strategji duhet të përfshijnë masa për të realizuar synimet e mëposhtme:

- a. të sillen së bashku komunitetet;
- b. të përdoret arsimi për të rritur ndërgjegjësimin për diversitetin kulturor dhe fetar;
- c. t'i ofrohet ndihmë e veçantë personave me vështirësi sociale-ekonomike;
- d. të rregullohen problemet arsimore;
- e. t'u mësohet emigrantëve dhe fëmijëve të tyre gjuha kombëtare, ndërkohë që t'i jepet atyre mundësia për të ruajtur gjuhën e tyre të origjinës;
- f. të ofrohet ndihmë në lidhje me punësimin;
- g. t'i jepet e drejta e votës dhe e shtetësisë një numri sa më të madh banorësh;
- h. të miratohen politika më njerëzore në drejtim të migrantëve të papajisur me dokumente apo azilkërkuesve.

9. Institucionet evropiane dhe ndërkombëtare

Shumë institucione ndërqeveritare, si në nivel evropian ashtu edhe në atë global, janë të shqetësuar për çështjet që trajtohen në këtë raport. Ndër to janë Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë, Organizata Ndërkombëtare e Migracionit, dhe Kombet e Bashkuara, veçanërisht nëpërmjet Aleancës së saj të Civilizimeve. Megjithatë, dy institucione që duhet të luajnë një rol vendimtar për të ndihmuar evropianët të jetojnë së bashku janë Bashkimi Evropian dhe, veçanërisht nëpërmjet Gjykatës së tij të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës.

Gjatë dy dekadave të fundit, Bashkimi Evropian ka luajtur një rol gjithmonë e më të rëndësishëm për bashkërendimin e politikave të migracionit dhe azilit të shteteve të tij anëtare, veçanërisht për ato që janë pjesë e Traktatit të Shengenit, të cilat kanë hequr kontrollat e pasaportës dhe vizës në kufijtë e tyre të brendshëm. Si Komisioni ashtu edhe Këshilli Evropian⁴⁵ kanë miratuar një sërë dokumentesh për politikat ndaj emigrimit, përfshirjes, integritetit dhe shtetësisë. Megjithatë, nuk mund të thuhet ende se shtetet anëtare kanë rënë dakort për një strategji tërësisht gjithëpërfshirëse në ndonjë prej këtyre fushave. Përpjekjet për të realizuar një strategji të tillë për përfshirjen e Romëve janë intensifikuar që prej vjeshtës së vitit 2010, kur disa shtete të Evropës perëndimore kryen dëbime në masë të Romëve të cilët kishin emigruar nga Evropa Lindore në atë Perëndimore, që në kohën kur shtetet e tyre u bënë anëtare të Bashkimit Evropian në vitin 2004 dhe 2007. Strategjia e Komisionit “Evropa 2020” ka përcaktuar tashmë objektiva për shtetet anëtare në dy drejtime: arsimit (90% e fëmijëve Romë të përfundojnë shkollën fillore) dhe punësimi (75% e Romëve në moshë pune të gjejnë punë). Më 6 prill të vitit 2011, Viviane Reding, Komisionerja e

45. Këshilli Evropian (nuk duhet të ngatërrohet me Këshillin e Evropës!) është emri që përdoret për takimet e rregullta të udhëheqësve politikë të të gjitha shteteve anëtare të BE-së. Komisioni Evropian është organi ekzekutiv i Bashkimit Evropian.

BE-së për Drejtësi, të Drejtat Themelore dhe Shtetësinë, i dha shteteve anëtare një afat tetë muaj për të shpallur planet e tyre kombëtare për këtë çështje, dhe në qershor pritet që Komisioni të paraqesë një Komunikatë të re për Integrimin.

Për sa i përket Këshillit të Evropës, i cili kërkoi hartimin e këtij raporti, lufta kundër të gjitha formave të diskriminimit dhe nxitjes së diversitetit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, përbëjnë thelbin e misionit dhe objektivave të tij. Ai ka një sërë organesh dhe departamentesh që janë ngritur për këtë qëllim, përfshirë këtu Komisionerin për të Drejtat e Njeriut dhe Komisionin Evropian kundër Racizmit dhe Mungesës së Tolerancës.⁴⁶ Megjithatë, institucioni i tij më i rëndësishëm, dhe në të vërtetë unik, është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut,⁴⁷ e cila interpreton dhe vë në zbatim Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe shqyrton ankesat kundër shteteve anëtare të bëra ose nga shtete të tjera anëtare ose nga individë të veçantë. Rreth 800 milion individë dhe 47 shtete janë objekt i Konventës dhe si rrjedhojë edhe të juridiksionit të Gjykatës.

Ndoshta sfida më e madhe për Gjykatën vitet e fundit ka qenë nevoja për të balancuar diversitetin dhe unitetin, si dhe të harmonizojë parimet universale dhe standardet e shprehura në Konventë me kulturat dhe traditat e shoqërive gjithmonë e më të larmishme evropiane. Megjithatë, është shprehur qartë nga Gjykata se veprimet që sjellin abuzim me të drejtat e njeriut nuk mund të justifikohen asnjëherë duke përdorur kulturën, besimin fetar, traditën apo zakonet.⁴⁸

Gjykimet e kohëve të fundit nga ana e Gjykatës kanë vendosur parime të rëndësishme në fushat e mëposhtme, të cilat lidhen me tematikën e këtij raporti.

Liria e besimit fetar

Gjatë 10 viteve të fundit ka pasur një rritje të dukshme të numrit të rasteve që lidhen me këtë të drejtë. Në mënyrë të veçantë, rregullorja për veshjet fetare ka shkaktuar debate të konsiderueshme. Për sa i përket aspektit të brendshëm të lirisë së besimit fetar, Gjykata përgjithësisht ka shprehur qëndrimin se shteti mund të mos i kërkojë individëve të shprehin besimet e tyre fetare.

46. Të dyja i dhanë fakte Grupit në Strasburg më 15 tetor të vitit 2010.

47. Grupi mori të dhëna nga Vincent Berger, Jurist i gjykatës, në takimin e tij në Bruksel më 18 mars 2011.

48. *Dialog ndërkulturor në kuadër të mbrojtjes evropiane të të drejtave të njeriut*, Patricia Wiater, Botim i Këshillit të Evropës, mars 2010.

Minoritetet etnike, përfshirë Romët

Gjykata nuk ka dhënë një përkufizim lidhur me atë se çfarë do të thotë një minoritet kombëtar. Në fakt, ajo duket se parapëlqen referencat ndaj njërit nga tiparet e një grupi të caktuar minoritar, siç është identiteti i tyre “etnik”. Në përgjithësi, ajo i ka siguruar mbrojtje jo të drejtpërdrejtë individëve të veçantë të grupeve minoritare, duke shfrytëzuar parimin e respektimit të pluralizmit demokratik dhe nëpërmjet klauzolave të Konventës që ndalojnë diskriminimin. Gjykata ka pranuar gjithashtu se identiteti etnik është një element thelbësor i identitetit të individit; dhe ka pranuar të drejtën e individëve që i përkasin minoriteteve për të formuar shoqata, në mënyrë që të promovojnë kulturën e tyre dhe ndërgjegjen minoritare.

Gjykata ka njohur gjithashtu vështirësinë e veçantë të Romëve dhe shpesh ka mbështetur ankesa të bëra nga Romët në zona të ndryshme. Në mënyrë të veçantë, ajo ka pranuar se shteti është i detyruar të hetojë dhe të ndjekë penalisht personat që ushtrojnë dhunë kundër Romëve, qofshin këta aktorë privatë apo zyrtarë të shtetit. Ajo ka pohuar përsëri se ndarja në shkolla e fëmijëve Romë (në shkolla për fëmijë me probleme dhe në shkolla të ndara nga shkollat e përgjithshme) përbën diskriminim të paligjshëm.

Minoritetet fetare

Mbrojtja e minoriteteve fetare përfshin në përgjithësi të njëjtat të drejta si ato të minoriteteve etnike apo Romëve. Megjithatë, çështja më urgjente lidhet me manifestimin e besimeve të gjithsecilit. Përveç çështjes së veshjes fetare që përmendëm më sipër, shfaqja e simboleve fetare në klasat e një shteti ka shkaktuar shumë debat.⁴⁹

Në disa raste që lidhen me dënime për nxitje të urrejtjes kundër komuniteteve myslimane dhe emigrantëve, Gjykata ka pranuar një shkallë të lartë zgjedhjeje për shtetet për të vlerësuar nevojën e ndërhyrjes në lirinë e shprehjes së individit, duke pasur parasysh shkallën e ndryshme të problemeve me të cilat përballen, në kuadrin e politikave të tyre ndaj komuniteteve me prejardhje emigranti të kohëve të fundit dhe nevojës për të ruajtur rendin publik. Në disa vendime të tjera, Gjykata ka theksuar se është shumë e rëndësishme që politikanët të shmangin komentet të cilat mund të nxisin mungesën e tolerancës gjatë shfaqjeve të tyre publike.

Sfida e emigracionit

49. Në datën 18 mars 2011, në çështjen *Lautsi e të tjerë kundër Italisë*, e cila kishte të bënte me praninë e kryqeve në klasat e shkollave shtetërore italiane, Gjykata vendosi se nuk kishte cënim të Konventës. Ajo mendonte se çështja e simboleve fetare në klasë ishte, në parim, një çështje që lidhet me vlerësimin e shtetit – veçanërisht duke pasur parasysh se nuk kishte konsensus evropian për këtë çështje – me kusht që vendimet në këtë fushë nuk do të çonin në ndonjë formë indoktrinimi.

Pjesa më e madhe e vendimeve të Gjykatës për “emigrantët” mund të ndahen në dy grupe të përgjithshme çështjesh. E para ka të bëjë me situatat ku aplikuesit pretendojnë se dëbimi do t’i ekspozojë ata ndaj torturës dhe keqtrajtimit. Ky është shpesh një rast refugjatësh, ku aplikuesi ka aplikuar pa sukses për azil sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1951, që lidhet me Statusin e Refugjatëve (Konventa e Gjenevës), ose kur i është hequr statusi i refugjatit. (Në rastin e parë të çështjeve, Gjykata kohët e fundit i ka dhënë rëndësi të madhe nevojës së veçantë të azilkërkuesve.) Lloji i dytë i çështjeve ka të bëjë me vendimet e marra nga autoritetet e emigracionit për të dëbuar, apo refuzuar hyrjen për persona që kërkojnë të qëndrojnë, apo të bashkohen me pjesëtarët e tjerë të familjes. Gjithashtu, është çështja e ndalimit në pritje të kthimit; si dhe çështje të tjera që lidhen me jetën private: mohimi i arsimit kur fëmijët janë të detyruar të shoqërojnë një prind që po largohet; diskriminimi, kur rregullat e emigrimit duket se trajtojnë disa grupe në mënyrë më pak favorizuese se të tjera; dhe problemi nëse janë efikase zgjidhjet e dhëna nga autoritetet kombëtare për aplikuesit që pretendojnë se përballen me rrezikun për torturë, keqtrajtim apo ndikim në jetën e tyre familjare. Së fundi, lindin çështje të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat shoqërore të “emigrantëve” dhe mundësinë e tyre për t’u martuar apo që t’u njihet martesë.

Ky studim i shkurtër trajton shumëllojshmërinë dhe kompleksitetin e çështjeve të të drejtave të njeriut që lindin në kuadrin e “bashkëjetesës”, si dhe rolet shumë të rëndësishme që luhen nga Gjykata, e cila shpesh është mundësia e fundit e mbrojtjes për personat të cilëve u cënohen të drejtat, si dhe Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, funksioni themelor i të cilit është të sigurojë që shtetet anëtare të veprojnë në përputhje me vendimet e Gjykatës.

C. Propozime për veprim

I. Rekomandime strategjike

1. Njerëzit të cilët vijnë të jetojnë në një shtet të ri, si dhe pasardhësit e tyre, nuk duhet të ndjehen të detyruar të lënë pas besimin, kulturën dhe identitetin e tyre. Por, si çdokush tjetër, ata duhet të respektojnë ligjin, duhet të mësojnë gjuhën që përdoret nga pjesa më e madhe e fqinjëve të tyre të rinj, dhe duhet të përpiqen të bëhen të dobishëm për shoqërinë në të cilën jetojnë.
2. Duke qenë se banorëve në një territor të një shteti u kërkohet të zbatojnë ligjet e tij, ne besojmë, si çështje e një parimi themelor demokratik, se ata duhet të shprehin mendimin e tyre gjatë hartimit të këtyre ligjeve. Si rrjedhojë, të gjitha shtetet duhet të përpiqen të ofrojnë të drejtat dhe detyrimet e plota të

shtetësisë, përfshirë këtu të drejtën për të votuar, për sa më shumë banorë që ata të munden.

3. Nxisim të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës të cilat nuk kanë bërë një gjë të tillë deri tani, të punojnë në drejtim të një ligji modern për shtetësinë, sipas të cilit mundësia për të marrë shtetësinë të gjykohet në bazë të kriterëve qytetare dhe jo etnike.
4. Pas dhënies së shtetësisë, të drejtat dhe privilegjet që rrjedhin prej saj duhet të jenë të barabarta për të gjithë.
5. Si një hap i parë drejt saj, personat që nuk kanë shtetësinë, të çfarëdo origjine qofshin, duhet të lejohen të votojnë në zgjedhjet për pushtetin vendor në qytetin apo rajonin ku banojnë (siç ndodh tashmë me shtetasit e Bashkimit Evropian që banojnë në një shtet anëtar jashtë shtetit të tyre).
6. Nxisim drejtuesit evropianë, të të gjitha niveleve dhe profesioneve (politikë, kulturë, media, arsim, shoqëri civile), të tregojnë virtyte të vërteta drejtuesi, duke dënuar deklaratat ekstremiste, raciste, ksenofobike dhe kundër emigrantëve, kurdo dhe kudo që ata i hasin; si dhe të këmbëngulin që të gjitha kërcënimet kriminale për dhunë për arsye racore, etnike, fetare apo të tjera, të hetohen dhe të ndiqen penalisht në mënyrë sistematike, duke u mbështetur tek instrumentet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.
7. Të gjithë qytetarët duhet të jenë të gatshëm për të dënuar abuzimet verbale si dhe të korrigjojnë imazhin e shtrembëruar të ndonjë grupi, sa herë që ata përballen me një gjë të tillë. Personat me pozicion drejtues kanë një përgjegjësi të veçantë për ta bërë një gjë të tillë, dhe sa herë të jetë e mundur ata duhet të ofrojnë një përshkrim të drejtë dhe të saktë të besimeve, kulturës dhe veprimtarive të grupeve të tjera – ashtu siç bëjnë ata të cilëve fama ose profesioni i jep mundësi më të mëdha për t'u shfaqur në media dhe për të qenë në vëmendjen e publikut.
8. Ndërkohë që debati aktual politik në Evropë ndizet nga informacione të gabuara dhe stereotipe për emigrimin, nxisim shtetet anëtare të Këshillit të Evropës t'i ofrojnë qytetarëve evropianë një pasqyrë më realiste të situatës së emigrantëve dhe nevojave aktuale dhe ato të së ardhmes së Evropës në fushën e emigrimi; si dhe të përkrahin një ligjërim politik më të informuar në lidhje me emigrimin dhe diversitetin.
9. Autoritetet, policia dhe gjykatat në të gjitha nivelet, në të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, duhet të bëjnë gjithçka që është në autoritetin e tyre për të siguruar që emigrantët (me ose pa dokumente), njerëzit me prejardhje emigranti të kohëve të fundit dhe pjesëtarët e komuniteteve, të mbrohen, dhe personat që ushtrojnë ndaj tyre dhunë, abuzim apo shfrytëzim të paligjshëm, të arrestohen dhe të ndëshkohen sipas ligjit. Ato duhet të tregojnë gjithashtu kujdes të jashtëzakonshëm për të trajtuar të gjitha pjesët e popullsisë në mënyrë të barabartë dhe të mos ushtrojnë apo të tolerojnë kryerjen nga ana e grupeve apo institucioneve të tjera të çdo lloji diskriminimi kundër emigrantëve apo pjesëtarëve të minoriteteve, si në arsim, punësim, apo lejin

e mundësisë për mallra, banesa, hapësira dhe ambiente publike, si dhe shërbime. Në rastet kur një mundësi e tillë i mohohet dikujt për shkaqe racore, fetare, gjinore apo orientimi seksual, ai person duhet të jetë në gjendje të marrë zhdëmtim të plotë dhe të menjëhershëm sipas ligjit.

10. Autoritetet kompetente në të gjitha nivelet duhet të identifikojnë grupet që përjetojnë vështirësi sociale-ekonomike të veçanta (të tilla si papunësi e lartë në mënyrë disproporcionale, nivel të ulët arsimimi dhe/ose të ardhurash familjare, strehim të papërshtatshëm) dhe të bëjnë përpjekje të veçanta, me alokimin e burimeve të përshtatshme, për t'i mundësuar anëtarëve të këtyre grupeve, veçanërisht fëmijëve dhe të rinjve, të tejkalojnë këto vështirësi dhe të gëzojnë barazi të vërtetë mundësish me pjesën tjetër të popullsisë.
11. Inkurajojmë të gjitha shtetet anëtare që nuk e kanë bërë ende një gjë të tillë, të përmirësojnë dhe të zbatojnë ligjet e tyre kundër të gjitha formave të diskriminimit në të gjitha sferat e jetës publike, duke përfshirë edhe mediat. Kjo duhet të jetë e mbështetur nga mekanizma solidë që kuptohen mirë nga publiku i gjerë dhe zbatohen nga qeveritë.
12. Duke qenë se gjendja e Romëve në të gjithë Evropën është një turp për të gjithë kontinentin, dhe një nga shkeljet më të vazhdueshme nga ana e evropianëve të asaj që ne na pëlqen ta mendojnë si “vlera evropiane”, i bëjmë thirrje drejtuesve evropianë në të gjitha nivelet që të kthejnë vuajtjet e tyre, të shtuara nga riatdhesimet masive nga Evropa perëndimore në atë lindore, në veprime që do të eliminojnë në mënyrë efikase diskriminimin kundër tyre.
13. Shtetet kanë të drejtën dhe detyrën për të drejtuar dhe kontrolluar emigracionin, por njerëzve të cilëve u mohohet e drejta për të hyrë apo qëndruar nuk i hiqen të drejtat e tyre themelore. I bëjmë thirrje të gjithë evropianëve për të trajtuar azilkërkuesit dhe emigrantët që vijnë në Evropë në mënyrë të drejtë dhe humane.
14. Ata që zhvendosen më tej nga zonat e mbërritjes duhet të jenë të gatshëm të luajnë rolin e tyre të plotë në këtë përpjekje. Kjo kërkon solidaritet dhe ndarje vështirësie nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.
15. I bëjmë thirrje të gjitha shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për të punuar drejt një politike gjithëpërfshirëse, koherente dhe transparente për emigracionin, pasi mungesa e një politike të tillë krijon probleme të mprehta, të cilat shpesh duhet të trajtohen në nivel lokal.
16. Rekomandojmë ndërmjetësimin si një mjet për tu përdorur në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në të gjitha nivelet politike, veçanërisht në nivel lokal, dhe nxisim autoritetet për të siguruar që një numër i mjaftueshëm njerëzish do të trajnohen për të marrë këtë funksion.
17. I bëjmë thirrje të gjithë popujve të Evropës për t'i shtrirë dorën e solidaritetit njerëzve në pjesët e tjera të botës, sidomos fqinjëve të tyre në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, të cilët tani me guxim janë duke shfaqur përkushtimin e tyre ndaj vlerave universale të lirisë dhe demokracisë.

Përsëritës veçanërisht guximin dhe mençurinë e atyre që kanë luftuar ose janë duke u përpjekur për të arritur lirinë pa dhunë, madje edhe kur kërcënohen me dhunë të skajshme nga ata që do t'ia mohonin atyre një gjë të tillë. Prandaj, ne nxisim institucionet kryesore evropiane (Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë) për të zhvilluar politika gjithëpërfshirëse drejt Mesdheut jugor dhe lindor, vendeve të Azisë Qendrore dhe Lindjes së Mesme, dhe për t'i dhënë atyre mundësinë, kur ata kërkojnë dhe janë në gjendje për ta bërë këtë, të përfitojnë nga përvoja dhe ekspertiza e Evropës në ndërtimin e shoqërive bazë të shtetit të së drejtës, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, veçanërisht duke marrë pjesë, me një status të përshtatshëm, në institucionet dhe konventat evropiane. Një politikë e tillë duhet të lejojë gjithashtu evropianët për të përfituar nga përvoja dhe urtësia e fqinjëve të tyre, dhe për të vlerësuar më mirë trashëgiminë historike dhe kulturore të sjellë në Evropë nga shumë prej atyre që janë vendosur këtu kohët e fundit.

II. Rekomandime të veçanta

Edhe pse ky raport është autorizuar nga Këshilli i Evropës, ne na u kërkua “të përcaktonim një koncept të ri të ‘bashkëjetesës’, i cili do të mund t'i propozohej qytetarëve të shoqërive evropiane”. Në të vërtetë, ne besojmë se kjo është një përpjekje e cila nuk mund të bëhet nga çdo lloj institucioni, por në të cilin të gjithë evropianët duhet të luajnë rolin e tyre, si nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në të gjitha nivelet dhe përmes veprimit vullnetar, ashtu edhe në organet e organizuara, apo si individë. Kështu, ne ja drejtojmë këto rekomandime jo vetëm Këshillit të Evropës, por të gjitha shteteve të tij anëtare, si dhe autoriteteve lokale dhe rajonale, dhe shoqërisë civile brenda tyre.

Rekomandimet janë grupuar sipas temës. Disa i janë adresuar në mënyrë specifike Bashkimit Evropian. Kjo mund të duket jonormale në një raport të kërkuar nga Këshilli i Evropës, por të gjithë anëtarët e BE-së janë gjithashtu anëtarë të Këshillit, dhe një proces është tani në vazhdim, ku vetë Bashkimi Evropian do t'i përmbahet Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në shumë fusha politikash që mbulohen nga ky raport, vendimet e marra nga BE-ja ndikojnë jo vetëm shtetet e saj anëtare, por edhe fqinjët e tyre. Në fushat e politikave për emigracionin dhe veçanërisht azilin, është thelbësore që BE-ja të marrë rol udhëheqës, por ajo duhet të marrë gjithashtu parasysh pikëpamjet dhe interesat e shteteve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës.

A. Integrimi i emigrantëve dhe njerëzve me prejardhje emigranti të kohëve të fundit

18. Nxisim të gjitha shtetet anëtare për të zgjidhur mangësitë legjislative, mangësitë praktike dhe dështimet në zbatim, në veçanti për sa i përket aksesit të barabartë për strehim, punësim, arsim dhe kujdes shëndetësor; dhe për të shfrytëzuar më shumë përfundimet e organeve të Këshillit të Evropës (në veçanti Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komisionit Evropian

kundër Racizmit dhe Intolerancës dhe Komitetit Evropian për të Drejtat Sociale), në të cilat këto boshllëqe identifikohen në mënyrë të qartë; nxisim Këshillin e Evropës për të zhvilluar tregues më të mirë për matjen e suksesit të politikave të inegrimit të shteteve anëtare.

19. Nxisim Bashkimin Evropian të shfrytëzojë plotësisht Komunikatën e ardhshme të Komisionit Evropian për integrimin, dhe atë të Samitit evropian të qershorit të vitit 2011, për të dhënë një mesazh të fortë dhe të qartë politik për shtetet anëtare të BE-së, duke u bërë thirrje atyre që t'i japin popullsisë të tyre një përshkrim të plotë, të qartë dhe të ndershëm për nevojën aktuale dhe të ardhshme evropiane për emigrantët, si dhe t'i përmbahen normave evropiane dhe ndërkombëtare kur kanë të bëjnë me integrimin e emigrantëve, azilin dhe emigrimin e parregullt.
20. I bëjmë thirrje Bashkimit Evropian për të zhvilluar një politikë gjithëpërfshirëse për emigrimin me një kuadër të shëndoshë kushtetues dhe ligjor, të bazuar në respektimin dhe promovimin e të drejtave themelore, siç kërkohet në Programin e Stokholmit dhe Planin e Veprimit për vitet 2010-2014 dhe Strategjinë Evropa 2020; dhe në veçanti:
 - a. të zhvillojë më tej qasjen globale të BE-së për migracionin, duke rritur bashkëpunimin me vendet që nuk janë pjesë e BE-së;
 - b. të mbështesë migracionin për të përmbushur nevojat e tregjeve të punës të shteteve të BE-së;
 - c. të nxitë më tej integrimin dhe të drejtat e emigrantëve (si dhe njerëzve me prejardhje emigranti të kohëve të fundit);
 - d. të marrë parasysh situatën e të miturve të pashoqëruar emigrantë dhe të bashkëpunojë më tej me Këshillin e Evropës për këtë çështje (veçanërisht mbi bazën e Rekomandimit CM/Rec (2007) 9 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare, mbi projektet e jetës për të miturit emigrantë të pashoqëruar);
 - e. të krijojë Zyra Evropiane Informacioni për Migracionin Ekonomik në vende të treta të përzgjedhura, veçanërisht në ato të bregut lindor dhe jugor të Mesdheut.
21. Këshilli i Evropës duhet, si një çështje me përparësi, të promovojë standardet e tij në këtë fushë nëpërmjet instrumenteve të ndryshme të Bashkimit Evropian, në kuadër të Programit të Stokholmit dhe Planin e Veprimit për 2010-2014, i cili synon ndër të tjera zhvillimin e një politike gjithëpërfshirëse të BE-së për të luftuar diskriminimin, racizmin dhe ksenofobinë, dhe për të promovuar barazinë dhe integrimin.
22. Ftojme Bankën e Zhvillimit të Këshillit të Evropës që t'i kushtojë vëmendje të veçantë mbështetjes së projekteve që synojnë integrimin më të mirë të emigrantëve në të gjitha shtetet anëtare.

23. Duke pasur parasysh se puna për përcaktimin e standardeve në fushën e migracionit ka pasur prirjen për të theksuar të drejtat e emigrantëve, duke thënë pak në lidhje me përgjegjësitë e tyre, Këshilli i Evropës duhet që në aktivitetet e ardhshme të përcaktimit të standardeve në këtë fushë, të zhvillojë udhëzime që përfshijnë si të drejtat ashtu edhe përgjegjësitë, si dhe lidhjet mes tyre.

B. Shtetësia dhe e drejta për të votuar

24. Nxsisim të gjitha vendet anëtare për të inkurajuar dhe lehtësuar fitimin e shtetësisë nga të gjithë banorët e përhershëm në territorin e tyre; dhe jo të trajtojnë shtetësinë e një shteti tjetër si pengesë, skualifikimin, apo mosbesnikëri.
25. Për të nxitur pjesëmarrjen aktive në jetën publike në nivel lokal të të gjithë banorëve të ligjshëm në juridiksionin e tyre, nxsisim të gjitha shtetet anëtare të cilat nuk e kanë bërë ende një gjë të tillë, të lejojnë jo-shtetasit të cilët janë banorë të një qyteti apo rajoni të caktuar të votojnë në zgjedhjet lokale dhe bashkiake - siç ndodh brenda Bashkimit Evropian për të gjithë qytetarët që jetojnë në një shtet anëtar tjetër. Kjo mund të zbatohet për të gjithë emigrantët të cilët kanë qenë në vendbanim për një periudhë të caktuar kohe, dhe të përdoret si një fazë e ndërmjetme në rrugën drejt shtetësisë së plotë. I bëjmë gjithashtu thirrje shteteve anëtare që nuk e kanë bërë ende një gjë të tillë të nënshkruajnë dhe të ratifikojnë Konventën e Këshillit të Evropës mbi Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal (deri tani e kanë nënshkruar 13 shtete anëtare, por e kanë ratifikuar vetëm 8 prej tyre).
26. I bëjmë thirrje Këshillit të Evropës të ndihmojë shtetet anëtare duke miratuar një studim krahasues të efekteve të ligjeve të ndryshme të shtetësisë për integrimin e emigrantëve, njerëzve me prejardhje emigranti të kohëve të fundit dhe minoriteteve.

C. Çështjet e azilit dhe ato humanitare

27. I bëjmë thirrje Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, duke punuar ngushtë së bashku, për të hartuar dhe zbatuar një regjim azili koherent dhe human, i cili do të ishte i zbatueshëm në kuadrin panevropian, dhe për të përpunuar një perspektivë afatgjatë për Evropën në këtë fushë, si dhe një strategji për solidaritet ndërmjet shteteve dhe “ndarje përgjegjësie” midis emigrantëve dhe banorëve, apo qytetarëve të tjerë; si dhe:
- a. të sigurojnë që të gjitha politikat e emigrimit dhe azilit të shteteve anëtare të jenë plotësisht në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës, në veçanti me instrumentet e tij të të drejtave të njeriut, veçanërisht Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dokumente të tjera nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si

dhe t'i sigurojë vendeve anëtare udhëzime të qarta se si të zbatojnë këto standarde në praktikë dhe të përmirësojnë efikasitetin e procedurave të tyre kur një numër i madh azilkërkuesishe arrijnë në një vend ose zonë në një kohë të shkurtër;

- b. të sigurojnë që kuadri i Bashkimit Evropian për azilin, në kuadrin e rishikimit të politikave të tij për azilin në bazë të Programit të Stokholmit dhe Planit të Veprimit, të mos prodhojë rreziqe për cënime strukturore të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- c. të kenë parasysh vlerën e punës së re të caktimit të standardeve për kushtet e pranimit dhe ndalimit të azilkërkuesve dhe emigrantëve të parregullt, duke marrë parasysh, ndër të tjera, Rregulloren Dublin II, vendimet përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe aktivitetet e ndërmarra nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor ose Poshtërues;
- d. të kenë parasysh hartimin e udhëzimeve të përbashkëta për trajtimin e emigrantëve të parregullt, azilkërkuesve dhe personave pa shtetësi;
- e. të shqyrtojnë mundësinë e krijimit të një fondi të emigrimit, të ngjashëm me Fondin ekzistues të Këshillit Evropës për të Drejtat e Njeriut, dhe ai të financohet kryesisht nga kontribute vullnetare të shteteve anëtare, me qëllim që të sigurohet fleksibiliteti i punës së tyre në fushën e emigrimit, dhe duke bërë të mundur një reagim më të shpejtë ndaj çështjeve të emigracionit që mund të shfaqen.

28. Nxsisim me forcë të gjitha shtetet anëtare që të shmangin ndalimin e azilkërkuesve dhe emigrantëve të parregullt nëse nuk është absolutisht e nevojshme, si dhe të sigurojnë dhe shfrytëzojnë mjetet alternative ndaj ndalimit, të cilat mund të përfshijnë:

- lirim me kusht me shërbimin social;
- ndalim në shtëpi (arrest shtëpie);
- lejet e punës;
- gjysëm ndalim (duke kaluar një pjesë të ditës në burg);
- liri e kufizuar (izolim në qytetin e banimit);
- lirim me kusht.

29. Inkurajojmë Këshillin e Evropës që t'i ofrojë përvojën dhe mjetet e trajnimit aktorëve në vijën e frontit, si rojeve kufitare, sidomos duke i dhënë vendeve anëtare këshilla ekspertësh për mënyrën se si të hartojnë fuqitë, kompetencat dhe procedurat e këtyre autoriteteve të "vijës së frontit" në një mënyrë efikase dhe në përputhje me të drejtat e njeriut. Për këtë qëllim, Organizata duhet të punojnë së bashku me organet e Bashkimit Evropian, si për shembull Zyra Mbështetëse Evropiane e Azilit me qendër në Maltë (të cilën Bashkimi Evropian aktualisht është duke e përforcuar), Frontex-i me bazë në Varshavë dhe Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët.

30. Duke qenë se parlamentarët kanë të drejtë për të vizituar qendrat e ndalimit, anëtarët e Asamblesë Parlamentare mund të ndjekin shembullin e anëtarëve të Parlamentit Evropian dhe të nxjerrin në pah kushtet shpesh të tmerrshme me të cilat përballen emigrantët dhe azilkërkuesit. Ndërkohë që aktivitete të tilla nuk duhet të zëvendësojnë apo dublojnë punën e instancave monitoruese kombëtare, si punonjësit e Avokatit të Popullit apo zyrtarë të veçantë, ata mund të jenë një mekanizëm i dobishëm vigjilence dhe një mënyrë që Këshilli i Evropës të rritë ndërgjegjësimin për nevojën e procedurave më të shpejta dhe më njerëzore.

D. Arsimi, rinia, dialogu ndërkulturor

31. Nxsisim arsimtarët dhe autoritetet arsimore në të gjitha shtetet anëtare për të zhvilluar “kompetenca ndërkulturore” si një element bazë të kurrikulave shkollore, si dhe t’i shtrijnë këto përtej arsimimit formal, në ambiente jo formale si muze dhe institucione kulturore, aktivitete kulturore dhe festivale, dhe në veçanti në media; Këshilli i Evropës duhet të vazhdojë punën e tij në një kuadër konceptual për të ndihmuar këtë zhvillim.
32. Rekomandojmë që shtetet anëtare të marrin masat e nevojshme për të lehtësuar më tej mobilitetin e studentëve dhe stafit arsimor në të gjitha nivelet, si një mjet i rëndësishëm për të promovuar arsimimin ndërkulturor, për shembull duke rishikuar rregulloret dhe politikat e tyre, veçanërisht, por jo kufizuar në fusha të tilla si vizat dhe rregulloret e emigracionit, rregullat për sigurimet shoqërore dhe lejet e punës për personelin arsimor (si dhe për studentët të cilët duhet të punojnë me kohë të pjesshme për të përballuar studimet). Këshilli i Evropës mund të marrë në konsideratë nisjen e një skeme të veçantë mobiliteti për këtë qëllim dhe të përpunojë një tekst normativ me dispozita për të lehtësuar mobilitetin akademik dhe shkollor, me qëllim që të forcohet arsimimi ndërkulturor.
33. Ftojme Këshillin e Evropës për krijimin e projekteve pilot për dialogun ndërkulturor me një numër të kufizuar shkollash fillore dhe të mesme dhe institucionet e arsimit të lartë në shtetet anëtare, dhe të marrë në konsideratë krijimin e një çmimi të Këshillit të Evropës i cili t’i jepet institucioneve arsimore për punën e tyre në këtë fushë. Gjithashtu, Këshilli i Evropës mund të hartojë ose të autorizojë një manual evropian për përfshirjen e këndvështrimeve të ndryshme dhe “imazhin për Tjetrin” në mësimdhënien e historisë, duke inkurajuar ndërkohë autoritetet e arsimit në rajonet fqinje të Evropës, në mënyrë të veçantë pellgun e Mesdheut, që të miratojnë një qasje me shumë perspektiva (për të cilat mund të japë ndihmën e saj Qendra Veri-Jug e Këshillit të Evropës).
34. Inkurajojmë Këshillin e Evropës për të punuar me shtetet anëtare dhe organizatat e shoqërisë civile për të zbatuar programin e saj të ri të titulluar “Ambasadorët e Rinisë për Paqen”, me qëllim që të rritet vetëdija në mesin e të rinjve dhe publikut të përgjithshëm për standardet dhe instrumentet e Këshillit të Evropës, veçanërisht në zonat pas konfliktit; dhe për të zbatuar

qasjen novatore arsimore të zhvilluar në programin e “kampeve rinore të paqes” në kontekste të tjera të konflikteve, që përfshijnë të rinjtë, për shembull në kontekstin e Romëve të rinj dhe autoriteteve bashkiake, apo banorëve të rinj të zonave urbane të lëna pas dore, si dhe punonjësit e zbatimit të ligjit.

35. Rekomandojmë krijimin e një procesi të rregullt të vlerësimit të mëpasshëm të zhvillimit të dialogut ndërkulturor në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës (në formën e një Forumi Evropian çdo tre vjet ose një raport evropian) me Letrën e Bardhë të vitit 2008 mbi Dialogun Ndërkulturor; një botim “i vogël” i Letrës së Bardhë për përdorim në shkollat fillore dhe të mesme, si dhe në punën e të rinjve; duke u mbështetur tek Shkëmbimet në dimensionin fetar të dialogut ndërkulturor, Këshilli i Evropës dhe shtetet anëtare duhet gjithashtu të hartojnë një platformë të qëndrueshme dhe të njohur për të përmirësuar marrëdhëniet e tyre me përfaqësues të nivelit të lartë të feve dhe organizatave pa një besim të caktuar fetar, si dhe të bashkëpunojnë më tej me përfaqësuesit personalë të Kryetarit në detyrë të OSBE-së, përgjegjës për nxitjen e një niveli më të lartë tolerance dhe luftës kundër racizmit, ksenofobisë dhe diskriminimit.

E. Media

36. Inkurajojmë gazetarët dhe profesionistët e medias të bëjnë kujdes të veçantë për të mos përhapur mite dhe stereotipe rreth anëtarëve të grupeve të caktuara etnike ose fetare, si dhe të sigurojnë që anëtarët e grupeve të tilla të kenë mundësinë për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe të japin versionin e tyre të ngjarjeve; duke pasur këtë parasysh, ftojme Këshillin e Evropës për të organizuar takime të rregullta, duke përfshirë rrjetet kryesore të mediave evropiane, me qëllim që të çojnë më tej zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Evropës për trajnimin, çështjet etike dhe të përmbajtjes; të hartojë dhe shpërndajë një përmbledhje të nismave të suksesshme të ndërmarra në nivel kombëtar për të luftuar diskriminimin në media, të sigurojë mbulimin mediatik etik të çështjeve të minoriteteve dhe të përmirësojë aksesin në media për minoritetet.
37. I bëjmë thirrje të gjitha shteteve anëtare për të siguruar që programet arsimore të medias të përfshihen si një element kryesor në programet e shkollave dhe që fëmijët dhe të rinjtë të alarmohen nga shprehjet të motivuara nga paragjykime raciste, ksenofobike, anti-semite, ose të tjera si këto, të cilat ata mund t'i hasin në internet. Shtetet anëtare duhet gjithashtu të sigurohen që punonjësit e zbatimit të ligjit dhe prokurorët të trajnohen për të trajtuar krimet e urrejtjes me motivacion të ngjashëm në internet, dhe të punojnë me industrinë e internetit për ta nxitur atë që të marrë një rol më aktiv për zgjidhjen e kësaj çështjeje.
38. Inkurajojmë Këshillin e Evropës për të vazhduar punën me organet përfaqësuese të organizatave të medias dhe gazetarëve homologë për hartimin e udhëzimeve për dhënien fund të diskriminimit në vendin e punës dhe krijimin e një kulture të brendshme që nxit në mënyrë aktive

mosdiskriminimin, veçanërisht në punësimin e gazetarëve dhe talenteve radio-televizive.

39. I bëjmë thirrje Këshillit të Evropës për të ngritur një fond bashkëprodhimi për diversitetin në kuadër të Fondit Eurimages - siç është rekomanduar tashmë nga Asambleja Parlamentare në Rekomandimet e saj 1277 (1995) dhe 1768 (2006). Ky fond bashkëprodhimi për diversitetin do të mbështesë filma dhe dokumentarë, duke theksuar dimensionet kulturore të larmishme të shoqërive të sotme evropiane, në mënyrë të tillë që të përplotësohen nismat ekzistuese kombëtare në këtë fushë.
40. Ftojme Këshillin e Evropës, në një partneritet të mundshëm me Mekanizmin e Reagimit të Shpejtë Mediatik të Aleancës së Civilizimeve të Kombeve të Bashkuara dhe Zyrën për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE-ODIHR), për të mbështetur krijimin e një strukture të pavarur (një observator ose një faqe interneti) e cila do të monitorojë mbulimin mediatik, për të siguruar që media po bën siç duhet punën e saj për çështje që kanë të bëjnë me diskriminimin, ksenofobinë dhe mungesën e tolerancës.

F. Përfshirja e Romëve

41. Ndërkohë që i kujtojmë të gjitha shteteve anëtare përgjegjësinë e tyre kryesore për masat e politikave për të promovuar përfshirjen e Romëve në punësim, arsim, shëndetësi dhe strehim, ne nxisim Bashkimin Evropian të përdorë kuadrin e tij të ri për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve për të adresuar në mënyrë efektive të gjitha format e shkeljeve të të drejtave themelore të Romëve, duke përfshirë diskriminimin, ndarjen, gjuhën e urrejtjes, profilizimin etnik dhe marrjen e paligjshme të gjurmëve të gishtave, si dhe dëbimin e paligjshëm; ndërsa i duhet dhënë gjithashtu fund praktikës së kthimit të Romëve në vendet ku ata mund t'i nënshtrohen torturës apo trajtimit poshtërues.
42. Nxisim Bashkimin Evropian për të përdorur gjithashtu këtë kuadër të ri për të përkrahur heqjen e ndarjes në shkolla dhe klasa duke punësuar ndërmjetësues Romë në shkolla dhe duke rritur numrin e mësuesve Romë; si dhe për të siguruar akses të barabartë në arsim në fëmijërinë e hershme, trajnimin profesional të të rriturve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
43. E konsiderojnë gjithashtu të domosdoshme që kuadri i ri të përdoret si një mjet për të siguruar akses efektiv të Romëve në tregun e punës, duke e bërë mikro-kreditin të mundshme për sipërmarrësit Romë dhe punëtorët e vetëpunësuar. U bëjmë thirrje shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Komisionit për të miratuar masa për nxitjen e punësimit të Romëve në administratën publike.
44. I bëjmë thirrje Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, si një vazhdim i Takimit të tij të Lartë më 20 tetor 2010, në bashkërendim të plotë me kuadrin e ri të Bashkimit Evropian dhe në partneritet me OSBE-ODIHR-in, për të

zhvilluar më tej një strategji gjithëpërfshirëse pan-evropiane për përfshirjen sociale të romëve, dhe në veçanti:

- a. të nxjerrë raporte vjetore të monitorimit për të përshpejtuar progresin, si një kontribut thelbësor për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2005-2015, dhe të krijojë një objektiv për të siguruar që veprimet për këtë çështje të mbeten një përparësi e madhe pas përfundimit të dekadës;
- b. të punojë më tej me shtetet anëtare për të përcaktuar objektiva të qarta me afate të caktuara kohore për t'i dhënë fund ndarjes të Romëve në shkolla dhe praktikës problematike të përcaktimit të gabuar të diagnozës së fëmijëve Romë si me të meta mendore dhe duke i çuar ata në shkolla të veçanta në kundërshtim me vendimet ekzistuese të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Shtetet anëtare duhet të hartojnë programe gjithëpërfshirëse për fëmijërinë e hershme dhe arsimin para-shkollor për të siguruar që fëmijët në vështirësi të shumëfishta të jenë gati për në shkollë; që mjedisi i integruar i të mësuarit të jetë i tillë ku fëmijët Romë nuk do të përballen me diskriminim; dhe mësuesit të jenë të trajnuar në mënyrën e duhur për të punuar me diversitetin;
- c. duke pasur parasysh se mungesa e të dhënave është perceptuar shpesh si vendosje e pengesave të tjera për përparimin dhe dobësim i impaktit të politikave që nxisin barazinë dhe mosdiskriminimin, duhet ndërmarrë një studim evropian karahasues në këtë fushë dhe të jepen rekomandimet përkatëse, mundësisht në bashkëpunim me Agjensinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore. Këto të dhëna duhet të jenë anonime dhe duhet të regjistrojnë vetëm ato përkatësi etnike apo të ndonjë lloji tjetër që cilat individët i caktojnë vetes;
- d. të forcohet më tej shoqëria civile Rome dhe Romët të promovohen si qytetarë aktivë dhe jo pritës pasivë, veçanërisht nëpërmjet një nisme mbarëevropiane për të mbështetur regjistrimin e votuesve, programeve për zgjedhje të informuar, si dhe edukatë qytetare për të nxitur qytetari aktive në komunitetin Rom.

G. Mbështetje për veprim në nivel lokal dhe rajonal

45. Duke pasur parasysh faktin se qytezat dhe qytetet evropiane janë fushëbeteja kryesore në luftën për të ndërthurur diversitetin me lirinë, i bëjmë thirrje të gjitha shteteve anëtare të hartojnë programe kombëtare për punonjësit e administratës publike dhe punonjësit e shërbimeve sociale lokale dhe rajonale, për t'i trajnuar personat që punojnë me emigrantë dhe me njerëz me prejardhje emigranti.
46. I bëjmë thirrje të gjitha shteteve anëtare të forcojnë kuadrin për bashkëpunim ndërbashkiak dhe ndërrajonal, duke mundësuar në veçanti bashkëpunimin midis bashkive dhe rajoneve evropiane dhe joevropiane në brigjet jugore dhe

lindore të Mesdheut, duke pasur gjithmonë parasysh se kuadri fillestar për bashkëpunim ndërkufitar, bazuar në Konventën Evropiane të vitit 1980 për Bashkëpunimin Ndërkufitar midis Komuniteteve apo Autoriteteve Territoriale dhe protokollit të saj, është tashmë gati dhe duhet të zhvillohet më tej

47. Ftojme Këshillin e Evropës të zhvillojë më tej programin e tij të “qyteteve ndërkulturore” dhe në veçanti të inkurajojë krijimin e rrjeteve kombëtare të qyteteve ndërkulturore, në mënyrë që koncepti të përshtatet sa më shumë me kontekstet e veçanta kombëtare; si dhe të lehtësohet shtrirja e “qyteteve ndërkulturore” përtej Evropës, me mbështetjen e Qendrës Veri-Jug të Këshillit të Evropës.
48. Ftojme Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës të bashkëpunojë me Komitetin e Rajoneve të Bashkimit Evropian dhe rrjete të tjera evropiane të autoriteteve lokale dhe rajonale (përfshirë rrjetin e qyteteve ndërkulturore) për të:
 - a. ngritur një mekanizëm të përhershëm që të monitorojë shfaqjet e diskriminimit, racizmit dhe ksenofobisë në nivel lokal;
 - b. krijuar bazën ligjore dhe financiare për institucionalizimin e zyrave lokale kundër diskriminimit në zonat me shkallë të lartë emigracioni. Legjislacioni kombëtar duhet të përcaktojë standardet themeore për funksionimin e këtyre zyrave.

H. Ekstremizmi politik, racizmi, fjalori ksenofobik dhe ai kundër emigrantëve

49. I bëjmë thirrje të gjithë udhëheqësve politikë, që ndërkohë që përpiqen t'i përgjigjen në mënyrë bindëse shqetësimeve reale dhe legjitime të publikut lidhur me emigraimin e tepërt apo atë të parregullt, t'i rezistojnë lindjes së partive ksenofobike ose raciste dhe të bëjnë kujdes që të mos kërkojnë të përfitojnë politikisht duke nxitur apo luajtur me shqetësimet e publikut për emigrantët apo pjesëtarët e minoriteteve; duke pasur këtë parasysh, i bëjmë thirrje Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të vazhdojë përpjekjet e saj për të promovuar standarde më të larta etike gjatë trajtimit politik të çështjeve që kanë të bëjnë me racën, origjinën etnike apo kombëtare dhe besimin fetar, duke shfrytëzuar plotësisht Kartën e Partive Politike Evropiane për një Shoqëri Jo-raciste, të nënshkruar nga Presidenti i saj dhe Presidenti i Parlamentit Evropian në vitin 2003.
50. Ftojme Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës të emërojë një raportues për ekstremizmin politik dhe të organizojë një forum vjetor mbi ekstremizmin – i cili mund të quhet takimi Stieg Larsson.

I. Puna me fqinjët

51. I bëjmë thirrje Komitetit të Ministrave t'i japë një status të veçantë në Këshillin e Evropës – përfshirë këtu një marrëdhënie më të ngushtë se ai i statusit të vëzhguesit – vendeve të bregut jugor dhe lindor të Mesdheut dhe Azisë Qendrore që e kërkojnë një gjë të tillë, dhe të cilat kanë dëshirë të aderojnë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
52. Shtetet të cilave u jepet ky status duhet të nxiten të bëhen anëtare me të drejta të plota të organeve të caktuara të Këshillit të Evropës, si Qendra Veri-Jug apo Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet së Drejtës, i njohur më shumë si Komisioni i Venecias; ata duhet të ftohen gjithashtu t'i bashkohen anëtarëve me të drejta të plota të Forumit të Këshillit të Evropës për të Ardhmen e Demokracisë, si dhe për themelimin dhe administrimin e një shkolle të studimeve politike.
53. Të gjitha veprimtaritë e organizuara në mënyrë të përbashkët midis Këshillit të Evropës dhe shteteve fqinje me statusin e ri – përfshirë ato që përmendëm në paragrafin më sipër – duhet të grupohen së bashku dhe të bashkërendohen nga një “organ fqinjësie”, i mbështetur nga një fond me kontributet vullnetarëve të anëtarëve.
54. Këshilli i Evropës duhet t'i drejtohet Lidhjes së Shteteve Arabe me një ofertë për partneritet, në bazë të së cilës të dy organizatat do të punonin së bashku për të siguruar që vendet arabe të mund të shfrytëzojnë më mirë të gjitha instrumentat ekzistuese për të drejtat e njeriut.

J. Zbatimi i propozimeve tona

55. Ftojme Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës të emërojë një përfaqësues special të nivelit të lartë i cili do të mandatohej për të sjellë këtë raport në vëmendjen e udhëheqësve politikë dhe të monitoronte zbatimin e tij, me ndihmën e një task force, me detyrë sigurimin e koherencës gjatë zbatimit të rekomandimeve të këtij raporti brenda Organizatës.
56. I bëjmë thirrje Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës të hartojë një plan veprimi i cili të reflektojë rekomandimet kryesore të shprehura në këtë raport, me qëllim prezantimin e tij për miratim në një nivel të takimit të lartë në të ardhmen e afërt.
57. Ftojme Këshillin e Evropës të zhvillojë një kod të praktikave të mira për “bashkëjetesën në diversitet dhe liri në Evropë” mbështetur në rekomandimet e këtij raporti, si dhe në standardet ligjore ekzistuese të Këshillit të Evropës dhe teksteve të tjera të referencës, si Letra e Bardhë mbi Dialogun Ndërkulturor të miratuar në vitin 2008.
58. Nxisim Sekretarin e Përgjithshëm që t'i bëjë propozime Komitetit të Ministrave për të thjeshtuar dhe përmirësuar makinerinë e Këshillit të Evropës, në mënyrë që ajo të mund të nxjerrë raporte më të pakta në numër por më të

qarta dhe të lexueshme, të cilat të mund të kenë një imapkt më të madh tek opinioni publik dhe vendimmarrësit në shtetet anëtare.

59. I bëjmë thirrje qeverive të Polonisë dhe Ukrainës, si drejtuesit përkatës të Bashkimit Evropian dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në vjeshtën e vitit 2011, që të organizojnë një takim të përbashkët Këshill i Evropës – Bashkim Evropian mbi diversitetin, në të cilin shtetet anëtare të të dyjave organizatave të shqyrtojnë çështjet e ngritura në këtë raport dhe të bien dakort për një strategji të përbashkët veprimi në fushën e diversitetit dhe të drejtave të njeriut.

Shtojca 1: Termat e Referencës së Grupit

1. Studim

Të jesh një qytetar evropian do të thotë të jesh pjesëtar i një komuniteti bazuar në gëzimin e plotë të të drejtave të individit – të garantuara nga qeveri të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe të mbrojtura nga një sistem gjyqësor i paanshëm dhe i pavarur – si dhe bazuar në tolerancën, respektin e ndërsjellë dhe pranimin e diversitetit. Ajo do të thotë gjithashtu të pranosh disa detyrime në respekt të të tjerëve, duke qenë kështu në përputhje me rregullat e demokracisë dhe duke dhënë kontribut për zhvillimin e një shoqërie të drejtë dhe të organizuar.

Ky “model evropian” gjendet tani në rrezik si pasojë e ringjalljes së mostolerancës dhe diskriminimit. Gjatë disa viteve të fundit, të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës janë prekur nga përkeqësimi i lidhjeve shoqërore, radikalizimi dhe rritja e ndarjeve midis komuniteteve të ndryshme brenda shoqërive tona. Këto zhvillime shqetësuese po minojnë kohezionin e shoqërive tona evropiane dhe mund të vënë në rrezik vlerat demokratike të Evropës.

Këshilli i Evropës, si ruajtësi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka përgjegjësinë të mbrojë – së bashku me partnerë të tjerë ndërkombëtarë – vlerat e demokracisë, të drejtat e njeriut dhe shtetin ligjor, të cilat janë parakushte themelore për sigurinë dhe stabilitetin në Evropë. Të mësosh se si të “bashkëjetosh” është pjesa kryesore e konceptit të “sigurisë së butë”. Bashkekzistenca në harmoni midis pjesëtarëve të një shoqërie është garancia më e mirë për unitetin dhe përparimin e saj.

Për të ndihmuar Këshillin e Evropës që të përballet me këto sfida, Sekretari i Përgjithshëm dhe Presidenca e ardhshme turke e Komitetit të Ministrave propozoi në Sesionin Ministror të majit të vitit 2010 krijimin e “një Grupi me Persona të Shquar” për të hartuar një raport i cili të shërbejë si bazë për veprimet e mundshme në të ardhmen të Këshillit të Evropës. Termat e referencës së Grupit përfshijnë:

1. vlerësimin e seriozitetit të rreziqeve ndaj vlerave të Këshillit të Evropës si rrjedhojë e mungesës në rritje të tolerancës dhe përhapjes së qasjeve “komunitare”;
2. identifikimin e burimeve të këtyre dukurive (ideologjike, morale, fetare, ekonomike, sociale, kulturore e kështu me rradhë);
3. përcaktimin e një koncepti të ri të “bashkëjetesës”, i cili mund t’i propozohet qytetarëve të shoqërive evropiane.

2. Anëtarët e Grupit

Grupi përbëhet nga nëntë individë të nivelit të lartë, të cilët kanë specializimin e duhur dhe shfaqin një interes të veçantë në këtë fushë. Pjesëtarët e grupit sigurojnë, me aq sa është e mundur, një shpërndarje të balancuar gjeografike, përfaqësim të barabartë të burrave dhe grave, si dhe shumëllojshmëri në aspektin profesional. Një raportues do të jetë përgjegjës për përgatitjen e draft raportit.

Grupi përbëhet nga këta anëtarë:

1. Joschka Fischer (Gjermani, Kryetar)
2. Emma Bonino (Itali)
3. Timothy Garton Ash (Mbretëria e Bashkuar)
4. Martin Hirsch (Francë)
5. Danuta Hübner (Poloni)
6. Ayşe Kadioğlu (Turqi)
7. Sonja Licht (Serbi)
8. Vladimir Lukin (Federata Ruse)
9. Javier Solana (Spanjë)

Raportuesi është Edward Mortimer (Mbretëria e Bashkuar)

Metodologjia

Grupi i Personave të Shquar do të mbështetet nga Sekretariati i Këshillit të Evropës (Drejtoria e Planifikimit të Politikave) për organizimin dhe përgatitjen e takimeve të tij. Ai do të takohet gjashtë herë në periudhën tetor 2010 dhe Maj 2011. Shpenzimet e tij operative do të mbulohen nga Qeveria e Turqisë.

Shtojca 2: Takimet e Grupit dhe njerëzit e intervistuar

Takimi i parë (Strasburg, 15 tetor 2010)

- Gabriella Battaini-Dragoni, Drejtoreshë e Përgjithshme për Arsimin, Kulturën dhe Trashëgiminë, Rininë dhe Sportin, Kordinatore për Dialogun Ndërkulturor dhe për Fushatën e Këshillit të Evropës Kundër Diskriminimit
- Thomas Hammarberg, Komisioner i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut
- Niels Muiznieks, Kryetar i Komisionit Evropian Kundër Racizmit dhe Mungesës së Tolerancës (ECRI)

Takimi i dytë (Budapest, 2 dhjetor 2010)

- Zoltán Balog, Sekretar Shteti për Përfshirjen Sociale, Hungari
- Costel Bercus, Kryetar Bordi, Fondi për Arsimimin e Romëve
- Mesazh video nga Livia Járóka, Anëtare e Parlamentit Evropian
- Rob Kushen, Drejtor Ekzekutiv, Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve
- Osman Balić, Kordinator i OJQ-së Lidhja për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2005-2015, Serbi
- Istvan Gyarmati, Ambasador, Hungari
- Gyorgy Makula, Zëdhënës i Policisë Hungareze, Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Vëllazërore të Punonjësve Romë Evropianë të Zbatimit të Ligjit (Faerleo)
- Katalin Bársony, Drejtoreshë, Fondacioni Romedia, Hungari

Takimi i tretë (Stamboll, 13 dhe 14 Janar 2011)

- Takim me Patriarkun Ekumenik të Kishës Ortodokse Greke
- Takim me Ahmet Davutoglu, Ministër i Jashtëm i Turqisë, Kryetar i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës
- Ayhan Kaya, Universiteti Istanbul Bilgi
- Ferhat Kentel, Universiteti Istanbul Sehir
- Famile Arslan, Rrjeti i Profesionistëve Myslimanë Evropianë

Takimi i katërt (Madrid, 14 dhe 15 shkurt 2011)

- Jorge Sampaio, Përfaqësues i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Aleancën e Civilizimeve
- Gabriella Battaini-Dragoni, Drejtoreshë e Përgjithshme për Arsimin, Kulturën dhe Trashëgiminë, Rininë dhe Sportin, Kordinatore për Dialogun Ndërkulturor dhe për Fushatën e Këshillit të Evropës Kundër Diskriminimit
- Mukti Jane Campion, Drejtor, Culture Wise (Mbretëri e Bashkuar)
- Joan-Andreu Rocha Scarpetta, Zëvendës Dekan i Gazetarisë, Universiteti Abat Oliba CEU i Barcelonës (Spanjë)
- Manuela Mesa, Drejtoreshë e CEPAZ, Fundación Cultura de Paz (Madrid)
- Catherine Fieschi, Drejtoreshë e Counterpoint (Mbretëria e Bashkuar) dhe Sabine Selchow, Studiuese, Programi Shoqëria Civile Globale, Shkolla e Ekonomisë së Londrës

Takimi i pestë (Bruksel, 17 dhe 18 mars 2011)

- Cecilia Malmström, Komisionerja Evropiane për Çështjet e Brendshme
- Pierre Mirel, Drejtor për Ballkanin Perëndimor, Drejtor i Përgjithshëm për Zgjerimin, Komisioni Evropian
- Keith Whitmore, President i Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.
- Roman Jaborkhel, Departamenti i Kulturës, Qyteti Lublin, Poloni
- Berend de Vries, Nënkyetar Bashkie, Qyteti Tilburg, Hollandë
- Nazia Hussain, Drejtor i Projektit të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur “At home in Europe”
- Alard du Bois-Reymond, Drejtor, Zyra Federale Zvicerane për Migracionin
- Vincent Berger, Jurist, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- Ilze Brands Kehris, Drejtor i Zyrës së Komisionerit të Lartë për Minoritetet Kombëtare të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Takimi i gjashtë (Salzburg, 7 dhe 8 prill 2011)

Shtojca 3: Bibliografi përmbledhëse

1. Këshilli i Evropës

Konventa dhe Karta

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 1950

Karta Sociale Evropiane (e rishikuar), 1996

Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 1995

Konventa mbi Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal, 1992

Konventa mbi Krimin Kibernetik - Protokolli shtesë në lidhje me penalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike, 2003

Tekstet të tjera të miratuara dhe dokumentet e referencës

Komiteti i Ministrave

Ndërveprimi ndërmjet emigrantëve dhe shoqërive pritëse – Rekomandim CM/Rec(2011)1

Vlerësimi i aftësive të emigrantëve / Rekomandim CM/Rec(2011)2

Karta e Këshillit të Evropës për Arsimimin për Qytetarinë Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut – Rekomandim CM/Rec(2010)7

Arsimimi i Romëve dhe Udhëtarëve në Evropë – Rekomandim CM/Rec(2009)4

Letra e Bardhë për Dialogun Ndërkulturor, 2008

Përmirësimi i mundësive të emigrantëve dhe personave me prejardhje emigranti për punësim – Rekomandim CM/Rec(2008)10

Dimensioni i bindjeve fetare dhe jofetare brenda arsimimit ndërkulturor – Rekomandim CM/Rec(2008)12

Politikat për Romët dhe/ose Udhëtarët në Evropë – Rekomandim CM/Rec(2008)5

Forcimi i integritetit të fëmijëve të emigrantëve dhe atyre me prejardhje emigranti – Rekomandim CM/Rec(2008)4

Projekte të jetës, emigrantë minorenë të pashoqëruar – Rekomandim CM/Rec(2007)9

Asambleja Parlamentare

Mbrojtja e minoriteteve në Evropë: praktikat më të mira dhe mangësitë në zbatimin e standardeve të përbashkëta – Rekomandim 1904 (2010)

Islami, Islamizmi dhe Islamofobia në Evropë – Rezoluta 1743 (2010)

Rritja e kohëve të fundit e ligjërimit për sigurinë kombëtare në Evropë: rasti i Romëve – Rezoluta 1760 (2010)

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, raport, 2010

Azilkërkuesit Romë në Evropë – Rezoluta 1768 (2010)

Lufta kundër ekstremizmit: arritje, mangësi dhe dështime – Rezoluta 1754 (2010)

Lufta kundër anti-Semitizmit në Evropë – Rezoluta 1563 (2007)

Programet e rregullimit për emigrantët e parregullt – Rezoluta 1568 (2007)

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale

Integrimi Kulturor i Grave Myslimane në Qytetet Evropiane – Rezoluta 318 (2010)

Qytetet ndërkulturore – Rezoluta 280 (2009)

Dialogu ndërkulturor dhe ndërfetar: një mundësi për demokracinë lokale – Rekomandim 245 (2008)

Komisioneri për të Drejtat e Njeriut

Raporti i 4-rt i Aktiviteteve Tremujore 2010

Raportet e Aktiviteteve Vjetore 2009 dhe 2010

Penalizimi i Migrimit në Evropë: Pasojat tek të Drejtat e Njeriut CommDH/IssuePaper(2010)¹

Të Drejtat e Njeriut të Migrantëve të Parregullt në Evropë, CommDH/IssuePaper(2007)¹

Myslimanët Evropianë damkosen nga retorika populiste, Koment për të Drejtat e Njeriut, 28 tetor 2010

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Mostolerancës (KERI)

Raporti Vjetor për Aktivitetet e KERI-t – 2009

Rekomandimet për Politikën e Përgjithshme

Botime të tjera dhe faqe interneti

Këshilli i Evropës dhe Romët, 40 vjet veprim, Jean-Pierre Liégeois, botime të Këshillit të Evropës, 2010

Dialogu Ndërkulturor në Kuadër të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Patricia Wiater, Botim i Këshillit të Evropës, 2010

Migrantët dhe pasardhësit e tyre – Udhëzues politikash për mirëqenien e të gjithëve në shoqëri pluraliste, Botim i Këshillit të Evropës, 2010

Të jetosh në Diversitet – Plane Mësimore për Shkollat e Mesme, Botim i Këshillit të Evropës, 2010

Përshtatja institucionale dhe qytetaria: ndërveprimi ligjor dhe politik në shoqëritë pluraliste – Prirje të Kohezionit Social, Botim i Këshillit të Evropës, 2009

Manual për fjalorin e nxituar, 2009

Media & Diversiteti: Hapat e ardhshëm për të nxitur aksesin e minoriteteve në Media – Raporti përfundimtar i Fushatës së Këshillit të Evropës “Ngrije zërin kundër diskriminimit”, 2009

Manual për ligjet evropiane kundër diskriminimit, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Agjensia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2011

2. Bashkimi Evropian

Projekti Evropa 2030 – Sfida dhe Mundësi – Raport për Këshillin Evropian nga Grupi i Reflektimit për të Ardhmen e BE-së 2030

Manual për Integrimin për hartuesit e politikave dhe praktikuesit – Komisioni Evropian, 2010

Faqja Evropiane e Internetit për Integrimin

Diskriminimi në BE në vitin 2009/ – Eurobarometër i veçantë 317, 2009

Lidhjet ndërmjet emigrimit dhe diskriminimit – Rrjeti Evropian i Ekspertëve Ligjorë në fushën e mosdiskriminimit, Olivier de Schutter, Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Punësimin, Çështjet Sociale dhe Mundësitë e Barabarta, 2009

Praktikat sindikaliste kundër diskriminimit dhe ato të diversitetit, Luksemburg, Zyra e Botimeve të Bashkimit Evropian, 2010

Diversiteti Mediatik: matja e pulsit të diversitetit më media – Komisioni Evropian, 2009

Emigrimi pa dokumente: Të numërosh të panumërueshmen – Të dhëna dhe prirje në mbarë Evropën, projekt i financuar nga Komisioni Evropian, DG Research, Programi i Gjashtë Kuadër (2009), raport përfundimtar

TE-SAT 2010 EU- Situata e terrorizmit dhe raporti i prirjeve, EUROPOL, 2010

Agjensia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore

Diskriminimi i Shumëfishtë; EU-MIDIS Sondazhi për Minoritetet e Bashkimit Evropian dhe Diskriminimin, 2010

Ndërgjegjësimi për të Drejtat dhe Organet për Barazinë. Forcimi i të drejtave themelore në EU III; EU-MIDIS Sondazhi për Minoritetet e Bashkimit Evropian dhe Diskriminimin, 2010

Anti-Semitizmi, Përmbledhje e Situatës në Bashkimin Evropian 2001-2008, 2009

Raport i të Dhënave: Myslimanë, EU-MIDIS Sondazhi për Minoritetet e Bashkimit Evropian dhe Diskriminimin, 2009

3. Organizata të tjera ndërkombëtare

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) - Krimet e urrejtjes në Rajonin e OSBE-së - Incidentet dhe përgjigjet - 2009, Raporti Vjetor 2010

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë - Komisioneri i Lartë për Minoritetet Kombëtare - Rekomandime tematike 1996-2008, 2010

Policia, Romët dhe Sintit: Praktikë e Mira në Krijimin e Besimit dhe Mirëkuptimit, Seria e Botimeve SPMU Vëllimi 9, OSBE 2010

Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM) – Raport për migracionin botëror 2010 : E ardhmja e migracionit: ngritja e kapaciteteve për ndryshim, 2010

Organizata Ndërkombëtare e Migracionit – rrjeti i Pavarur i Migracionit për Punësim dhe Ekspertët e Integrit: Migracioni, Punësimi dhe Politikë për Integrimin në Tregun e Punës në Bashkimin Evropian, 2000-2009

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) – Perspektiva e Migracionit Ndërkombëtar, 2010

Mostoleranca dhe Diskriminimi kundër të Krishterëve: Duke u përqendruar tek Përgjashtimi, Margjinalizimi dhe Mohimi i të Drejtave, Raport i Tryezës së Rrumbullakët OSBE/ODIHR, 2009

Aleanca e Civilizimeve e Kombeve të Bashkuara, Raport i Grupit të Nivelit të Lartë – Nju Jork, 2006

Rekomandime për Policinë në Shoqëritë multietnike, Zyra e Komisionerit të Lartë për Minoritetet Kombëtare, OSBE, 2006

4. Botime të tjera

Gjendja e Minoriteteve në Botë dhe Njerëzve Autoktonë 2010, Grupi Ndërkombëtar për të Drejtat e Minoriteteve, 2010

Rritja e Mendimeve jo pozitive për Hebrenjtë dhe Myslimanët, Projekti Pew Global Attitudes, 2008

Perceptimi i Krimit dhe Viktimizimi në Evropë: A ka rëndësi emigrimi? Centro Studi Economici Antonveneta, 2011

Myslimanët në Evropë: raport për 11 qytete të BE-së, Fondacionet për Shoqëri të Hapur, 2010

Lufta kundër Krimit dhe Dhunës me bazë Racore: Dëshmi dhe Strategji Mbrojtjeje – Rrjeti Evropian kundër Racizmit dhe Këshillit të Irlandës Veriore për Minoritetet Etnike (NICEM), 2009

Fitzgerald, J., K. A. Curtis, dhe C. L. Corliss: “Publik në ankth: Shqetësim për krimin dhe emigracionin” në Aktet e Takimit Vjetor të Shoqërisë Ndërkombëtare për Psikologji Politike, Dublin, Trinity College, 2009

Dhoma e Lordëve, Efektet ekonomike të emigracionit, Dhoma e Lordëve, 2008

Süssmuth R., Strukturimi i emigracionit, nxitja e integritit, Komision i Pavarur për Migracionin në Gjermani, Berlin, 2001

Rrjeti Ndërkombëtar kundër Urrejtjes në Internet (INACH), Raport 2010

Ashutosh Varshney, Konflikti Etnik dhe Jeta Civile: Hindutë dhe Myslimanët në Indi, Yale University Press, 2002 dhe 2003

Romët në Itali: informacion për Komisionin Evropian, Fondacionet për Shoqëri të Hapur, 2010

Gianni Betto, “L’immagine dell’immigrato attraverso i media italiani”, 2010

M. J. Champion, “Shiko kush po flet” – Diversiteti Kulturor, Transmetimi i Shërbimit Publik dhe Bashkëbisedimi Kombëtar, Nuffield College Oxford, 2005

A. Altikriti dhe A. Faliq, Islamofobia dhe urrejtja antimyslimane: shkaqet & masat, Fondacioni Cordoba, 2010

Shtojca 4: Anëtarët e Grupit

Joschka Fischer (Kryetar)



Joseph Martin (“Joschka”) Fischer është politikan gjerman, anëtar i Aleancës “90/the Greens”. Ai ka qenë Ministër i Jashtëm dhe zëvendës Kancelar i Gjermanisë në periudhën 1998 - 2005.

Emma Bonino



Emma Bonino është zëvendës kryetare e Senatit Italian. Ajo ka qenë Ministre për Tregtinë Ndërkombëtare dhe Çështjet Evropiane. Në periudhën 1994-99 ajo ka qenë Komisionere Evropiane për Ndihmat Humanitare, Peshkimin, Politikat Konsumatore, Mbrojtjen e Shëndetit të Konsumatorëve dhe Sigurinë e Ushqimeve.

Timothy Garton Ash



Timothy Garton Ash është Profesor i Studimeve Evropiane në Universitetin e Oksfordit. Ai është autor i nëntë librave të “historisë së sotme”, të cilat trajtojnë transformimin e Evropës gjatë 40 viteve të fundit. Editoriali i tij i përjavshëm në gazetën *Guardian* vlerësohet gjerësisht në mbarë kontinentin.

Martin Hirsch



Martin Hirsch ka qenë më parë Komisioneri i Lartë Francez për Solidaritet Aktiv kundër Varfërisë dhe Komisioner i Lartë për Rininë. Aktualisht ai është Drejtues i Agjensisë për Shërbim Civil. Ai është gjithashtu ish President i Emmaüs France.

Danuta Hübner



Danuta Hübner është ekonomiste, akademike dhe politikëbërëse polake. Ajo ka qenë Ministria Polake për Çështjet Evropiane dhe Komisionere Evropiane për politikat rajonale. Që prej vitit 2009 ajo është Anëtare e Parlamentit Evropian.

Ayşe Kadioğlu



Ayşe Kadioğlu është pedagoge e Shkencave Politike në Universitetin Sabancı të Stambollit. Vitin akademik 2009-10 e zhvilloi në Universitetin e Oksfordit. Ajo ka marrë gradën shkencore “doktor” për Shkenca Politike në Universitetin e Bostonit (1990) dhe gradën “Master” për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Çikagos (1984).

Sonja Licht



Sonja Licht është sociologe me famë ndërkombëtare si dhe aktiviste politike dhe e të drejtave të njeriut. Ajo ka qenë pjesë e lëvizjes disidente jugosllave e fundit të viteve 1960, dhe dy dekada më vonë themeloi një numër të madh OJQ-sh kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë këtu disa organizata për gratë.

Vladimir Lukin



Vladimir Lukin është Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Federatës Ruse që prej vitit 2004 dhe është gjithashtu President i Komitetit Rus të Paralimpikëve. Diplomuar për histori në Institutin Arsimor Shtetëror Lenin në Moskë, Vladimir Lukin është diplomuar gjithashtu për shkenca natyrore dhe ka punuar si studiues për disa vite.

Javier Solana



Javier Solana Madariaga është fizikant spanjoll dhe politikan socialist. Ai ka mbajtur disa poste qeveritare (Ministër i Kulturës, Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Ministër i Jashtëm), dhe ka qenë Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s dhe i Këshillit të Bashkimit Evropian. Ka qenë Përfaqësuesi i parë i Lartë i BE-së për Politikën e Përbashkëta të Jashtme dhe ato të Sigurisë.

Edward Mortimer (raportues)



Edward Mortimer është autor dhe publicist anglez. Aktualisht është Zëvendës President dhe Drejtues Kryesor Programi i Seminarit Global të Salzburgut. Gjatë periudhës 2001-06 ka qenë Drejtor i Komunikimit në Zyrën Ekzekutive të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kofi Annan.

Pjesëtarët e stafit të Këshillit të Evropës të cilën dhanë ndihmesën e tyre për përgatitjen e këtij raporti

Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet e Demokracisë dhe ato Politike: Piotr Świtalski (Drejtor i Planifikimit të Politikave); Mehdi Remili; Rebecca Scaife; Jane Wodey; Demian Podolskyi; Anna Dolgikh

Drejtoria e Komunikimit: Daniel Höltingen (Drejtor)

www.coe.int